



# UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Korrik 2015

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

## REKTORI I UBT-SË U NDERUA ME ÇMIMIN ICT AKADEMIKU I VITIT



Faqe 4

## UBT PREZANTOI QENDRËN PËR SIGURI KIBERNETIKE DHE PRIVATËSI

Faqe 5

## NË UBT I ZHVILLOI PUNIMET KONFERENCA "DITËT AUSTRIAKE- KOSOVARE 2015"

Faqe 6, 7, 8

## I ZHVILLOI PUNIMET KONFERENCA "FREE MARKET ROAD SHOW"

Faqe 9

## STUDENTËT E UBT-SË E TË UP-SË FITUES TË GARËS SË NASA-S

Faqe 10

## NË UBT U INAUGURUA BIBLIOTEKA DHE QENDRA E DIJES ME MBI 100 MIJË LIBRA

Faqe 11

## NË UBT U INAUGURUA INKUBATORI VIRTUAL I KOSOVËS DHE START UP QENDRA

Faqe 12

## DRULAK: NË RRUGËN DREJT EVROPËS, KOSOVA DUHET TË PËRFITOHË NGA SHEMBULLI I ÇEKISË

Faqe 13

## AMBASADORI I NORVEGJISË, JAN BRAATHU MBAJTI LIGJËRATË NË UBT

Faqe 14

## APLIKIMET KANË FILLUAR...



Zgjedh më të mirin ...  
... që të bëhesh më i miri!

**APLIKO TANI!**

# CEREMONIA E DIPLOMIMIT 2015



Faqe 3



## Editorial

Safet Zejnullahu

## Të gjitha në një vend!

Nga një numër në tjetrin, "UBT News" sivjet mbushi gjashtë vjet të publikimit të saj. Nisma dhe rrita e gazetës së studentëve të UBT-së është pothuaj e njëjtë me UBT-në – një fillim i qetë e pa fjalë të mëdha, por me punë të madhe e lajme të rëndësishme.

Në këto gjashtë vjet, "UBT News" ka shërbyer si një publikim që ka përmbledhur në faqet e veta të gjitha aktivitetet e zhvilluara në UBT dhe nga UBT: marrëveshjet e konferencat ndërkombëtare, sukseset e profesorëve, sukseset e studentëve, ceremonitë e fillimit të viteve akademike, ceremonitë e diplomimit të gjeneratave e deri te aktivitetet kulturore e sportive. Të gjitha këto aktivitete do të mbeten në faqet e kësaj gazete, si dëshmi e një kohe të rritës së pakontestueshme e të parivalë të UBT-së.

Në editorialin e fundit, ne iu gëzuar bashkë vlerësimit që UBT-së i bëri EFQM (organizata që bën vlerësimin në Evropë për Ekselencë), duke konfirmuar se UBT ka arritur nivelin e zhvillimit në shkallë të ekselencës dhe duke hyrë në grupin e organizatave evropiane dhe botërore më të zhvilluara. Aty ku ekselencështë e akceptuar si kriteri kryesor i vlerës.

Nga kjo kohë e tutje, duke e dëshmuar në vazhdimësi këtë titull dhe duke punuar për çdo ditë që ekselencia të tregohet në praktikë, UBT ka shënuar hapa të mëdhenj, duke u dëshmuar si institucioni më prestigjioz i arsimit të lartë në vend dhe në rajon.

Po përmendim, kalimthi, disa prej rezultateve të shënuara gjatë kësaj periudhe.

Krahas shumë marrëveshjeve ndërkombëtare, UBT e ka vazhduar bashkëpunimin ose ka nënshkruar marrëveshje të reja bashkëpunimi me shumë universitete të njohura. Përmendim këtu Universitetin "Corvinus" të Budapestit, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universitetin e Varshavës, Universitetin "Linnaeus" të Suedisë, Universitetin "Anhalt Dessau" në Gjermani... Gjatë po kësaj periudhe janë nënshkruar edhe disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendore.

Një sukses i shënuar është edhe fakti se, përveç programeve të tjera ndërkombëtare, UBT u bë pjesë e projektit CEEEPUS («Central European Exchange Program for University Studies»), që përfshin vendet e Evropës Qendrore dhe Evropës Juglindore dhe që ofron programe dhe diploma të përbashkëta për studentët e institucioneve anëtare.

UBT për disa javë rresht ishte pjesë e lajmit më të mirë për të arriturat shkencore të studentëve të tij, të cilët, bashkë me kolegë nga UP, me Projektin "Natev Explorer", fituan garën e organizuar nga NASA, në një konkurrencë mbarëbotërore.

UBT e vazhdoi edhe traditën e organizimit të konferencave ndërkombëtare, Kështu, UBT ishte mikpritës i konferencës dyditore "Ditët Austriake-Kosovare 2015". Në UBT i zhvilloi punimet edhe konferenca "Free Market Road Show", pastaj edhe konferenca "Dita Financiare Austriake-Kosovare për hipotekat 2015". Të gjitha me karakter ndërkombëtar dhe që mblodhën emra të rëndësishëm nga politika ndërkombëtare dhe ajo vendore.

Po në planin ndërkombëtar. Ceremonia e dhënies së çmimeve nga "Albanian ICT Awards" u dominua nga UBT. Rektori i tij, Prof.Dr.Edmond Hajrizi u nderua me Çmimin ICT Akademiku i

Vitit, ndërsa çmime u dhanë edhe për shumë studentë të institucionit tonë.

UBT gjatë kësaj periudhe ishte edhe një pikë referimi për politikanë e ekspertë, ndërkombëtarë e vendorë, të cilët mbajtën ligjërata dhe debatuan me studentët. Një përvojë e jashtëzakonshme.

Një pikë së cilës UBT vazhdon t'i kushtojë kujdes janë bursat për studime jashtë vendit për studentët dhe stafin. Kështu, në UBT u mbajt sesioni informativ për bursat e Forumit Evropian të Alpbach dhe IG Alpbach Kosova, që dhanë bursa për studentët e UBT-së. Gjithashtu, përmes Programit "Erasmus+ Global Mobility and Knowledge Alliances", studentët e UBT-së mund të përfitojnë bursa në universitetet e Norvegjisë, në vlerë prej qindra mijëra euro. Bursat individuale janë edhe më tej pika në të cilën studentët e UBT-së vazhdojnë të jenë të parët në krahasim me institucionet akademike në vend e në rajon.

UBT u kujdes edhe për krijimin e kushteve dhe mundësive të reja për studentët. Ne inauguruam Bibliotekën dhe Qendrën e Dijes me mbi 100 mijë libra. Nepo ashtu inauguruam Inkubatorin Virtual të Kosovës dhe Start up Qendrën. I hapëm rrugë kështu përkrahjes së ideve e projekteve inovative të studentëve tanë, por edhe të gjithë të tjerëve që duan të zhvillojnë idetë e tyre, me përkrahjen tonë të pakursyeshme.

Duke u dëshmuar si prijatë, UBT prezantoi Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi. Dhe, shumë shpejt, UBT u bë pikë referencë në këtë fushë.

Ne zhvilluam edhe aktivitete të tjera, promovuam libra të profesorëve tanë. Botuam revistën "Alumni". Profesorë të UBT-së morën pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare, duke prezantuar UBT-në dhe Republikën e Kosovës. Në secilën prej tyre u arritën marrëveshje të shumta bashkëpunimi dhe dhjetëra universitete ndërkombëtare shprehën interesim për bashkëpunim me UBT-në.

Studentët tanë realizuan dhjetëra vizita studimore në Kosovë dhe jashtë vendit. Organizuam me mjaft sukses Akademitë verore 2015, konferencat studentore, ekspozitat tradicionale... Organizuam edhe një ceremoni madhështore të diplomimit të studentëve...

Nëse në tre muaj kohë, një institucion organizon kaq shumë aktivitete (këtu përmendim vetëm më kryesoret), atëherë nuk ka se si të mos quhet një qendër e dijes, e shkencës, e hulumtimit, e inovacionit, një institucion me vizion të qartë, që vë studentit në plan të parë. I afron atij të gjitha mundësitë dhe ia hap atij të gjitha perspektivat.

Sepse, vlera më e madhe me të cilën matet UBT është rezultati i studentëve, shkalla e tyre e punësimit, rezultatet kulminante të atyre që vazhdojnë studimet janë vendit dhe ku janë të parët, pa konkurrencë.

Studentët e rinj, që tashmë janë më mijëra që i janë drejtuar UBT-së për vitin e ri akademik 2015/2016, sikur edhe familjet e tyre, e dinë mirë pse duhet zgjedhur UBT-në, pse duhet zgjedhur institucionin më të mirë për t'u bërë më të mirët. Sepse, në UBT i gjejnë në një vend të gjitha që i duhen një studentit. Ne garantojmë që pas tri vitesh ata do të jenë profesionistë të vërtetë, të përgatitur për sfidat e kohës dhe - më e rëndësishmja - një hap para të gjithë të tjerëve!



**14 YEARS**  
**LEADERSHIP and INNOVATION**

Education • Research • Training • Consulting  
2001/2015

## IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

**Botues:** Edmond Hajrizi

Gazetën e përgatitën studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim në UBT.

**Adresa:** www.ubt-uni.net | **Tel:** 038 541 400, 044 541 400

**Thyerja Grafike:** ELV Studio

**Shtypet në Shtypshkronjën** «Roto Print»



PËR TË 12-TIN VIT ME RADHË

# NË UBT U ZHVILLUA CEREMONIA E DIPLOMIMIT 2015

4 qershor. - Në një ceremoni madhështore, zhvilluar në sallën "1 Tetori" në Prishtinë, UBT shënoi edhe një sukses të tijin, ngjarjen më madhështore për mbi 470 studentë të nivelit bachelor dhe master – Ceremoninë e diplomimit 2015.

Studentët e diplomuar janë nga departamentet: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Sistemet e Informacionit, Juridik, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri dhe Mekatronikë.

Përveç prindërve e familjarëve të shumtë, ceremoninë e diplomimit në UBT e nderuan me pjesëmarrjen e tyre zëvendësiministri i MTI, z.Avni Kastrati, zëvendësiministri i Integritimit Evropian, Ramadanllazi, profesori nga Vjena, Dr. Engelbert-Selenko, Prof. Jozef Bushati nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", ish-Ambasadori Shqipërisë në Kosovë, Prof. Dr. Islam Lauka e shumë zyrtarë të tjerë, pjesë e institucioneve shtetërore e akademike të Republikës së Kosovës.

Rektori i UBT-së, prof. dr.Edmond Hajrizi, duke folur në ceremoni theksoi:

Jemi shumë të nderuar që jeni pjesë e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme, e cila sigurisht është njëra prej elementeve më të veçanta në jetën e absolventëve tanë.

Kjo ceremoni është rezultat që del nga një përkushtim i juaji disaveçar për të studiuar dhe për të ndërtuar një dije dhe një personalitet nga njëri nga profesionet e zgjedhura nga ju, me qëllim të arritjes të një cilësie sa më të lartë jetësore për ju dhe për tërë shoqërinë tonë.

Ju e dini se nevoja për një lider është e pranishme kudo në botë e po ashtu edhe këtu në Kosovë. UBT mundësoi të zhvilloni një personalitet, të tillë që të jeni shumë të përgatitur profesionalisht, të jeni të përkushtuar në punë, të keni shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, të



ndërtoni partneritete me të tjerët, ta ndihmoni veten dhe shoqërinë.

Puna e UBT-së bazohet në fakte dhe në rezultate. Ka një aftësi të lartë kulturore dhe interdisciplinare, por ka edhe një komunikim modern bazuar në vlerat më të larta. Studimet në UBT kanë pikërisht këtë qëllim, ofrimin e veglave dhe kushteve për individë, në këtë rast studentit tonë, për të marrë vendime racionale dhe që i garantojnë atij sukses dhe rezultate, bazuar në vlerat më të larta ndërkombëtare.

Detyrë kryesore e jona është t'ia ofrojmë studentit tonë të gjitha kushtet dhe praktikën më të mira në shkencën e Menaxhimit, Biznesit, Ekonomisë, në ekselencë biznesore, në teknologjitë më moderne, mekatronikë, robotikë, programim,

rrjete, telekomunikacion, në dizajn, në drejtësi etj. Kjo është mundësuar nga një planprogram modern që UBT ka zhvilluar me vite, falë një bashkëpunimi të madh ndërkombëtar, planprograme që janë konform trendeve dhe zhvillimeve të fundit, njëkohësisht dhe në bazë të kërkesave që dalin nga tregu i punës, në bazë të nevojave që ka Kosova për profesionistë. Së dyti, UBT ka angazhuar një staf akademik me eksperiencë të lartë, me reputacion ndërkombëtar. Ky është viti i 14-të i punës dhe është gjenerata e 12-të që kur ne kemi filluar punën me studentë dhe studime. Ne kemi filluar me 28 studentë dhe sot kemi brenda vitit mbi 2500 studentë dhe prej atëherë dhe tani UBT vazhdon të ruajë pozitën e më të mirë në edukim, zhvillim, leadership, bursa, me përkrahje në punësim e shumë të tjera.

Ne mburremi me ju. Kemi pasur fatin që ju kemi sot këtu. Me angazhimin e juaj, ju ia kemi dalë të thyeni bllokadën dhe pengesat e shumta, duke u shndërruar në ambasadorë të vendit tonë, duke bindur se në Kosovë ka studentë të mirë.

UBT nuk është diplomë, është sukses, është prestigj, është krenari... Kjo është si rezultat i angazhimit tuaj dhe ne do të vazhdojmë që këto suksese t'i bartim edhe në gjeneratat e tjera, tha ndër të tjera Rektori Hajrizi.

Zëvendësiministri i MTI, z.Avni Kastrati, duke iu drejtuar studentëve theksoi: "Shpreh kënaqësinë e veçantë që

gjendem këtu, në momentin kur këta studentë mbyllin një kapitull dhe fillojnë një tjetër. Më kujtohet, para 40 vitesh, kur kam përfunduar studimet, në çfarë kushtesh kemi diplomuar. Me të vërtetë kam emocione kur e shoh se UBT po zhvillohet, por asnjëherë s'kemi menduar që mund të kemi kaq shumë studentë. Sot është një ditë kur ju festoni sukseset tuaja. Studimet i keni kryer, por para jush është jeta. Jeta është e vështirë, por organizohuni që të jetoni mirë".

"Është një ditë e përfundimit të një arritjeje tuaj, është një ndjenjë, por kjo ndjenjë ka një afat. Nga nesër është një ndjenjë tjetër, ndjenjë e përgjegjësisë. Secili nga ne ka një barrë për të ndryshuar vendin ku është, pastaj kreu botën. Në institucionin nga i cili unë vij, jemi të përkushtuar sa më shumë për t'u afruar me Evropën", tha ndërkaq zëvendësiministri i Integritimit Evropian, Ramadanllazi.

Në vazhdim të ceremonisë foli profesori nga Vjena, Dr. Engelbert Selenko, i cili ka një angazhim të gjatë në UBT dhe është shumë i familjarizuar me studentët. "Unë po vij nga Vjena dhe ndihem shumë i nderuar që e kam ndihmuar UBT. Unë erdha herën e parë, me gjithë optimizmin që kishte z. Hajrizi për të bërë diçka në Kosovë. Shteti juaj dhe optimizmi ka përparuar shumë këto 15 vite. Dikur edhe unë isha në vendin tuaj, po e pyesja veten se ku do të jetë vendi im në shoqëri. Më dukej se ishte

një sistem i mbyllur. Si sot më kujtohen ndjenjat që kisha. Më kujtohet mësimi i parë që kisha në Universitetin e Vjenës në ekonomi. Profesori foli për një orë, shikoi audiencën dhe tha: Më duket se askush nuk ka kuptuar asgjë". Pastaj, për ta thjeshtësuar, ai na tha: "Një menaxher i mirë nuk duhet t'i dijë të gjitha gjërat, por ai duhet të dijë të zgjedhë atë të duhurën për punën e duhur", theksoi Profesor Selenko.

Ceremoninë e nderoi me një fjalë edhe Dr. Jozef Bushati nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". "Ju uroj nga stafi i universitetit "Luigj Gurakuqi". UBT në këto 14 vite është orientuar nga modelet e përparuara, ju të gjithë së bashku keni vënë të gjithë energjitë tuaja drejt dijes dhe zhvillimit. Ju jeni autorë dhe përjetues të arritjeve të mëdha. Ky vit akademik ishte një vit i gjithëpërfshirjes së personelit administrativ në të gjitha nivelet për rritjen e cilësisë në shërbim të studentëve. Studentët janë fuqia e ndryshimit", u shpreh Dr. Bushati.

Në emër të Alumnit të UBT-së foli Leana Mahmuti, që ka kryer arkitekturën në UBT, ndërsa në emër të kolegëve të diplomuar sot falënderoi Armira Fetoshi.

Manifestimi është përcjellë me pika të zgjedhura muzikore, ndërsa madhështinë atij ia kanë shtuar mysafirët e shumtë, prindër të cilët kanë madhështuar ceremoninë e diplomimit.

Po kështu, gjatë kësaj ceremonie janë shpallur edhe studentët e dalluar të departamenteve, të cilët janë nderuar me certifikata.

Në vijim, lista e studentëve të dalluar:

Armira Fetoshi, Teuta Dervishi, Kaltrina Mehmeti, Florian Piraj, Zana Govori, Driton Begisholli, Alma Feka, Dodona Blakaj, Dina Demiri, Bardha Meta, Fistina Bllaca, Kaltrina Rexhepaj, Sokol Deçani, Fjolla Abazi, Zana Rrmoku, Armend Begisholli, Blerina Berisha, Egzona Morina-Thaqi, Ardi Hyseni, Learta Stavileci, Arta Abdyli, Vesa Shasivari, Gentrit Krasniqi, Donjeta Duraj, Marigona Xhemaili, Albulena Hyseni, Donika Xhakli, Magbule Rizani, Luiza Hoxha, Ruhada Emini, Doruntina Mejzini, Besart Jashari, Festina Avdija, Drenushë Thaçi, Zana Prelvukaj, Donika Ismaili, Fiton Zogaj, Diana Sahiti, Leoranda Arapi, Majlindë Jahiu, Liridon Vrapca, Rinor Svarça, Trinë Ismajli, Anita Nika, Etleve Arifi, Egzona Jonuzi, Gentian Zogaj, Nora Lika.

Besart Troshupa





NË CEREMONINË E ORGANIZUAR NË TIRANË

# REKTORI I UBT-SË, DR. EDMOND HAJRIZI U NDERUA ME ÇMIMIN ICT AKADEMIKU I VITIT NGA ALBANIAN ICT AWARDS

Në ceremoni u nderuan edhe tre përfaqësues të tjerë nga UBT, studentët MuhamedRatkoceri, Arlind Hajredinaj dhe Altin Ukshini

18 maj. - Rektori i Universitetit për Biznes dhe Teknologji, dr.Edmond Hajrizi u nderua me Çmimin ICT Akademiku i Vitit, në ceremoninë e organizuar në Tiranë për ndarjen e çmimeve nga Albanian ICT Awards. Në ceremoni u nderuan edhe tre përfaqësues të tjerë nga UBT, studentët MuhamedRatkoceri, Arlind Hajredinaj dhe Altin Ukshini.

Albanian ICT Awards u finalizua me mbrëmjen gala tradicionale, ku u bë edhe kurorëzimi i fituesve në shtatë kategori. Ky konkurs mbarëkombëtar, njëkohësisht edhe vlerësimi më i lartë individual në sektorin e teknologjisë informative në hapësirën mbarëshqiptare, finalizoi përpjekjet disamujore në kërkim të yjeve inovatorë të tekno-



logjisë së informacionit në mbarë trevat shqipfolëse.

“Dr.Edmond Hajrizi është themelues, President dhe CEO në Universitetin për Biznes dhe Teknologji; Instituti për Ndërmarrësi, Menaxhment dhe Inxhinieri; Agjencia e Kosovës për Menaxhment; themelues i Librarisë së UBT-së me mbi 200.000 libra – më e madhja në trojet shqiptare. Z. Hajrizi ka një CV të shkëlqyer akademike”, tha kryetarja e Jurisë,

Prof. Dr. KozetaSevrani, me rastin e dhënies së Çmimit për Presidentin e UBT-së.

Në ceremoni u nderuan edhe tre përfaqësues të tjerë nga UBT, studentët MuhamedRatkoceri, Arlind Hajredinaj dhe Altin Ukshini.

Kështu, MuhamedRetkoceri me një projekt në fushën e Inteligjencës Artificiale, mori diplomë si i nominuar në kategorinë “ICT Diploma e Vitit”.

Z.Ratkoceri gjithashtu u nderua me medalje për kontribute të veçanta për sektorin e ICT në Shqipëri. Ai e mori medaljen për arritjet në NASA Space Apps Challenge me çmimin “People’s Choice Award”.

Me medalje për kontribut në sektorin e ICT u nderua edhe studenti i UBT-së, Altin Ukshini (Prishtina HackerSpace).

Studenti tjetër i UBT-së, Arlind Hajredinaj u nderua me medalje si i nominuar për Çmimin “ICT Mobiliteti i Vitit”, me aplikacionin “AutoShkolla”.

Ndryshe, në ceremoninë madhështore të organizuar për të tretin vit rresht në Tiranë, morën pjesë ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike të Shqipërisë, Milena Harito, zëvendësministrja e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë, Rita Haizeraj, ish-ministri Mirëqenies Sociale dhe Rinisë së Shqipërisë, Erion Veliaj, përfaqësues të trupit diplomatik të SHBA-ve, udhëheqës të bizneseve dhe

organizatave të industrisë së TIK nga Shqipëria e Kosova, si dhe profesionistë të IT-së, akademikë, përfaqësues të universiteteve dhe medias.

Në ceremoni u dhanë edhe çmime të tjera. Kështu, çmimin fituesi i ICT Inovacioni i Vitit, ishte Mërgim Cahani nga kompania “Gjirafa”. Në kategorinë ICT Ylli në Ngritje i Vitit fitues u shpall 16-vjeçarit Kelvin Çobanaj nga Durrësi. Çmimin ICT Mobiliteti i Vitit e fitoi Bledar Bregu, themelues i “FindIt.al”. Fituese e çmimit ICT Diploma e Vitit ishte Mirgita Frashëri nga Tirana. ICT Shërbimi Publik i Vitit në Shqipëri shkoi për Ministrinë e Mirëqenies dhe Rinisë, ndërsa për Kosovën shkoi për Administratën Tatimore të Kosovës, që u shpall fituese me projektin Deklarimi Elektronik i Tatimeve. Mirënjohja për Femrën në sektorin ICT iu dha Lindita Shomos, ndërsa për kontribute të veçanta për sektorin e ICT në Shqipëri u nderuan edhe Ludovik Laventure MPAY, Arber Rrapi doktorim.com, Frenki Ktona dhe Krenare Shala.



## ICT Awards konfirmon edhe një herë se UBT është lider në fushën e ICT dhe të Inovacionit

Ceremonia e dhënies së çmimeve për kontribut në fushën e teknologjisë informative, organizuar nga Albanian ICT Awards në Tiranë, dëshmoi edhe një herë faktin se Universiteti për Biznes dhe Teknologji, duke dominuar në çmime dhe mirënjohje në disa kategori, është lider në fushën e teknologjisë informative dhe të informacionit.

Dhënia e pesë çmimeve për përfaqësuesit e UBT-së në këtë ceremoni, me një pjesëmarrje të gjerë figurash të rëndësishme nga jeta politike dhe nga jeta e shkencës, dëshmoi edhe një herë se UBT, me angazhimin e pandalshëm shumëvjeçar, ia ka dalë të vihet pa asnjë mëdyshje në krye, duke shënuar rezultate të dukshme në fushën e teknologjisë informative dhe të inovacionit.

Të përkujtojmë se rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi u nderua nga Albanian ICT Awards me Çmimin ICT Akademiku i Vitit, një çmim ky prestigjioz, ndërsa, në një konkurrencë shumë të madhe të tënominuarve, shkëlqyen edhe tre studentë të UBT-së, të cilët morën gjithsej katër mirënjohje, duke e ngritur në pesë numrin e përgjithshëm të çmimeve të marra nga UBT në edicionin e tretë të Albanian ICT Awards.

MuhamedRetkoceri me një projekt në fushën e Inteligjencës Artificiale, mori diplomë si i nominuar në kategorinë “ICT Diploma e Vitit”. Ai gjithashtu u nderua me medalje për kontribute të veçanta për sektorin e ICT në Shqipëri. Ai e mori medaljen për arritjet në NASA SpaceAppsChallenge me çmimin “People’sChoiceAward”. Me medalje për kontribut në sektorin e ICT u nderua edhe studenti i UBT-së, Altin Ukshini (Prishtina HackerSpace). Studenti tjetër i UBT-së, Arlind Hajredinaj u nderua me medalje si i nominuar për Çmimin “ICT Mobiliteti i Vitit”, me aplikacionin “AutoShkolla”.



## BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I UBT-SË

### Edhe qindra mijëra euro mundësi bursash për studentët e UBT-së



6 qershor. - Studentëve të UBT-së u shtohet edhe një mundësi e re, krahas shumë mundësive për bursa e mobiliteteve në institucionet më prestigjioze akademike botërore.

Së fundi, është konfirmuar se, në kuadër të Programit “Erasmus+ Global Mobility and KnowledgeAlliances”, studentët e UBT-së mund të përfitojnë bursa në universitetet e Norvegjisë, në vlerë prej qindra mijëra euro.

Programi “Erasmus+ Global Mobility and KnowledgeAlliances” ofron mobilitetin e stafit dhe të studentëve mes UBT-së dhe universiteteve nga Norvegjia, një mundësi unike që ofrohet bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar, fushë në të cilën UBT është prijatë në vend dhe në rajon, duke krijuar mundësi unike për studentët e tij.

Ky program është vazhdimësi e programit “Erasmus Mundus” të BE-së, që ka për qëllim shkëmbimin e njohurive dhe përvojave mes studentëve dhe stafit të institucioneve akademike. UBT në vazhdi-

mësi ka qenë pjesë e këtyre iniciativave evropiane dhe deri tash një numër i madh i studentëve dhe stafit akademik ka përfituar nga eksperiencat akademike më pozitive.

Kjo ka ndikuar që stafi dhe studentët e UBT-së të jenë të krahasueshëm me kolegët e tyre në universitetet partnere evropiane, që i ka bërë ata të dallueshëm dhe u ka mundësuar të jenë shumë të kërkuar në tregun e punës në Kosovë.

Po në kuadër të këtij programi, UBT pret që shumë shpejt për studentët e tij të sigurojë bursa për mundësi vazhdimi të studimeve edhe në universitetet partnere në shtete të tjera.

Përveç kësaj, një nga universitetet partnere të UBT-së, Universiteti “Gjøvik” në Norvegjia parajmëruar vazhdimin e bashkëpunimit edhe në projektin AEP (Programi për Shkëmbime Akademike), duke konfirmuar se bashkëpunimi paraprak me UBT-në ka qenë frytdhënës dhe i dobishëm për të dy institucionet akademike.

Përmes këtyre shkëmbimeve akademike, UBT mëton të harmonizojë hapat dhe të gjenerojë dije të reja e të ofrojë mundësi të reja dhe unike për studentët dhe stafin.



REKTORI I UBT-SË, DR. EDMOND HAJRIZI MORI PJESË NË PUNËTORINË "MASAT E SIGURISË"

# UBT PREZANTOI QENDRËN PËR SIGURI KIBERNETIKE DHE PRIVATËSI

Para të pranishmëve të shumtë, rektori Hajrizi prezantoi Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, e cila funksionon në kuadër të UBT-së, dhe foli në detaje për rëndësinë e padiskutueshme të mbrojtjes së të dhënave në epokën digjitale dhe për mundësitë që ofron Qendra e krijuar nga UBT në këtë fushë

8 prill.- Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi mori pjesë në punëtorinë "Masat e Sigurisë", në kuadër të diskutimeve për Privatësinë në Epokën Digjitale, të organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Para të pranishmëve të shumtë, rektori Hajrizi prezantoi Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, e cila funksionon në kuadër të UBT-së, dhe foli në detaje për rëndësinë e padiskutueshme të mbrojtjes së të dhënave në epokën digjitale dhe për mundësitë që ofron Qendra e krijuar nga UBT në këtë fushë.

Ai theksoi se kjo qendër do të shërbejë si pikë referencë për zhvillimin e diskutimeve në këtë fushë dhe për dhënien e këshillave për të gjitha institucionet e interesuara dhe në të gjitha nivelet.

UBT, tha rektori Hajrizi, ka aktivitete të hershme në fushën e sigurisë, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me universitetet norvegjeze, që ka rezultuar me një përvojë dhe hulumtim me shumë interes.

Ai gjithashtu përkujtoi se UBT ka një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me të cilën do të bashkëpunojë edhe në të ardhmen, në projekte të ndryshme.

Bashkëpunimin e mirë mes këtyre dy institucioneve e theksoi edhe z.MentorHoxhaj nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili bëri një prezantim të gjatë në temën e masave të sigurisë së të dhënave.

"Çështja e sigurisë më nuk është temë për të diskutuar nëse është apo nuk është e arsyeshme, edhe në nivelin global, edhe në nivelin evropian edhe në nivelin kosovar. Motivimi ynë se ne kemi pasur një projekt katërveçar me Norvegjinë dhe me disa universitete në regjion dhe kemi punuar shumë në fushën e sigurisë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, kemi programin në fushën e sigurisë dhe themelimin e kësaj qendre. Edhe norvegjezët para një viti kanë themeluar qendrën e tyre në këtë fushë, ku i kanë ndërlidhur të gjitha palët e interesit", tha ai.

Z.Hajrizi theksoi në vijim se UBT është shkolla më e madhe e



IT-së dhe fushat që ofrohen në UBT lidhen mjaft shumë me sigurinë, përfshirë këtu studimet në nivele të ndryshme dhe hulumtimet e shumta.

"Nuk është vetëm siguria në aspektin teknik, por është edhe në aspektin e politikave, në aspektin e standardeve, në aspektin e sistemeve. Është një sistem shumë disiplinuar dhe është shumë e rëndësishme që ne, nga të gjitha fushat, t'i qasemi dhe të merremi me këtë punë. Ne na intereson hulumtimi dhe zhvillimi, sepse e kemi obligim të punojmë në këtë fushë. Na intereson të punojmë edhe në ngritjen e kompetencave profesionale në Kosovë, sepse e shohim se kjo kompetencë mungon, pasi është një fushë e re. Por, konsiderohet si një fushë që do të gjenerojë vende të shumta të reja punës. Do të ketë kërkesa të shumta për personat që merren me sigurinë", vijoi Hajrizi.

Dr.Hajrizi theksoi në vazhdim se kjo qendër e UBT-së mund të ndihmojë në përmbushjen e standardeve, përdorimit të praktikave të mira, kriterëve ndërkombëtare të kërkuara në fushën e sigurisë kibernetike dhe privatësisë. Ai tha se standardet janë mjetet më të mira

të cilat ne mund t'i përdorim për një kualitet më të mirë të punës.

"Ne kemi misionin dhe vizionin tonë. Qëllimi është që të merremi me disa aktivitete, edukimin, shqyrtimin profesional, hulumtimin dhe zhvillimin, certifikimet e sistemeve sipas standardeve, certifikimet e individëve sipas standardeve dhe praktikave më të mira. Një temë mjaft e rëndësishme është procesimi i të dhënave, hulumtimeve, publikimi i atyre dhe promovimi i temave që lidhen me këtë fushë", tha Hajrizi.

"Qendra për Siguri Kibernetike dhe Privatësi nuk ka synim që të jetë vetëm qendër e UBT-së. Ajo do të jetë një qendër nacionale, ku ndërlidhen palët e interesit", theksoi më tej Hajrizi, duke shtuar se ajo do të shërbejë si një mundësi debati dhe pune të përbashkët për çështjet që mbulon fusha e sigurisë së informacionit.

Ai tha se janë një varg kompetencash nga kjo fushë, gjithsesi e re, shumë sfida të cilave duhet dhënë përgjigje, si në nivelin institucional ashtu edhe në nivelin shtetëror, si në nivelin akademik ashtu edhe në nivelin praktik të krijimit të kuadrit në këtë fushë, që është kuadër spe-

cifik. Ndaj, krijimi i kësaj qendre synon pikërisht këtë – përgjigjen ndaj sfidave në një fushë të re, por me shumë interes dhe me shumë rëndësi.

Z.Hajrizi paralajmëroi një punëtorinë nga 20-22 prill, ku do të trajtohen një varg temash me interes nga fusha e sigurisë kibernetike dhe privatësisë.

Ai theksoi se UBT ka të akredituar në studimet master programin Siguria e Informacionit dhe Privatësia, që është programi i parë i akredituar në këtë fushë jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, si dhe shumë drejtime të tjera të studimit, si Shkencat kompjuterike, Sistemet e Informacionit. Nisur nga kjo, ekziston një bazë e mirë që të krijojmë disa kuadro në këtë fushë.

UBT ka edhe laboratorët në kuadër të Kampusit Inovativ të UBT-së, ku ka një grup të pajisjeve dhe një hapësirë shumë e mirë për hulumtime në këtë fushë, tha ndër të tjera rektori i UBT-së, gjatë prezantimit të Qendrës për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, në punëtorinë e organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## NË PRAGË TË ÇEKISË

### STUDENTË TË UBT-SË NË PUNËTORINË "CYBER SECURITY EXERCISES"

6 qershor. - Një numër studentësh të UBT-së kanë marrë pjesë në punëtorinë "Cyber Security Exercises", organizuar në Pragë të Çekisë më 29 dhe 30 qershor. Punëtorinë është organizuar në kuadër të projektit transregional të financuar nga Komisioni Evropian "Enhancing CyberSecurity", përfutues të të cilit janë Republika e Kosovës, ajo e Maqedonisë dhe ajo e Moldavisë.

Njëri nga studentët e UBT-së, pjesëmarrës në punëtori, Atdhe Buja theksoi se punëtorinë është shumë e rëndësishme për përballjen e trajtimin më tutje të sulmeve kibernetike si Networkforensics, Phishingattack dhe Largescale incident handling.

Vlen të theksohet se nga pjesëmarrësit nga Kosova shumica ishin studentë të UBT-së.

Pas punëtorisë, studentët dhe gjithë pjesëmarrësit nga Kosova në këtë punëtori vizituan Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë, ku u pritën nga diplomati Adriatik Kryeziu dhe u njohën më shumë për punën që bën Ambasada e Kosovës në këtë shtet.



## QENDRA PËR SIGURI KIBERNETIKE DHE PRIVATËSI E UBT-SË PIKË REFERENCË NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

18 qershor. - Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar në Prizren nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Dedikuar mbrojtjes së të dhënave personale në fushën e shëndetësisë, konferenca u organizua në Prizren.

Dr. Hajrizi, duke qenë një nga folësit kryesorë në konferencë, prezantoi Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, e cila funksionon në kuadër të

UBT-së dhe mundësitë që kjo qendër ofron në mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha fushat, me theks të veçantë në fushën e shëndetësisë.

Në cilësinë e partnerit të konferencës, e cila mbledhi rreth 180 pjesëmarrës, z.Hajrizi foli për sfidat në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe sigurinë kibernetike, në kohën e zhvillimeve të hovshme të teknologjisë.

Ai theksoi se Qendra për Siguri Kibernetike dhe Pri-

vatësi e UBT-së, e krijuar pas një përvoje dhe bashkëpunimi të gjatë me universitete dhe qendra ndërkombëtare të kësaj fushe, ofron ekspertë dhe ekspertizë profesionale vendore dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Ai gjithashtu tha se kjo qendër nuk ka synim që të jetë vetëm qendër e UBT-së, por ajo do të jetë një qendër nacionale, ku ndërlidhen palët e interesit.



NË ORGANIZIM TË UBT-SË DHE ASOCIACIONIT AUSTRIAK-KOSOVAR, KLUBIT ALPBACH KOSOVË DHE ME MBËSHETJE NGA AMBASADA E AUSTRIËSË NË PRISHTINË

# NË UBT I ZHVILLOI PUNIMET KONFERENCA "DITËT AUSTRIAKE-KOSOVARE 2015"

Prishtinë, 11 mars. - "Ditët Austriake-Kosovare 2015" ishte konferenca dyditore ndërkombëtare, që i zhvilloi punimet në lokalet e UBT-së në Prishtinë dhe në të cilën morën pjesë përfaqësues nga qeveria austriake, institucione të tjera të këtij shtetit, si dhe përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Konferenca është organizuar nga UBT, në bashkëpunim me Asociacionin Austriak-Kosovar, Klubin Alpbach Kosovë dhe me mbështetje nga Ambasada e Austrisë në Prishtinë si dhe anëtarët e Shoqërisë austriake të Kosovës në Kosovë dhe akterët kyç austriakë që mbështesin Kosovën.

Ndër temat kryesore që u shtruan për diskutim gjatë sesionit të hapjes dhe gjatë dy ditëve të konferencës, ishin: E ardhmja evropiane e Kosovës; Përvojat e Austrisë si një shtet që shënon 20-vjetorin e anëtarësimit në BE; Sfidat e Kosovës sot në rrugën drejt Bashkimit Evropian; E-Qeverisja si bazë për Qeverisje të Mirë; E-Qeverisja si bartëse e reformës në fokus në kujdesin shëndetësor; E-Arsimi si faktor kyç për reformimin e Arsimit në Kosovë; Bashkëpunimi ekonomik midis Austrisë dhe Kosovës, Reforma ekonomike në bazë të e-Qeverisjes si faktor kyç për investime të mëtejshme të Austrisë në Kosovë; E-Qeverisja dhe bashkëpunimi në inovacion ndërmjet Austrisë dhe Kosovës, si faktor kyç për menaxhim urban dhe kadastër etj.

Në hapje të konferencës, rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, si dhe të gjithë bashkorganizatorët e kësaj konference, që ofron tema me shumë interes për opinionin kosovar dhe më gjerë.

Z. Hajrizi theksoi se Universiteti për Biznes dhe Teknologji ka ndërrin që të jetë nikoqir i Partneritetit Austriak-Kosovar, dhe e vlerësoi këtë konferencë si ngjarje të rëndësishme që ka për qëllim promovimin dhe implementimin e menaxhmentit të integruar.



Ai u shpreh se në Kosovë ka një dinamizëm të lartë, sistem të ri dhe një gjeneratë të re, ndërsa ndër pikat kryesore që theksoi si prioritet ishin teknologjia, globalizmi dhe resurset humane.

"Leadershipin do ta transformojmë në partneritet me vendet e Evropës", tha ndër të tjera z.Hajrizi.

Ministri i Administratës Publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z.Mahir Ya cilar, theksoi se institucionet dhe qytetarët e vendit tonë synojnë një Kosovë evropiane.

"Si Qeveri e Kosovës, si Ministri e Administratës Publike, jemi të gatshëm ta çojmë përpara përdorimin e teknologjisë informative, por edhe të krijojmë njerëz të cilët janë të gatshëm ta përdorin teknologjinë informative, E-Qeverisjen, që ta ndërtojmë një Kosovë evropiane", theksoi ministri Ya cilar.

Ai falënderoi organizatorët për organizimin e kësaj konference ndërkombëtare për qeverisje elektronike, me rëndësi të jashtëzakonshme për vendin, për avancimin dhe zhvillimin e qeverisjes elektronike në Kosovë.

"Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur të bëjë reformë të administratës publike dhe të avancojë qeverisjen elektronike, përmes proceseve administrative dhe digjitalizimit të këtyre proceseve, ku synohen shërbime më cilësore, përdorimi më efikas te

ndërmarrjet publike, për procese më efikase dhe më të shpejta të qeverisjes. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar dokumente strategjike dhe akte të tjera që ndihmojnë fushën elektronike të komunikimeve dhe shërbimeve elektronike. Në vitin 2008 është miratuar Strategjia për E-qeverisje dhe kemi filluar dhe do të vazhdojmë hartimin e strategjisë në periudhën e ardhshme 5-vjeçare, që është një hap i strategjisë dhe reformës së administratës publike dhe vazhdimin e strategjisë për inovacionin", tha ndër të tjera ministri i Administratës Publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z.Mahir Ya cilar.

Në vazhdim foli z.Christian Rupp, koordinator i Qeverisë së Austrisë për qeverisje elektronike. Ai e vlerësoi Kosovën si një vend me bazë të mirë të zhvillimit, ndërsa theksoi se UBT i ka kushtet dhe premisat për të qenë i suksesshëm.

Duke folur për zhvillimin e teknologjisë në përgjithësi, ai u shpreh se në këtë drejtim menaxhmenti luan rol të rëndësishëm. "Teknologjia është pjesë e vogël, mund të them 20 për qind dhe pjesa tjetër, 80 për qind, është ndryshimi i menaxhmentit. Për të qenë i suksesshëm duhet ndryshim i menaxhmentit, forcë ndryshuese (një menaxher

i mirë) dhe siguri i informacioneve", tha ai.

Ai u shpreh i kënaqur edhe me sistemin elektronik që ofrojnë shërbimet elektronike. "Sektori publik dërgon dokumente zyrtare në mënyrë elektronike, çdo pyetje e përgjigje prej klientëve duhet ti kemi në formë elektronike. Pranojmë vetëm faturat elektronike, jo aty të shtypura dhe kjo është bazë ligjore", tha ndër të tjera z. Rupp.

Kujtim Gashi nga Agjencia Kosovare për Shoqëri të Informacionit, pasi foli për bazën ligjore që mbulon këtë fushë, të miratuar gjatë vitit 2013 dhe 2014, theksoi se është krijuar një bazë e mirë që edhe institucionet e Kosovës të ecin drejt modernizimit të sektorit publik.

"Dokumentet e rëndësishme strategjike të qeverisjes elektronike janë dokumente të cilat legjislativi i Kosovës dhe Qeveria i ka aprovuar si dokumente të rëndësishme në drejtim të zhvillimit të e-qeverisjes në Kosovë", tha ai.

Ai përmendi një varg ligjesh të miratuara, ndër të cilët veçoi Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, që është një ligj i rëndësishëm për këtë fushë dhe një dokument i me rëndësi të veçantë.

Z.Gashi theksoi në vijim se është duke u punuar në nxjerrjen e strategjisë së re, që do të shënojë përmirësim të dukshëm në këtë fushë.

Një mysafire e veçantë në konferencë ishte edhe Adriana Boersma, menaxhere e rrjetit të "Microsoftit" në mbi 20 shtete.

Fillimisht, znj. Boersma foli për rëndësinë e Microsoftit për jetën e njerëzve dhe qasje sa më të lehtë të të dhënave të shërbimeve online.

"Është nder të jem këtu. Kosova është një vend i bukur, me sfida dhe mundësi të mira për zhvillim në fusha të ndryshme. Pajisjet e reja teknologjike njerëzve u kanë ofruar lehtësim në ofrimin e shërbimeve elektronike. Studentëve u kanë ofruar mundësi dhe qasje në mësimnxënie", tha Adriana Boersma.

Ajo theksoi se teknologjia informative ka potencial të lartë në mbrojtjen e të dhënave, të sigurisë dhe të shërbimeve të ICLOUD. Sipas saj, Microsoft mundëson arritjen e objektivave, kalimin e sfidave dhe vështirësive, me eficiencë më të madhe të ofrimit të shërbimeve elektronike.

Znj. Boersma e falënderoi dhe e mbështeti Presidentit e UBT-së për këtë partneritet në fushën e teknologjisë dhe zhvillimit të saj dhe shfaqti dëshirën që të ndihmojë sa i përket këtij sektori të shërbimeve dhe të dhënave.

"Duam t'ju ndihmojmë edhe juve që të krijoni mundësi të mira në sferën dhe sektorin e shërbimeve publike dhe elektronike", tha ndër të tjera zonja Adriana Boersma.

Ndërsa, Mentor Hoxhaj nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, theksoi ndër të tjera se një ndër detyrat kryesore të kësaj agjencie është gjetja e balancit mes transparencës dhe privatisimit.

Kjo, tha ai, është një sfidë e vazhdueshme, e cila ka ardhur edhe me zhvillimin e teknologjisë informative ashtu edhe të transparencës që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes.

"Gjetja e këtij balanci është një sfidë e vazhdueshme. Jemi duke tentuar që ta gjejmë dhe jemi duke punuar në këtë drejtim. Për të kuptuar më mirë sfidat në tërësi dhe mundësitë të cilat i kemi së bashku, duhet të kuptojmë edhe në cilën botë jemi duke jetuar. Jemi duke jetuar në botën e rrjetëzuar, jemi të digjitalizuar tërësisht me identitetet tona, lokacionet e veprimt, shoqërimin, të gjitha të ruajtura në BIT dhe BYTE. Sasia e informacioneve të gjeneruara brenda ditës është një sasi jashtëzakonisht e madhe. Gjersa në vitin 2013 janë gjeneruar 4 trilionë gigabajt, në vitin 2014 kemi dyfishim të kësaj shifre, 8 trilionë gigabajt", tha ndër të tjera z.Hoxhaj.

## ADRIANA BOERSMA: "INTERNETI JU KA NDIHMUAR NJERËZVE NË NDRYSHIMIN E BOTËS"

Adriana Boersma, menaxhere e rrjetit të "Microsoftit" në mbi 20 shtete, pas fjalës në konferencën "Ditët Austriake-Kosovare 2015", u përgjigj në disa pyetje për gazetën e studentëve "UBT News"

E pyetur sa kjo konferencë ka ndihmuar të rinjtë që ta kuptojnë rëndësinë dhe të mirat e rrjetit elektronik, ajo tha: "Para së gjithash mendoj se është një mundësi e madhe për studentët që të marrin pjesë dhe të kenë mundësi të shohin ide të reja nga vendet e jashtme. Studentët patën mundësi të mësojnë sadopak në lidhje me privatisimin, sigurinë, transparencën, që janë shumë të rëndësishme dhe krijimin e së ardhmes në Kosovë. Shpresoj se Microsofti mund të japë një platformë që të keni sukses në punën parë të mjedisit".

"Unë mendoj se interneti ju ka ndihmuar njerëzve në ndryshimin e botës. Njerëzit, si për shembull studentët, e kanë më të lehtë dhe ata po e ndryshojnë botën, sepse e kanë një platformë të quajtur Internet dhe ajo po ndryshohet dita-ditës me ide të reja", vijoi znj. Boersma.

E pyetur lidhur me mundësitë që ofrohen për ruajtjen e të dhënave në servere të kompanive të mëdha, jo u përgjigj: "Nuk ka nevojë të keni bazë të të dhënave, por ICLOUD ju ofron shërbime që të keni të dhëna dhe informacione të sigurta sikur sot që ju treguan përfaqësuesit e MICROSOFT-it. Nuk keni nevojë të brengoseni për gjërat që jeni të interesuar t'i mbani, t'i ruani dhe t'i arrini. Nuk keni nevojë të brengoseni me teknologjinë informative. Ju e dini se në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë mund të jeni në gjendje që me Microsoft ICLOUD të mbronit të dhënat. Ju mund të jeni produktivë duke përdorur platformën e Microsoftit dhe të filloni të punoni me ide të reja".

Tekstin e përgatitën: Albina Zeneli, Besart Troshupa, Drin Jakurti



KONFERENCA "DITËT AUSTRIAKE-KOSOVARE 2015"

# TEKNOLOGJIA NË SHËRBIM TË SHËNDETËSISË DHE TË EDUKIMIT



**Prishtinë, 11 mars.** - Konferenca "Ditët Austriake-Kosovare 2015", e moderuar nga presidenti i Asociacionit Austriak-Kosovar, Gunther Fehlinger, i ka vazhduar diskutimet në temën e E-Shëndetësisë dhe E-Edukimit dhe përparësitë e tjera që ofron teknologjia informative në të gjitha fushat.

Në këtë vazhdë, për përdorimin e e-teknologjisë në shëndetësi foli z.Olegas Niaksu nga Lituania, i cili paraqiti për një varg përvojash nga projektet në e-shëndetësi në Shqipëri dhe sidomos në disa vende të Afrikës, ku ai ka marrë pjesë në zbatimin e tyre.

"Para 17 vitesh në Afrikë ne e filluam regjistrimin e pacientëve në sistemet spitalore. Qytetarët presin shërbime shëndetësore efektive, pritet dhe synohet përkujdesi më i madh ndaj atyre që jetojnë në zonat rurale. Ajo çfarë ne kemi tentuar ta bëjmë në Afrikë, pasi që atje dihet se sëmundjet ngjitëse janë më të shpeshta, ishte që të krijojmë qendra të parandalimit të sëmundjeve e jo qendra shëruese nga to", tha z.Niaksu.

"Investimet nga shtetet e ndryshme bënë që të rregullohej rrjeti i mbingarkuar dhe të krijohej një sistem spitalor i cili tashmë lidh jo vetëm qytetet por edhe shtetet", tha Olegas Niaksu.

**Edmond Hajrizi: "Zgjidhja e problemeve është arsimi"**

Z.Fehlinger e ftoi në vazhdim Presidentin e UBT-së, Edmond Hajrizi për ta marrë fjalën. Njëkohësisht e uroi atë për sukseset

në garat me robotët që luajnë futboll, ku UBT ka zënë vendin e parë në garë me shumë universitete nga e gjithë Evropa. "Ju keni një arritje të lartë, keni vendin e parë në robotikë", u shpreh Fehlinger.

Ndërsa, rektori Hajrizi vuri theksin te rëndësia e shpërndarjes së internetit. Ai tha se 85 për qind e territorit të vendit mbulohet me rrjet të internetit, që për UBT-në, si universiteti i teknologjisë është shumë e rëndësishme.

"Si shtet i ri, kemi ekspertë në lëmi të ndryshme, por janë të paktë në numër. Ne duam të kontribuojmë në këtë aspekt. Ne si organizatë e teknologjisë kërkojmë më të mirën, kërkojmë të gjejmë gjërat më të mira dhe të nxjerrim ekspertë të rinj. Kemi nisur në vitin 2001 kurse tash në vitin 2015 jemi shkollë më e madhe e teknologjisë në rajon. 800 studentë në drejtimet e teknologjisë janë shumë, por kjo krijon potencial të madh! Jemi të parët në Ballkan të certifikuar me çmimin për ekselencë, gjithashtu edhe me shumë certifikime të tjera për cilësi na ISO. Këto çmime ne nuk i kemi për t'i treguar por për të punuar me to. Kemi shumë programe për studim dhe këtë e konsiderojmë si përgjegjësi për edukimin e të rinjve", tha z.Hajrizi.

Ai tha se zhvillimi profesional bëhet me trajnime, si p.sh Cisco e tash edhe Microsoft e shumë të tjera. Pjesë tjetër e zhvillimit është që ne të arrijmë standardin dhe t'u afrohem liderëve të shkollimit botëror.

"Kampusi ynë njihet në mbarë Ballkanin si një ndër më të mëdhenjtë dhe me kushte shumë të mira për zhvillimin e studenteve", tha ndër të tjera Edmond Hajrizi.

Në konferencë foli edhe JovcePlastinovski përfaqësues i Microsoft në Maqedoni.

"Transparenca është ajo që ne e kemi kërkuar ndër vite në projektet tona. Kemi hequr fjalëkalimet e ueb-faqeve të shërbimeve zyrtare dhe në fillim ata thanë: Ju po e rrëzoni aplikacionin tuaj! Kurse ne u përgjigjëm: Le ta provojmë. Arritëm ta mposhtim korrupsionin dhe njerëzit ishin të lirë të aplikojnë për vende pune. Arritëm të krijojmë aplikacion për regjistrimin e biznesit nga laptopet, telefonat mobilë e pajisjet e tjera teknologjike", tha ai.

Shembuj të ndryshëm të sistemeve shëndetësore mori edhe zonja Elisabeth Campestrini, e cila tregoi që në muajin prill ajo, bashkë me disa kolegë të saj, do të mbajë një tjetër lloj të seminarit për E-shëndetësinë.

**Busek: Sfida e shoqërisë është edukimi**

Dr. Erhard Busek, President i Institutit për Rajonin e Danubit dhe Evropës Qendrore dhe ish Ministër i Arsimit i Austrisë, theksoi se sfida e shoqërisë është edukimi. "Duhet pranuar që kemi mungesë të resurseve, të vetmen dhuratë që e kemi është truri", tha Busek. Sipas tij arsimit është parakusht për zhvillimet e mëtutjeshme dhe duhet fushatë publike për arsimim.

"Po jetojmë në ndryshimin e kushteve që na rrethojnë. Telefoni mobil po na mundëson të komunikojmë me gjithë botën, të shprehim idetë dhe të shkëmbejmë përvojat tona. Pasi u shfaq interneti mund të lidhemi me njëri-tjetrin dhe kjo gjë është në favor të qenies njerëzore", tha z. Busek.

Ai tha se po jetojmë në tregun e botës dhe se konkurrenca është e dukshme. Që ta kuptojmë njëri-tjetrin së pari duhet ta dëgjojmë.

"Mua më bëjnë përshtypje në Kosovë se në çdo program kemi forume, diskutime të ndryshme. I konsideroj shumë të rëndësishme këto diskutime", tha Dr. Busek.

Ai përmendi edhe stafin akademik, që luan një rol mjaft të madh në avancimin e njohurive.

"Po pretendojmë të avancojmë profesorët me trajnime ku zhvillohen aktivitetet e ndryshme. Kemi mjaftueshëm buxhet por mungojnë vetëm njerëzit e shkolluar dhe gjithçka lidhet me shkollimin dhe arsimimin", theksoi Busek.

Në vazhdim foli edhe Blerim Rexha, mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, i cili u shpreh se gjeneratat e reja po e ndryshojnë botën dhe vuri theksin te përdorimi i internetit dhe rrjeteve sociale.

"Interneti nuk shërben vetëm që të postojmë gjëra nëpër rrjetet sociale, por edhe të gjurmojmë nëpër ueb-faqe të ndryshme të rëndësishme", tha z.Rexha.

Ai gjithashtu foli edhe për funksionin e teknologjisë infor-

mative në shërbim të edukimit dhe të shëndetësisë.

Ndërsa Elisabeth Schleicher, eksperte e tregut (E-Commerce), tha se ndihet e privilegjuar dhe ka nderin që t'i ndajë me studentët dhe me stafin akademik të UBT-së faktet dhe të dhënat për tregun botëror.

Gjatë prezantimit të saj, ajo u fokusua në të dhënat për kompaninë, vlerat e konsumatorit, mundësitë për Kosovën dhe mënyrën e funksionimit.

Në debatin për rolin e teknologjisë në fushën e edukimit, rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi, shpaloji të dhëna për zbatimin e teknologjisë në institucionin që ai drejton.

Në fushën e edukimit ai përmendi në UBT ai përmendi: E-edukimi, E-libraria, E-Administrata, E-Partneriteti, E-Cilësia, E-Orari, E-Pjesëmarrja, E-testet, E-Syllabuset, Stafii i UBT-së dhe studentët.

Në fushën e zhvillimit profesional: ICT Akademia, CISCO, Menaxhment, Biznes si dhe stafi E-Staff.

Në fushën e hulumtimeve: E-Publikimet, E-Dokumentimet, Interneti, UBT Radio.

Hajrizi përmendi edhe rëndësinë e partneritetit që ka UBT-ja me Universitetet tjera si dhe për projektin Erasmus Mundus, në të cilën Universiteti për Biznes dhe Teknologji është e anëtarësuar dhe studentët mund të marrin bursa për studime jashtë vendit.

**Albina Zeneli, Besart Troshupa, Drin Jakurti**



DITA E DYTË E KONFERENCËS "DITËT AUSTRIAKE-KOSOVARE 2015", ORGANIZUAR NË UBT

# BUSEK: DUHET TË SHIKONI ME NJË VIZION MË TË QARTË QË TË ZHVILLOHENI DHE TË BËHENI MË TË MIRËT

**Prishtinë, 11 mars.** - Konferenca "Ditët Austriake-Kosovare 2015", e moderuar nga presidenti i Asociacionit Austriak-Kosovar, Gunther Fehlinger, i ka vazhduar diskutimet në temën "Së bashku në Evropë - 20 vitet e Austrisë në BE dhe marrëdhënie austriak të Kosovës në këtë periudhë".

Folës të shumtë, kosovarë dhe austriakë, kanë folur për përvojat dhe të dhënat e bashkëpunimit Kosovë-Austri.

Presidenti i Asociacionit Austriak-Kosovar, Gunther Fehlinger foli për Qeverinë e re dhe fokusin e E-Qeverisjes, dhe qasjen e re të qytetarëve që do të kenë një nivel tjetër të besimit në Qeverinë e Kosovës.

**Eva Michlits: Azil kërkimi nuk është mjet për zhvillim ekonomik**

Në vazhdim, Eva Michlits, konsulle e Austrisë në Kosovë, ndër të tjera u shpreh se rruga e migrimit nuk është mjet për ta zhvilluar Kosovën dhe as bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Austrisë.

"Është kënaqësi t'ju flas për stabilitetin dhe të ardhmen e përbashkët të Evropës Juglindore. Austria dhe Kosova janë aleat shumë të afërt, miq. Austria ka bërë shumë që ta mbështesë Kosovën, pas luftës dhe në rrugëtim drejt pavarësisht, si dhe në rrugën e Bashkimit Evropian", tha ajo.

Në vazhdim, ajo foli për valën e azilkerkuesve ilegalë nga Kosova drejt Austrisë dhe vendeve të tjera të Bashkimit Evropian, që sipas saj ishte një veprim i papritur dhe i befasishtëm.

"Azil kërkimi nuk është mjet për zhvillim ekonomik. Ne e dimë që duhet të bëhet shumë në Kosovë, por kjo qasje është imazh i keq për Kosovën dhe Austrinë, kështu që të punojmë së bashku që ta zhvillojmë Kosovën dhe mos ta shfrytëzojmë të drejtën e azilit në Austri. Austria ka filluar një fushatë të madhe dhe ka treguar rezultate", vijoi ajo.

Ajo tha një bashkëpunim edhe më i mirë Austri-Kosovë mund të ndihmojë për t'i shmangur këto befasi.

"Austria ka bërë shumë që ta mbështesë Kosovën në asistencë teknike dhe në fushën kulturore, dhe gjithmonë mbështetemi në angazhimin e Kosovës në të ardhmen evropiane. Duhet të jemi më ambiciozë dhe të fokusohemi në atë çfarë është arritur dhe çka mund të arrijmë në të ardhmen. Vjena ka lehtësuar dialogun në Evropën Juglindore me projekte dhe ne jemi momentalisht duke implementuar një program softuerik për qeverisje të mirë, gjithashtu kemi zhvilluar kornizën e zhvillimit dhe bashkëpunimit në edukim si dhe në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Jemi të

angazhuar për suksesin e Kosovës edhe në fushat socio-ekonomike", tha ndër të tjera Eva Michlits, konsulle e Austrisë në Kosovë.

**Busek: Të bëheni më të mirë - kjo është një sfidë shumë e madhe**

Dr. Erhard Busek, President i Institutit për Rajonin e Danubit dhe Evropës Qendrore dhe ish Ministër i Arsimit i Austrisë, i bëri një paraqitje të gjatë historisë së raporteve të Austrisë me Shqipërinë e me Kosovën, si dhe me gjithë rajonin e Evropës Juglindore, duke nisur nga fillimi i shekullit të kaluar dhe përgjatë gjithë këtij shekulli dhe shekullin që jemi tash.

Ai numëroi sfidat nëpër të cilat ka kaluar Austria, në periudhat e rëndësishme të historisë, por edhe qëndrimin që kanë mbajtur qytetarët, gjenerata të tëra, për t'iu bërë ballë sfidave të kohës dhe për ta zhvilluar shtetin, në një shkallë shumë të lartë dhe me shumë ndikim, siç është sot.

Duke folur për 20 vitet e Austrisë në Bashkimin Evropian, ai e quajti këtë një të arritur të madhe, e cila mund t'u shërbejë si model të tjerëve, e konkretisht Kosovës.

Ai përmendi prezencën në shtetin tonë e në rajon të Bankës Raiffeisen dhe kompanive të fuqishme austriake, dhe theksoi se fuqia ekonomike e Austrisë mbështetet me faktin se ndërmarrjet nga ky shtet e kanë shtrirë jashtë vendit aktivitetin e biznesit.

Z.Busek theksoi se Evropa Juglindore duhet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. "Nuk kam dëgjuar që dikush ka thënë që të mos i pranojmë këta. Me gjithë dashurinë time për vendin e juaj, Bosnja Hercegovina është në pozitë më të keqe sesa Kosova. Por, mos e shfrytëzoni këtë që të thoni se jeni më mirë se Bosnja. Duhet të shikoni me një vizion më të qartë që të zhvilloheni dhe të bëheni më të mirë. Kjo është një sfidë shumë e madhe", tha ndër të tjera z.Busek.

Në vazhdim të konferencës foli Ramadan Ilazi, zëvendësministër i integriteteve evropiane, i cili fillimisht, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e falënderoi z.Busek për angazhimin e tij rreth Kosovës.

Ai foli gjerësisht për angazhimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e kritereve drejt integritetit të vendit në institucionet euroatlantike dhe sidomos përkushtimin e qeverisë për të përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara.

Z.Ilazi gjithashtu përmendi një varg sfidash, që nga dukuritë negative me të cilat përballen shteti dhe shoqëria e deri të papunësia

e madhe dhe problemi i migrimit ilegal, që kërkojnë një zgjidhje, e cila duhet të gjendet në bashkëpunim edhe me institucionet ndërkombëtare.

Christian Rupp, koordinator i Qeverisë së Austrisë për qeverisje elektronike foli për përvojat e zhvillimit të E-Qeverisjes në Shqipëri në Maqedoni.

"Kemi përmendur rëndësinë e kësaj qeverisjeje, që është një mundësi për të ndërtuar transparencën dhe besimin, siç ka ndodhur në shumë vendet tjera, por kjo gjeneron edhe punë të reja. Kjo mund të jetë një mundësi, sidomos në këtë Universitet, kjo mund të jetë një model i mirë se si mund të punoni në multi-media, që është një perspektivë për të ardhmen tonë", tha ndër të tjera z.Rupp.

"Ne si UBT nuk do të ekzistojmë pa këtë koncept bashkëpunimi ndërmjet Austrisë dhe Kosovës. Austria ka qenë i vetmi vend i cili ka hapur dyert tyre për të na ndihmuar. Unë kujtoj nga fillimi ndjenjën të kemi një partneritet për të na ndihmuar dhe kanë investuar shumë fonde. Në Gjermani kanë thënë se Kosova është një vend shumë i vogël, po ashtu edhe në Angli. Pra, në Austri ka pasur institucione por edhe ekspertë që na kanë ndihmuar", theksoi rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi, duke folur për bashkëpunimin Kosovë-Austri, respektivisht nga bashkëpunimi i tij dhe i UBT-së me institucionet austriake dhe ekspertët e fushave të ndryshme, përvoja e të cilëve u përcoll edhe në Kosovë.

**Bajrami: Do të krijojmë kushte më të mira për biznesin vendor, edhe më shumë lehtësi për investitorët e huaj**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, zonja Hykmete Bajrami, duke folur në konferencë, paraqiti një varg të dhënash për fushat e bashkëpunimit Kosovë-Austri dhe për përpjekjet e institucioneve të Kosovës për zgjerimin e këtij bashkëpunimi, por edhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Zonja Bajrami shtoi se qeveria po punon për hapjen e vendeve të punës dhe hapjen e perspektivës së qytetarëve. Në këtë kontekst ajo është angazhuar për heqjen e vizave për banorët e Kosovës.

Ajo theksoi fillimisht se ekonomia e Kosovës varet nga taksat e importit dhe remitencat, ndërsa theksoi se qeveria ka synim ta ndryshojë këtë gjendje.

Sipas saj, do të ndryshohen politikat për të ndihmuar bizneset prodhuese dhe për të mbështetur në përgjithësi biznesin privat.

Ministria Bajrami gjithashtu u angazhua për zgjerimin e

bashkëpunimit me bizneset austriake.

Qeveria e Kosovës po punon që të krijojë kushte më të mira për bizneset në Kosovë. Kemi përkrahjen nga donatorët, duke i përfshirë edhe ata austriakë. Unë dje u ktheva nga Austria, ku komiteti Kosovë-Austri mbajti një panair ku u prezantuan mbi 50 biznese austriake, disa prej të cilave edhe më përvojë në rajon e edhe në Kosovë. Jemi kënaqur për sukseset e tyre por edhe për sukseset e bizneseve kosovare në Austri, por jam e pakënaqur me investimet e bëra, theksoi ministrja Bajrami.

Qeveria e Kosovës është ne dijeni për pengesat dhe vështirësitë dhe po mundohemi që të luftojmë kundër tyre. Po punojmë kundër korrupsionit dhe po tentojmë që bizneset të kenë hapësirë dhe të gjitha kushtet për zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Duam që të krijojmë një sistem i cili nuk e merr parasysht kush është kryeministër, ministër, drejtor apo çfarëdo tjetër. Jemi në mesin e top-reformatorëve nga Banka Botërore, po bëhet fuqizimi i sektorit privat dhe po krijohet ligjet. Kemi filluar me e-regjistrimin në agjencinë e regjistrimit të biznesit, i cili tashmë bëhet online. Shumë shpejt do të fillojë edhe programi i e-prokurimit i cili do të luftojë korrupsionin dhe ku është shumë e rëndësishme që të përfshihen të gjitha institucionet, tha ndër të tjera ministrja Hykmete Bajrami.

**Wright: Në Kosovë ka 450 hotele, por pak turizëm**

Robert Wright, drejtor ekzekutiv i RaiffeisenBank në Kosovë tha se bizneset austriake në Kosovë janë në një numër të konsiderueshëm.

"109 kompani austriake ekzistojnë në Kosovë. Gjendja e Kosovës nuk është më e mira e mundshme, ka vend për shumë përmirësime. Cila është arsyeja që dikush të investoj këtu? Nuk besoj që do të ishte përgjigje e mirë rinia, që të huajt të investojnë këtu. Ne japim kredi por kthimi i tyre është i vështirë. Ne kemi në Kosovë 450 hotele, por sa turizëm ka këtu? Të mos them fare. Kemi 1000 pompa të benzinës kur ti mund të shkosh nga Prishtina deri në Tiranë dhe të mos kesh fare nevojë për furnizim me derivate", theksoi ai.

Ndërsa, Vjosa Huruglica nga Oda Austriake e Bizneseve, tha se biznesmenët nga Austria nuk janë shumë të kënaqur me gjendjen në Kosovë, megjithëse Austria është në mesin e investitorëve kryesorë në vendin tonë.

"Z. Wright përmendi 109 biznese në Kosovë, mendoj se është një numër mjaft i madh dhe bizneset nga Austria janë ndër me të shumtat në numër në Kosovë", tha ajo

Znj. Huruglica tregoi edhe për një anketë të bërë me bizneset austriake. Sipas saj, 50 për qind thanë se situata në Kosovë nuk është e kënaqshme, deri sa 25 ishin optimistë. Për bizneset e tyre 31 për qind deklaruan se është gjendje pak më e mirë në 3-mujorin e parë të vitit 2015.

Planet e bizneseve austriake janë që të investojnë më shumë në Kosovë dhe të rritin numrin e të të punësuarve", tha znj. Huruglica, duke shtuar se Oda e Bizneseve Austriake në Kosovë dhe biznesmenët presin nga qeveria e re mbrojtje të investimeve, presin që të mos vazhdohet me korrupsion dhe të ketë siguri politike.

Dr. Erhard Busek në vijim kërkoi nga ministrja Hykmete Bajrami që të tërheqin partnerë, të krijohen marrëveshje dhe të krijohet një treg i mirëfilltë.

Numri jashtëzakonisht i madh i të papunëve kërkon ide themelore, të cilat janë arsimimi dhe ekonomia. Kosova, nuk është pjesë e iniciativës strategjike për ekonomi në rajon, por ajo çfarë mua më pengon më shumë është mosbashkëpunimi mes vendeve fqinje, ku secili vend punon vetëm për vete. Gjëja më negative është se fonde ka, por projekte jo. Specifikoni çka ju nevojitet! Projektet infrastrukturore, nëse nuk i keni njerëzit e trajnuar, nuk nevojiten asgjë, theksoi z.Busek.

Në sesionin e pasditet të konferencës është diskutuar për temën "E-Qeveria dhe bashkëpunimi ndërmjet Austrisë dhe Kosovës, si faktor kyç për tokën më të mirë, menaxhimin urban dhe Kadastrin".

Përfaqësuesit e bizneseve austriake e kosovare diskutuan për bashkëpunimin mes tyre

Në margjina të ditës së dytë të konferencës janë zhvilluar edhe takime të përfaqësuesve të bizneseve nga Kosova dhe nga Austria.

Shumë përfaqësues të biznesit kanë ndjekur punimet e konferencës dhe janë njoftuar më për së afërmi me bashkëpunimin ekzistues, por edhe për format dhe mundësitë e reja të bashkëpunimit.

Përfaqësuesit e bizneseve të të dyjave vendeve kanë diskutuar për një varg çështjesh me interes, ndërsa për ta një përvojë shumë të mirë kanë paraqitur idetë e paraqitura në konferencën dyditore, por edhe fjalimet afirmative dhe përkrahëse të ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë të Kosovës për përkrahjen dhe krijimin e një klime të re të bashkëpunimit në të gjitha fushat e sidomos në ekonomi, duke eliminuar një varg barrierash e pengesash, që jo rrallë herë e kanë vështirësuar këtë bashkëpunim.



UBT NIKOQIR EDHE I NJË KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

# NË UBT I ZHVILLOI PUNIMET KONFERENCA "FREE MARKET ROAD SHOW"

"Është nder për UBT-në të organizojë këtë konferencë që ka të bëjë me edukimin e të rinjve me biznes dhe teknologji. Ne kemi përgjegjësi të zgjidhim problemet dhe të tentojmë të arsimojmë brezat e rinj. Është nder për UBT-në të marrë pjesë në projekte të ndryshme. Konsideroj se kemi material të mjaftueshëm dhe resurse e faktorë që mund të ndihmojnë në rritjen e ekonomisë së vendit. Kemi mbështetje nga partnerët e ndryshëm", tha rektori Hajrizi në hapje të konferencës

22 prill - Në ambientet e UBT-së në Prishtinë sot i ka zhvilluar punimet konferenca ndërkombëtare "Free Market RoadShow", në të cilën, folës ndërkombëtarë dhe vendorë kanë paraqitur idetë dhe hulumtimet e tyre lidhur me sipërmarrjen dhe zhvillimin ekonomik, përshkuar me shembuj nga vende, rajone e praktika të ndryshme nga gjithë bota.

Rektori i UBT-së, Dr. Edmond Hajrizi, në fjalën e tij hyrëse, i përshëndeti pjesëmarrësit e konferencës.



"Është nder për UBT-në të organizojë këtë konferencë që ka të bëjë me edukimin e të rinjve me biznes dhe teknologji. Ne kemi përgjegjësi të zgjidhim problemet dhe të tentojmë të arsimojmë brezat e rinj. Është nder për UBT-në të marrë pjesë në projekte të ndryshme. Konsideroj se kemi material të mjaftueshëm dhe resurse e faktorë që mund të ndihmojnë në rritjen e ekonomisë së vendit. Kemi mbështetje nga partnerët e ndryshëm", theksoi dr. Hajrizi.

"Besojmë se idetë për tregun e lirë të sjella nga Shkolla Austriake e Biznesit mund të jenë mjaft të mira për ju që t'i përdorni në vendin dhe në bizneset tuaja. Ne kemi marrë si model tregun austriako-hungarez, pra që nga kohët më të vjetra. Idetë e tregut të lirë do të ndihmojnë në jetët e njerëzve", theksoi ndërkaq Richard Zundritsch, anëtar i Bordit

të Institutit Hayek dhe i Qendrës Ekonomike Austriake).

Në fjalën e tij para të pranishmëve të shumtë, profesorë, ekspertë e studentë të shumtë, foli edhe Gunther Ferlinger, udhëheqës i shoqatës Austriako-Kosovare.

"Evropa mund ta përmirësojë tregun e lirë, me anë të të cilit do të pasojë rritja e ekonomisë. Kosovës i nevojitet edukimi evropian", tha ndër të tjera z. Ferlinger.

Drejtori i Projektit Millennium, Prof. Jose Luis Cordeiro na Venezuelë, theksoi se kjo është hera e dytë që vjen në vendin tonë, ku së pari ka qenë për prezantimin e futjes së Markës Gjermane në ekonominë dhe tregun e Kosovës.

"Ju duhet ta bëni atë që e ndjeni, nuk ka rëndësi nëse dështoni një herë. Nëse dështoni edhe 2-3 herë të tjera, prapë nuk ka rëndësi. Duhet të

dështoni disa herë që të bëheni më të mirë. Brenda 20 vitesh ne do të jemi pjesë e shumë ndryshimeve teknologjike. Në vitin 2009, në hapjen e universitetit tonë, i pranishëm ishte edhe guvernatori i Kalifornisë të cilin e njohim ndoshta të gjithë, austriako-amerikani Arnold Shwarzengger, i cili e përuroi universitetin tonë. Ai u kthye në vitin 2012, duke marrë shumë projekte nga Universiteti ynë, gjëra që do të jenë reale", tha në paraqitjen e tij Prof. Cordeiro.

"Nga viti 2029 deri në vitin 2045, teknologjia do të bëjë hapa të paimagjinueshëm. Në revistën e famshme "Times" u bënë publike dy projekte që ne i kemi. "Si mundet Google të shpëtojë jetë njerëzish" dhe "Nga viti 2045 njerëzit do të jenë të pavdeks-hëm". 3D printerët që ne i kemi sjellë në treg kanë arritur që të bëjnë gjëra të mahnitshme, ndër të tjera një të tillë e kemi dërguar edhe në stacionin hapësiror", tha ndër të tjera Cordeiro.

Një vështrim të gjerë zhvillimeve ekonomike në Kosovë dhe në rajon, në kohë të ndryshme e bëri Adri Nurkollari.

"Deri sa pjesa më e madhe e Evropës kishte rënie jashtëzakonisht të madhe ekonomike, Kosova faktikisht pati rritje ekonomike, kurse në vitin e kaluar (vitin 2014), pati rritjen më të madhe që nga koha e krizës.

Se Kosova është e qëndrueshme ekonomikisht tregon edhe investimi në autostrada e madje edhe në Aeroportin "Adem Jashari", i cili është ndër aeroportet më të frekuentuara në rajon", theksoi ai ndër të tjera në fjalën e tij në konferencë.

Ndërsa Henrique Shneider, udhëheqës i Federatës së e Bizneseve të vogla dhe të mesme në Zvicër, përcolli një mesazh mjaft interesant. "Rritja dhe Liria kanë ÇMIM! Ato nuk mund të jenë të lira e në rastet që dikush mendon që i ka marrë lirë atëherë ai apo ajo është idiot! UÇK deshi lirinë, ata e dinin se ka rrezik, ata e dinin se do të përballeshin ndoshta edhe me rrezikun më të madh... Vdekjen! Nuk ka liri, nuk ka rritje pa rrezik. Nëse ti nuk dëshiron të rrezikosh, pse nuk qëndron në shtat? Ai është vendi më i sigurt për secilin. Google ishte në rrezik në fillimet e saj, nuk kishte reklamues, nuk kishte përkrahës, kurse sot Google është në çdo vend! Rreziku mund të të sjellë suksesin...", theksoi ndër të tjera Shneider.

Në konferencë foli edhe Kate Sheehan nga Asociacioni për Hulumtim Postdoktoral në Institutin FreeMarket, e cila elaboroi temën për sfidat në tregun e lirë dhe ndikimin e tij në ekonominë e një vendi.

Sh.Sokoli, D.Jakurti

## UBT DHE SHOQATA AUSTRIAKE-KOSOVARE ORGANIZUAN KONFERENCËN "DITA FINANCIARE AUSTRIAKE-KOSOVARE PËR HIPOTEKAT 2015"

Çështja e hipotekave në Kosovë, e përcjellë me probleme ligjore, por edhe probleme të tjera të funksionimit të përgjithshëm të sistemit, është një nga temat kyçe në zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe në funksionimin e një varg institucionesh

19 qershor. - Funksionimi i tregut të hipotekave në Kosovës ishte tema bosht e diskutimeve në kuadër të konferencës "Dita Financiare Austriake-Kosovare për hipotekat 2015", organizuar nga UBT dhe Shoqata Austriake-Kosovare, e cila mbledhi ministra, zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të bizneseve dhe ekspertë e profesionistë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Çështja e hipotekave në Kosovë, e përcjellë me probleme ligjore, por edhe probleme të tjera të funksionimit të përgjithshëm të sistemit, është një nga temat kyçe në zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe në funksionimin e një varg institucionesh.

Gunther Fehlinger, President i Shoqatës Austriake-Kosovare dhe moderator i konferencës, e quajti temën e shtruar për diskutim si një

temë shumë të rëndësishme dhe sfiduese në kohën tonë.

Ndërsa, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, e konsideroi konferencën shumë të rëndësishme, për faktin se lidhet direkt me elementet e zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Ai theksoi se në UBT kjo temë diskutohet mjaft shumë, sikur edhe çështjet e hulumtimit, projektet e ndryshme, bashkëpunimet ndërkombëtar etj.

"Një event me vlerë, një debat i hapur, një mundësi e mirë që studentët të informohen më shumë për çështjet e financave, që t'i ndërlihdin politikat sa më të mira në jetën e tyre", tha dr. Hajrizi.

Një nga folësit në konferencë, drejtori i Raiffeisen Bank, Robert Wright, theksoi se rregullimi i çështjes së banimit është çështje primare e jetesës.

Sipas tij, tema e hipotekave është me interes për të gjithë, jo vetëm për sistemin bankar, por sjell shumë përfitime edhe për ekonominë e Kosovës dhe për shoqërinë në përgjithësi.

Ai e quajti me shumë interes ligjin mbi pronën private. "Nuk është vetëm dhënia e hipotekës por kjo dhënie të bëhet sipas ligjit dhe parimeve etike të punës", tha ai.

Gubernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bedri

Hamza tha se ekonomia është top-prioritet për shtetin dhe një fushë në të cilën duhet bërë përmirësime.

Ai theksoi se Kosova ka një sistem bankar profitabil, por në të cilin ende ka ngecje. Gjithashtu, ai theksoi se tregu i kredive dhe i hipotekave nuk është shumë i zhvilluar.

Hamza theksoi se pikë e fortë e bankës është edhe bashkëpunimi me bankat e tjera, që është çështje kryesore për hipotekat, duke shtuar se përmes rregulloreve të reja janë respektuar dhe janë vlerësuar regjistrimet e hipotekave të banimit.

Megjithatë, ai theksoi se bankat kanë probleme kur duan të shesin hipotekat, që nga rasti kur blerësi mund të ketë ndonjë mesazh që e pengon atë transaksion, pastaj evidencimi i pronave, shitja e tyre e të tjera.

Hamza vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe ndihmën që ata japin në rregullimin e fushës së hipotekave në vendin tonë.

Murat Hoxha nga Komisioni për Planifikim Hapësiror dhe Ambient, përmendi Ligjin për kadastrën dhe Ligjin për hipotekat, si bazë për rregullimin e çështjeve në fushën e hipotekave. Ndër të tjera, ai tërhoqi vërejtjen se hipotekat patjetër duhet të regjistrohen dhe për këtë regjistrim informacionet kadastrale duhet të jenë të sakta dhe të plota.

Ndërsa Jakup Fetaj, përfaqësues i kadastrës në Maqedoni, paraqiti përvojat në këtë fushë në shtetin prej nga vjen. Ai e konsideron të rëndësishëm regjistrimin e vlerave të hipotekës, sepse sa më shumë regjistrime, aq më shumë ka mundësi për hipotekë, ngase nëse nuk bëhen regjistrimet mund të dalin probleme në sektorin shtetëror dhe privat.

Përfaqësuesja e Odës Ekonomike Austriake që vepron në Kosovë në kuadër të Ambasadës Austriake, Vjosa Huruglica, foli në konferencë lidhur me investimet austriake në Kosovë.

Ajo tha se Austria është shteti i gjashtë për nga vlera e investimeve në Kosovë, por theksoi se investimet e kompanive austriake në Kosovë janë shumë më të vogla në krahasim me investimet në vendet e rajonit.

Megjithatë, Huruglica theksoi se ka një interesim të shtuar të kompanive austriake për investime në Kosovë. "Sipas të dhënave që kemi nxjerrë deri në fund të vitit 2013, kemi pasur rreth 110 kompani që kanë shprehur dëshirën të jenë pjesë e bizneseve në Kosovë apo të investojnë në Kosovë. Shumica e kompanive janë optimiste dhe planifikojnë të rrisin investimet duke shtuar kështu edhe numrin e punëtorëve", tha Huruglica.

Ferid Agani, Ministër i Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësiror, foli për rëndësinë e procesit të regjistrimit të pronave në Kosovë.

Sipas tij, në kushtet dhe rrethanat që ndodhet Kosova, është e domosdoshme që të investohet në mjedis dhe në regjistrim të pronave.

Ai e konsideron vitin 2015 si vit shumë të mirë, duke marrë parasysh se është bërë një arritje e veçantë në muajt e fundit. "Në mars të vitit 2015, kemi pasur shumë regjistrime dhe gradualisht është fituar besimi i qytetarëve dhe janë bindur se pronat e tyre duhet të regjistrohen, sepse është e vetmja mënyrë që ato të sigurohen", tha ministri Agani, i cili gjithashtu vlerësoi përkrahjen ndërkombëtare, sidomos atë nga SHBA, në këtë proces të rëndësishëm për vendin tonë.

Ndërkohë, Eljesi Surdulli, kryetar i Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës, theksoi se procesi administrativ i regjistrimit të pronës duhet të përshpejtohet, por edhe të lehtësohet. "Mendoj se nuk duhet të kërkohej aq shumë dokumente sa kërkohej tani, sepse po vështirëson punën e regjistrimit", tha Surdulli.

Gent Sejdiu, një ndërmarrës i suksesshëm, përfaqësues i Kosova Reality Group, theksoi se tregu i Kosovës ka nevojë për punë dhe për zhvillim, duke u shprehur optimist për investimet kapitale.



KOSOVA NË GARË NË NASA

# Studentët e UBT-së e të UP-së fitues të garës së NASA-s

Projekti "Natev Explorer" i studentëve ka triumfuar në mes të mijëra projekteve të tjera



Projekti "NatEv Explorer" i studentëve të UBT-së dhe të UP-së fitoi garën ndërkombëtare, e cila është organizuar nga NASA. Në këtë garë kanë konkurruar mbi 1 mijë projekte nga 140 shtete të ndryshme. Në garën e ngushtë, ditën e përmbylljes së votimeve, "NatEv Explorer" e la shumë mbropa projektin e dytë, "Robo-Fabric". "NatEv Explorer" nga studentët nga Kosova, ka grumbulluar plot 68903 vota ku u shpall fituese, me dallim të madh nga vendi i dytë, i cili tuboi 54321 vota.

Projekti "NatEv Explorer" është një platformë e bazuar në web ku sinkronizohen të dhënat në kohë reale të satelitëve të NASA dhe bën klasifikimin e dukurive gjeologjike duke përdorur inteligjencë artificiale. "NatEv Explorer" zgjidh sfidën e ashtuquajtur "Volcanoes, Icebergs and Cats from Space".

Kjo sfidë ka të bëjë me zbulimin e dukurive natyrore nga erupsionet vullkanike, vërshimet, tornadot, shkrirjet e akullnajave, zjarret në pyje, etj.

Ekipi i studentëve kosovarë është përkrahur gjatë garës deri në vendin e parë nga shumë qytetarë dhe personalitete të rëndësishme, të cilët kanë bërë thirrje për votimin e projektit të tyre.

Studentët e UBT-së, MuhamedRatkoceri, Rinor Maloku dhe Taulant Mehmeti, pjesë e ekipit fitues, në një bisedë të përbashkët për "UBT News"

flaslin për idenë dhe rrugën deri te finalja.

**Pyetje: Të nderuar. Përgëzimet tona për garën e fituar me Projektin "NatEv Explorer". A mund të na thoni si lindi ideja për këtë projekt?**

**Përgjigje:** Së pari falënderojmë të gjithë ata të cilët na votuan dhe na përkrahën. Ideja që ne ofruam ishte zgjidhje për sfidën "Volcanoes, Icebergs, and Cats from Space". Kjo sfidë ka të bëjë me zbulimin e ngjarjeve natyrore si katastrofat poashtu edhe ato interesante që ndodhin rreth tokës. Zgjidhja që e kemi ofruarë bën të mundshëm shfrytëzimin dhe hulumtimin e informacioneve që i disponon NASA për këto ngjarje siç janë imazhet satelitore të tokës në kohë reale.

**Pyetje: Kush janë anëtarët e ekipit dhe si vendosët të punoni së bashku?**

**Përgjigje:** Anëtarët e ekipit janë: MuhamedRatkoceri, Taulant Mehmeti, Rinor Maloku, Arlind Dushi, Blend Mehmeti, Zana Bytyqi dhe ArnoldPlakolli. Në fillim ishim të ndarë në dy grupe dhe punonim në projektet tona, përgjatë ditës ndihmonim njëri-tjetrit dhe pa përfunduar dita vendosëm që së bashku mund të ofrojmë një zgjidhje më të mirë për sfidën e zgjedhur.

**Pyetje: Si ju lindi ideja të konkurroni në garën ndërkombëtare të organizuar nga NASA?**

**Përgjigje:** Kemi qenë në dijeni të organizimeve të viteve të mëparshme dhe kemi parë që është një garë shumë sfiduese dhe

kemi vendosur të marrim pjesë dhe të kontribuojmë për zgjidhjen e problemeve globale.

**Pyetje: Sa projekte ishin në garë, respektivisht sa ishte e fortë konkurrenca?**

**Përgjigje:** Kjo garë ka pasur pjesëmarrës nga e gjithë bota. Gjithsej kanë qenë mbi 1 mijë projekte nga 140 shtete. Ka qenë garë shumë e fortë duke u nisur nga fakti që pjesëmarrës kanë qenë edhe njerëz me përvojë si inxhinierë, shkencëtarë dhe na vjen mirë që kemi kaluar këto barrierat dhe projekti ynë i ka zgjidhur problemet NASA-s.

**Pyetje: Si rrodhi procesi deri në hyrjen tuaj në mesin e pesë projekteve më të mira?**

**Përgjigje:** Fillimisht jemi nominuar për "People's Choice Award" ku kemi fituar falë votës së publikut, mirëpo natyra e kategorisë dhe sfidës të cilën e kemi zgjedhur së bashku me zgjidhjen të cilën e kemi ofruar ka bërë që ne të nominohemi edhe në kategorinë "Best Use of Data".

**Pyetje: A mund të na jepni detaje të ditëve të fundit të votimeve. Si shkoi ecuria e votave?**

**Përgjigje:** Ka qenë maratonë. 3-4 orë gjumë në ditë, probleme teknike me website të "NasaSpaceApps", mirëpo kemi arritur me punë dhe përkushtim që t'i kalojmë këto pengesa sidomos konkurrencën e fortë të cilën e kemi hasur dhe kemi rrezikuar vendin e parë në 2 ditët e fundit.

**Pyetje: A keni pritur se do të jeni të parët?**

**Përgjigje:** Të tregohemi modestë, ne kemi besuar në punën dhe publikun tonë. Mundi ynë është paguar në fund, gjë për të cilën krenohemi të gjithë pasi që pjesë e fitores nuk është vetëm ekipi "NatEv Explorer" por të gjithë shqiptarët.

**Pyetje: Cila do të jetë e ardhmja e projektit?**

**Përgjigje:** Fillimisht deri në shtator, kur do të marrim rrugën për në Amerikë, do të mundohemi ta përfundojmë dhe ta fusim në funksion dhe pastaj shohim dhe bisedojmë në NASA për hapat e mëtejshëm.

**Pyetje: Ju lutem, na jepni sa më shumë detaje rreth projektit tuaj. Si funksionon dhe cili është qëllimi i tij?**

**Përgjigje:** Është platformë e bazuar në web. E zgjidh sfidën e zbulimit të ngjarjeve natyrore "Volcanoes, Icebergs, and Cats from Space", kjo platformë mundëson zbulimin e këtyre ngjarjeve duke u lidhur me imazhet satelitore të tokës në kohë reale, në hartë mund të navigohet dhe nesër vërehet një erupsion vullkani ose ngjarje tjera mund të lajmërohen në formë të postimit në website tonë. Postohet një foto e ngjarjes e cila mundësohet përmes veglave që i ofrojmë, shkruhen disa detaje se ku ka ndodhur dhe njëpërshkrim i shkurtër dhe pastaj shenjohet në globin 3D të vendosur në mes të webfaqes. Përdoruesit mund të shohin ngjarjet e gjetura nga

njerëz të tjerë të "votojnë" për eventin e dëshiruar në mënyrë që të vendosim një listë me eventet më të votuara për t'i motivuar njerëzit që të zbulojnë ngjarje të tilla për t'i ndihmuar shkencëtarët dhe ekipet emergjente që të veprojnë në këtë situatë.

**Pyetje: Ju jeni pjesë e UBT-së. Sa ju kanë ndihmuar studimet dhe përgjithësisht hulumtimet që kryhen në UBT në arritjen e këtij rezultati?**

**Përgjigje:** Janë dy elemente që ofron UBT të cilat kanë qenë vendimtare. E para është fokusimi në aspektet praktike të programimit dhe stafit që vazhdimisht ndihmon studentët për tu aftësuar. Dhe e dyta është jo mbingarkesa e studentëve me informata të tepërta, çfarë u mundëson atyre vullnetarisht të angazhohen në të mësuarit e njohurive dhe hulumtimeve në fusha të ndryshme të shkencave kompjuterike.

**Pyetje: A mendoni te jeni bashkë edhe në projekte të tjera në të ardhmen?**

**Përgjigje:** Do të ishte kënaqësi por mundësitë janë shumë të vogla. Çdo njëri nga ne ka një ide se ku do të ndodhet pas ca viteve dhe çfarë duhet bërë për të arritur aty, kurse "NatEv" do të mbetet vetëm një meandër e shkurtër dhe e këndshme me shoqëri të reja dhe eksperiencë të paharrueshme.

AlbaMerovci



ME PËRKRAHJEN DHE FINANCIMIN E POPULLIT AMERIKAN, PËRMES ORGANIZATËS INTERNACIONAL BOOK PROJECT

# NË UBT U INAUGURUA BIBLIOTEKA DHE QENDRA E DIJES ME MBI 100 MIJË LIBRA

Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm edhe prof.dr.Stacy Closson nga Universiteti i Kentakit, anëtare e Bordit të Internacional Book Project, përfaqësues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, mësimdhënës dhe studentë të UBT-së

Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) është bërë inaugurimi i Bibliotekës dhe Qendrës së Dijes, krijimi i të cilave është mundësuar me përkrahjen dhe financimin e popullit amerikan, përmes organizatës Internacional Book Project.

Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm edhe prof. dr.Stacy Closson nga Universiteti i Kentakit, anëtare e Bordit të Internacional Book Project, përfaqësues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, mësimdhënës dhe studentë të UBT-së.

Biblioteka e UBT-së, me qendrën në saj në kampusin e ri të këtij institucioni, ka rreth 100 mijë libra dhe mëton të jetë biblioteka më e madhe universitare në vend dhe në rajon. Përveç kësaj biblioteke, UBT ka bibliotekat e saj edhe në objektin qendror në Prishtinë dhe në degët në Ferizaj e në Prizren.


Synimi i UBT është që jo vetëm të krijojë bibliotekë ku studentët dhe të interesuarit e tjerë të mund të marrin libra për lexim e hulumtim, por që hapësirën e saj ta kthejë në qendër të dijes, në përkrahje të të gjithë të interesuarve për literaturën dhe mundësitë që ofron ajo.

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi, duke folur për inaugurimin e bibliotekës qendrore në UBT, tha se ky paraqet një moment të rëndësishëm për UBT-

në dhe për Kosovën, për faktin që sot bëhet hapja e njëres prej bibliotekave më të mëdha universitare në Kosovë, dhe njëkohësisht krijohet një koncept i ri që ne e quajmë Qendra e Dijes. "Konceptin që të mos jetë si bibliotekë, si libra, por edhe një sistem i dijes. Ky moment vjen si rezultat i një projekti, i një pune disave që është bërë në UBT, dhe duke përfshirë disa elemente të këtij sistemimi, elementeve të para, librave, trajnimit e zhvillimit të stafit, krijimit të infrastrukturës etj.", theksoi dr.Hajrizi.

"Kjo qendër përfshin një sasi mjaft të madhe të librave. Ne kemi arritur që përmes atyre fizike dhe elektronike t'i kemi njëqindmijë libra, të cilat mëdoj që janë një sasi mjaft domethënëse për Kosovën. Përmes një sistemi të regjistrimit të të gjitha këtyre, siç është sistemi "Koha", studentët dhe stafi do të kenë mundësi që ta gjejnë informacionin e duhur sa më shpejt dhe në vendin e duhur", tha Hajrizi, duke përkujtuar se kjo është quajtur edhe si bibliotekë qendrore, pasi UBT ka edhe degët e tij edhe në Prishtinë edhe në Prizren, Ferizaj.

"UBT mendon që aspekti i dijes është një temë për të cilën duhet të flasim më shumë, duke promovuar më shumë. Menaxhimi i dijes është një kërkesë e kohës. Ne për herë të parë kemi



bërë master për menaxhimin e dijes dhe sistemin e informacionit të bibliotekarisë, për të arritur një efekt më të madh dhe një produktivitet më të madh sa i përket dijes në përgjegjësi", vijoi Hajrizi.

Z.Hajrizi tha se të gjitha këto sot nuk kishin qenë të mundura pa përkrahjen shumë të madhe të popullit amerikan, përmes donacionit që ka arritur nga International Book Project, që ka misionin të ndihmojë me literaturë në tërë botën. Ai theksoi kontributin e pamohueshëm të profesorit në UBT, Ridvan Peshkopia, i cili hulumtoi dhe përzgjodhi e siguroi mbërritjen në UBT të librave profesionalë dhe shumë të rëndësishëm për

studentët dhe studiuesit në përgjithësi.

Prof.dr.Stacy Closson nga Universiteti i Kentakit, anëtare e Bordit të Internacional Book Project, që ndihmoi pakursyeshëm bibliotekën e UBT-së, theksoi se ndihet shumë e kënaqur që është në Kosovë dhe që është në UBT për të promovuar bibliotekën dhe qendrën e dijes.

Ajo lavdëroi punën e bërë nga UBT-ja në përmblylljen e projektit të krijimit të bibliotekës dhe theksoi se ka qenë profesor Peshkopia që e ka vendosur organizatën Internacional Book Project në kontakt me rektorin Hajrizi dhe pastaj kanë planifikuar dhe realizuar idenë për bibliotekën e përruar sot.

"Për organizatën tonë është bashkëpunimi i parë në Kosovë. UBT është i vetmi Universitet që posedon qendrën e dijes dhe është i vetmi që ka një bibliotekë kaq të mirë me tituj të ndryshëm. Bashkëpunimi do të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme", tha ndër të tjera dr. Closson.

Bukurie Haliti nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës, e cila ka bashkëpunuar në trajnimin e stafit dhe në fazën përgatitore, lavdëroi punën e mirë dhe profesionale të bërë që nga ideja fillestare deri në finalizimin e plotë të bibliotekës me gjithë infrastrukturën e saj.

Prof. Dr. Ridvan Peshkopia në këtë ceremoni ka paralajmëruar ardhjen deri në fund të vitit edhe të një kontingjenti të madh librash specifike për studentët e UBT-së. Ai gjithashtu paralajmëroi krijimin e një biblioteke me libra dhe literaturë tjetër nga fusha e Mjekësisë, ndërsa theksoi angazhimin e tij dhe të UBT-së për zgjeruar literaturën për Arkiteturën, Shkencat Kompjuterike, Sociologjinë e fusha të tjera.

Në ceremoni folën edhe Egzona Luboteni, përgjegjëse e bibliotekës në UBT dhe Betim Gashi, që realizoi pjesën e TI, mjaft e rëndësishme për funksionalizimin e bibliotekës.

Në fund të ceremonisë, rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi nderoi më mirënjohje prof. dr.Stacy Closson, organizatën Internacional Book Project, profesorin Ridvan Peshkopia, si dhe Egzona Lubotenin e Betim Gashin.

B.Troshupa, E.Hyseni

## LIGJËRUESIT NË UBT VIZITUAN KOMPANINË "GRAPHISOFT" NË BUDAPEST

Ligjëruesit në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, Petrit Ahmeti dhe Ferhat Bejtullahu, gjatë një qëndrimi në Hungari, zhvilluan një vizitë në parkun e kompanisë "Graphisoft", me seli në Budapest.

"Graphisoft" është kompania që krijoi softuerin Archicad, i cili sot shfrytëzohet nga një numër i madh i arkitektëve në botë.

Profesorët Ahmeti e Bejtullahu, gjatë kësaj vizite, diskutuan me drejtuesit e kompanisë, si dhe u njohën me gjithë aktivitetin që zhvillon kompania. Ata gjithashtu diskutuan mundësitë e bashkëpunimit, sidomos në shkëmbimin e përvojave në fushën e Arkitekturës, në të cilën UBT ka një përvojë të çmueshme dhe rezultate të vlerësuar edhe në arenën ndërkombëtare.



## STUDENTËT E PROGRAMIT TË SHKENCAVE POLITIKE NË UBT, KAMPUSI FERIZAJ, ZHVILLUAN PUNË PRAKTIKE NË SARANDË

Gjatë datave 13-17 maj, studentët e programit Shkenca Politike, Kampusi Ferizaj, zhvilluan praktikë mësimore në Sarandë nën udhëheqjen e pedagogut të tyre Ridvan Peshkopia. Përmbledhur në projektin kërkimor Bashkimi European në Ballkan, studentët u përqendruan kryesisht në mbledhjen e të dhënave me sondazhe të opinionit publik të zhvilluar nëpërmjet telefonisë celulare dhe platformës programore iziSurvey, një prodhim risor i krijuar në Kosovë nga një grup ndërkombëtar akademikësh, inxhinierësh softuerikë dhe sipërmarrësish.

Kjo praktikë u zhvillua në kuadër të nismës në UBT për të rritur mësimdhënien ba-

zuar në kërkim. Mbledhja e të dhënave është vetëm një nga etapat e kërkimit shkencor dhe studentët do të vazhdojnë mandej me analizimin e të dhënave dhe me interpretimin e tyre. Disa nga studentët do të jenë bashkautorë me pedagogun e tyre dhe punimet e dala nga ky projekt synojnë të paraqiten në konferenca shkencore dhe botohen nëpër xhornalet akademike të disiplinave përkatëse.

Projekti kërkimor Bashkimi European në Ballkan është skicuar dhe drejtohet nga pedagogu i UBT-së Ridvan Peshkopia. Ky projekt synon të masë sjelljen politike dhe perceptimet e qytetarëve në gjashtë vende ballkanike

që ende nuk janë anëtarë të Bashkimit European, përkatësisht Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Ky është një kërkim kuazi/pothuajse-eksperimental dhe përbëhet nga një sërë pyetësorësh. Synimi është të matet ndryshimi i përgjigjeve të të pyeturve teksa kalohet nga një pyetësor tek një tjetër dhe teksa pyetjet ndryshojnë disi. Ky projekt synon jo vetëm që të trajtojë studentët në metoda kërkimore sasiore, por ai kryesisht priret nga zhvillimi tek ta i dëshirës për kërkim e prodhim shkencor si edhe për t'i përgatitur ata në studimin e subjekteve akademike jo vetëm në mënyrë teorike por edhe në mënyrë praktike.



EDHE NJË SUKSES I SHËNUAR

# NË UBT U INAUGURUA INKUBATORI VIRTUAL I KOSOVËS DHE START UP QENDRA



Në një ceremoni të organizuar sot në UBT, u bë inaugurimi i Inkubatorit Virtual të Kosovës dhe Start up Qendrës në UBT, të krijuara me mbështetjen e Ambasada të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë.

Në ceremoni ishte i pranishëm edhe Udhëheqësi i Projektit për Ndërmarrësi nga Ambasada e SHBA, z. Kanishka Gangopadhyay, përfaqësues të institucioneve dhe të biznesit, mysafir të

tjerë, mësimdhënës, studentë dhe përfaqësues të mediave.

Pos projektit të inauguruar sot, Ambasada e SHBA ka përkrahur garën për biznese të studentëve të UBT-së, ndërsa në kuadër të projektit është publikuar edhe revista "UBT Entrepreneurship Journal", në të cilën janë publikuar një varg aktivitetesh, si dhe janë prezantuar ish-studentë të UBT-së, të suksesshëm në bizneset e tyre.

"Ky moment është historik. Një inkubator virtual i Kosovës. Kemi theksuar edhe në përmblyllje pjesës së parë të projektit - Misioni ynë, vizioni ynë, ëndrra jonë po realizohet me ndihmën e Ambasada të Amerikës. Është një proces që ndihmon të gjithë këta pjesëmarrës. Pika e parë është që UBT ka program për Biznes dhe Teknologji. Shkolla që kanë mundësi të gjenerimit të ideve e produkteve. UBT është shkolla më e madhe e ICT në Ballkan. Këtë pjesë duhet ta shfrytëzojmë që studentëve t'ua mundësojmë të krijojnë ndërmarrësi. T'i mbështesim e të gjenerojmë vende të reja të punës e të krijojmë ndërmarrje në Kosovë. Janë të gjitha kushtet që ne ta mbështesim zhvillimin", theksoi rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, duke folur në ceremoni.

Sipas tij, virtualizimi i inkubatorit mundëson që nga forma fizike të mbështeten në formën virtuale. "Ne kemi mbështetje regionale. Mendoj se do të ketë shumë rezultate. Ne e kemi testuar në UBT, e ka pjesën e network, pjesën private etj. Pra i ka të gjitha që na nevojiten", vijoi Hajrizi.

Z.Hajrizi theksoi në vazhdim se idetë e reja do të mbështeten nga këndi i ndërmarrësisë. "Me mbështetjen e Ambasada të

SHBA ne kemi arritur që ta krijojmë këtë. Në të gjitha qytetet ne do ta krijojmë një kësi këndi. Me këtë krijohet një decentralizim/regjionalizim. Ne do të mbështesim të gjitha bizneset, por do të ketë përparësi inovacioni", theksoi z.Hajrizi.

Duke u ndërlidhur me inovacionin, ai përkujtoi se studentët e UBT-së e kanë zënë vendin e parë në NASA me idetë e tyre.

Ai gjithashtu tha se UBT është një nga universitetet e vetme që ka lëndë profesionale.

"Ne duhet të identifikojmë pjesën e njerëzve më të dalluar. Sa prej tyre do të regjistrojnë biznese, ne do të tentojmë që të krijojmë sa më shumë spinoff, në bashkëpunim me UBT-së dhe bizneseve të tjera. Presim grante edhe nga Qeveria e Kosovës. Ne kemi marrë konfirmimet nga të gjitha bankat, edhe nga TEB-i në këtë rast, që duan që të ndihmojnë në bizneset e grave", theksoi dr.Hajrizi.

Dr.Hajrizi bëri të ditur se shfrytëzuesit e parë vetëm janë përzgjedhur dhe do ta kenë rastin ta shfrytëzojnë këtë program.

"Ky muaj, apo ky segment kohor, është koha e përkrahjes nga populli amerikan që na ndihmuan me hapjen e bibliotekës dhe tash edhe me këtë program", theksoi ndër të tjera dr.Hajrizi.

Koordinatori i projektit, z. Naim Preniqi shpreh fillimisht falënderime për Ambasada të Amerikës dhe për pjesëmarrësit e tjerë në këtë projekt.

"Qëllimi ka qenë të formohet Qendra e Ndërmarrësisë në UBT. Projektika filluar në vitin 2014. Fillimisht në morën pjesë rreth 150 studentë, prej tyre dolën mbi 40 biznes-plane të cilat e kanë kaluar një fazë të monitorimit nga profesorët. Disanga ta që ishin më të suksesshëm janë shpërblyer me certifikata. Një ndër pikat e tjera të inkubatorit ka qenë themelimi i inkubatorit virtual, ku ka pasur prezantime gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit të kaluar. Në themelimin e inkubatorit kanë ndihmuar ekspertë amerikanë", tha z.Preniqi.

Lidhur me përkrahjen e bizneseve në fushën e teknologjisë informative foli Betim Gashi, i cili theksoi se ndërmarrësit e rinj do të përkrahen me shërbime të ndryshme elektronike.

Më fund të ceremonisë u dhanë certifikata dhe mirënjohje për të gjithë ata që kontribuuan në këtë projekt. Mes të tjerësh, me mirënjohje u nderua edhe Udhëheqësi i Projektit për Ndërmarrësi nga Ambasada e SHBA, z. Kanishka Gangopadhyay, por edhe inkubistët e parë.

B.Troshupa, D.Jakurti

## Arkitekti Georgi Konstantinovski mbajti ligjëratë në UBT

Arkitekti i mirënjohur nga Shkupi, Georgi Konstantinovski ishte mysafiri i radhës në UBT, me ligjëratën tematike "Modernizmi amerikan", në të cilën u fokusua në përshkrimin detal të zhvillimit të objekteve nga fillimi i shekullit të kaluar e deri sot.

Arkitekti Konstantinovski është autor i një varg objekteve të rëndësishme. Ndër kryesore janë Arkivi i qytetit dhe Konvikti i studentëve në Shkup, Pallati i Mediave "Rilindja" në Prishtinë, si dhe projekte pjesëmarrëse në konkursin për Institutin Albanologjik dhe Stacionin e Autobusëve në Prishtinë etj. Ai ishte ligjërues në Universitetin e Prishtinës.

Ligjëratën tematike e hapi Dekani i Arkitekturës, Lulzim Beqiri, duke u shprehur i kënaqur me interesimin e studentëve për pjesëmarrje. Ai profesionin e arkitekturës e konsideron shumë të rëndësishëm duke qenë se është profesion ku shkëmbehen eksperiencat dhe gjërat më interesante që i kalon çdo person në jetë.

Arkitekti Georgi Konstantinovski para të pranishmëve i paraqiti disa prej punimeve të kolegëve të tij, që kanë lënë gjurmë në historinë amerikane të arkitekturës. Duke folur për disa prej arkitektëve më të njohur në Amerikë, për të parë përmes tyre se sa e përpunuar ishte kultura amerikane e asaj kohe, Georgi Konstantinovskishpalosi disa pamje të realizuara para 30-40 vitesh.

Ai gjithashtu foli për evoluimin nëpër periudha të ndryshme të stilit dhe arkitekturës së ndërtimit.

Arkitekti Konstantinovski foli për arkitektin Philip Johnson, i cili njihet si arkitekti më i pasur në Amerikë, i cili është i famshëm me shtëpinë e tij të qelqit. Shtëpia është e tëra e "fundosur" në gjelbërim. Johnson ka dy shtëpi karakteristike: Njëra është e tëra e qelqit, ndërsa tjetra është tërësisht e mbyllur. Kjo e mbyllura është për mysafirë ose më mirë të themi e vetë z. Johnson, sepse ai aty fle.

Ai shtoi se arkitektët e Amerikës për ndriçim i cili vinte nga muret përdornin edhe kulturën arabe. "Më kujtohet kur u ulëm të gjithë në dysheme, diskutuam dhe dhamë ide për këto projekte", shtoi ai.

Të gjithë arkitektët më të njohur të asaj kohe, studimet i përfundonin nëpër Evropë, do të thotë të gjitha njohuritë ata i merrnin nga kultura të ndryshme perëndimore për të ardhur në Amerikë që t'i praktikojnë, tha z. Konstantinovski, duke shtuar se edhe interieri edhe eksterieri ishin shumë të bukura, u bazuan po ashtu në arkitekturën arabe.

"Edhe shkallët i projektonin sipas ngjyrave të diellit, të hapur, ku mund të depërtojë dielli më shumë. Me fjalë të tjera është një arkitekturë e pastër", theksoi më tutje ai.

Z. Konstantinovski shpalosi edhe planin e konviktit të cilin ai e ka projektuar. Aty u panë muret që ishin të ndërtuara nga



guri dhe të gjitha detajet që janë të ndërtuara nga guri. Shpesh nëpër pjesët e skajshme të objektit përdoren edhe skulptura.

Në këtë ligjëratë u shpalosën edhe të gjitha objektet më të rëndësishme të Amerikës, disa prej projekteve të të cilave arkitektët i kishin përgatitur edhe nga betoni. Z. Konstantinovski e konsideroi të rëndësishme se si në atë

kohë kulmet e shtëpisë ishin të mbajtura me litar.

Arkitekti Konstantinovski në ligjëratën e tij përmendi edhe një varg objekteve me arkitekturë karakteristike, kryesisht në SHBA por edhe në vende të ndryshme, duke i quajtur shpirt artistësh arkitektët që kanë bërë projektimin e tyre.

Albina Zeneli

ZËVENDËSMINISTRI I JASHTËM I REPUBLIKËS SË ÇEKISË, Z.PETR DRULAK MBAJTI LIGJËRATË NË UBT

# DRULAK: NË RRUGËN DREJT EVROPËS, KOSOVA DUHET TË PËRFITOJË NGA SHEMBULLI I ÇEKISË

“Është kënaqësi e madhe të jem këtu në mesin tuaj, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, që me sa kuptova është universiteti lider në Kosovë. Unë isha akademik dhe kam ligjëruar si në universitetin shtetëror të Çekisë ashtu edhe në universitetet private atje. Jam i impresionuar me infrastrukturën që ju e keni. Shumë universitete në Evropë i kanë kushtet shumë më të këqija se ju. Gjithashtu, më kanë njoftuar për rezultatet impresive të studentëve të diplomuar”, theksoi z. Drulak, një profesionist dhe një diplomat shumë i çmuar në vendin e tij dhe në rrethet diplomatike evropiane

Zëvendësministri i Jashtëm i Republikës së Çekisë, z.Petr Drulak dhe kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës, z.Enver Hoxhaj kanë mbajtur sot ligjëratë dhe kanë diskutuar me studentët e UBT-së në temën “Evropa Qendrore dhe Ballkani Perëndimor në politikën evropiane”.

Në ligjëratë ishin të pranishëm edhe ambasadori i Çekisë në Republikën e Kosovës, Ivo Silhavy, përfaqësues të institucioneve të vendit dhe mysafirë të tjerë, si dhe profesorë dhe studentë të UBT-së.

Rektori i UBT-së, prof. dr.Edmond Hajrizi theksoi bashkëpunimin shumë të mirë të UBT-së me universitetet nga Republika e Çekisë, siç janë universitetet në Pragë dhe në Bërno, me të cilat janë zhvilluar një varg projektesh të përbashkëta.

Ai theksoi se UBT ka zhvilluar një numër projektesh me përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Çekisë, përfshirë projektet për zonat ekonomike në Gjakovë, Gjilan e Novobërdë.

Bashkëpunimi i UBT-së me universitetet dhe institucionet çeke, tha Hajrizi, do të vazhdojë edhe më tutje.

Zëvendësministri i Jashtëm i Republikës së Çekisë, z.Petr Drulak fillimisht u shpreh shumë i kënaqur për vizitën në UBT dhe dialogun me studentët.

“Është kënaqësi e madhe të jem këtu në mesin tuaj, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, që me sa kuptova është universiteti lider në Kosovë. Unë isha akademik dhe kam ligjëruar si në universitetin shtetëror të Çekisë ashtu edhe në universitetet private atje. Jam i impresionuar me infrastrukturën që ju e keni. Shumë universitete në Evropë i kanë kushtet shumë më të këqija se ju. Gjithashtu, më kanë njoftuar për rezulta-



tet impresive të studentëve të diplomuar”, theksoi z. Drulak, një profesionist dhe një diplomat shumë i çmuar në vendin e tij dhe në rrethet diplomatike evropiane.

Duke iu referuar temës, z. Drulak theksoi se eksperiencat e Evropës Qendrore kanë bërë që ajo të arrijë aty ku është sot. “Ju jeni vend i vogël, por duhet të fitoni eksperiencat e reja për të arritur aty ku është pjesa tjetër e Bashkimit Evropian. Ajo çfarë dua të them është se nuk ka rëndësi shtrirja gjeografike, pra nuk ka rëndësi ku këto vende shtrihen, por rëndësi ka se janë pjesë e Evropës”, theksoi ai.

Z.Drulak, duke bërë një krahasim mes vendit të tij dhe vendit tonë, theksoi se Republika e Kosovës mund të përfitojë nga përvoja e Republikës Çeke.

“Çekia është një shembull i cili mund t'i ndihmojë Kosovës. Të dyja shtetet janë të vogla, kanë një numër jo të madh të banorëve. Nëse Çekia e arriti Bashkimin Evropian, e arriti një qëndrueshmëri ekonomike, pse të mos e arrijë edhe Kosova”, tha Drulak.

“Shtetet e Ballkanit e duan hyrjen në Bashkimin Evropian. Është një gjë e mirë, pasi që kjo i shtyn drejt një stabiliteti dhe një pune më të madhe për ta arritur synimin e tyre. Kosova duhet ta bëjë atë që e ka bërë më herët Çekia. Ne kemi angazhuar arkitektë të njohur nga Gjermania, nga Italia e nga shumë vende të tjera dhe nuk e kemi lënë me ato që i kanë bërë të tjerët. Ne e kemi vazhduar rrugën tonë të

vetëm. Pra, kemi disa vende që po tentojnë të hyjnë në Bashkimin Evropian, ne jemi duke u përparuar ta ndihmojmë këtë proces, këto misione të vendeve në zhvillim”, theksoi ndër të tjera zëvendësministri i Jashtëm i Republikës së Çekisë, z.Petr Drulak.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës, z.Enver Hoxhaj, ish-ministër i Arsimit dhe ish-ministër i jashtëm i Kosovës, theksoi në fjalën e tij një varg përvojash, sidomos nga kontaktet dhe aktivitetet që kishte si ministër i punëve të jashtme.

Duke analizuar zhvillime të shumta në planin ndërkombëtar dhe qëndrimin e institucioneve ndërkombëtare ndaj Ballkanit përgjithësisht dhe ndaj Kosovës, z.Hoxha theksoi se Ballkanit rreziku i vjen nga status-quo-ja dhe jo nga zhvillimi dhe proceset integruese.

Duke bërë një krahasim midis zhvillimeve demokratike në Ballkan dhe këtyre zhvillimeve në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, z.Hoxhaj theksoi se dallimi qëndron në faktin se në Ballkan, në vend të zhvillimit demokratik vendet u kthyen drejt luftës, ndërsa vendet sot anëtare të BE-së shkuan drejt zhvillimit ekonomik.

Ai gjithashtu theksoi se vendet e tjera të Ballkanit e kanë pasur shumë më të lehtë sesa Kosova bërjen e reformave dhe hapat në rrugën drejt integritimit.

Z.Hoxha përmendi në vazhdim tri elemente që paraqesin dallimin e Evropës Qendrore dhe

Lindore nga Ballkani. Elementi i parë është se Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja kanë synuar ta parandalojnë konfliktin, ta ruajnë qetësinë. Elementi i dytë është mbështetja e reformave ekonomike dhe demokratike, ndërsa elementin e tretë e paraqet mbështetja e vendeve të Evropës Qendrore nga vendet e BE-së.

Ish-ministri Hoxhaj përmendi edhe dialogun Kosovë-Serbi,

duke e quajtur si shumë të rëndësishëm, por që nuk ka dhënë ende rezultatet e pritshme. Ai theksoi se vendet perëndimore po bëjnë shumë në Kosovë dhe në rajon në kuptimin e përkrahjes dhe reformave në rrugën e demokracisë, por vërejtje se, megjithatë, rajoni i Ballkanit është në një situatë komplekse, në “status-quo”.

Z.Hoxhaj, duke ilustruar qëndrimin e BE-së ndaj vendeve të rajonit të Ballkanit, tha ndër të tjera se problemi kryesor që aktualisht po paraqitet në Bashkimin Evropian për vendet e rajonit nuk është çështja e anëtarësimit të shpejtë të të gjitha vendeve të rajonit, por pjesa më e rëndësishme është se a mundet BE-ja t'i rëndisë vendet e rajonit prej një faze në fazën tjetër në rrugën e integritimit.

Në përmbyllje, z.Hoxhaj përmendi edhe disa prej problemeve me të cilat ballafaqohet Kosova, siç janë liberalizimi i vizave, rruga e ngadaltë drejt integritimit evropian dhe të tjera.

Zëvendësministri i Jashtëm i Republikës së Çekisë, z.Petr Drulak dhe kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës, z.Enver Hoxhaj u përgjigjën edhe në një varg pyetjesh të studentëve, të cilët u interesuan të dinë më shumë detaje rreth temës dhe temave të tjera me interes.

## Studentët e UBT-së biseduan me kryeparlamentarin e Kosovës



11 qershor. - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, takoi sot në kabinetin e tij një grup studentësh të Shkencave Politike të UBT-së.

Kryetari i njohu studentët me punën dhe mënyrën e funksionimit të Kuvendit, rolet dhe funksionet e tij, duke potencuar njëkohësisht, edhe detyrat e obligimet që dalin para deputetëve dhe Kuvendit në përgjithësi, kundruall qytetarëve, njofton kumtesa nga Kuvendi.

Kryetari Veseli u përgjigj edhe në interesimet e studentëve përkitazi me angazhimet dhe përgjegjësitë e tij në krye të Kuvendit të Kosovës, por edhe për zhvillimet nëpër të cilat po kalon vendi ynë. (<http://www.kuvendikosoves.org>)

## Studentët e Arkitekturës vizituan laboratorin “Proing”

24 qershor. - Studentët e Arkitekturës në UBT, në kuadër të vizitave studimore, vizituan laboratorin “Proing”. Vizita e realizuar në kuadër të lëndës Materialet në Arkitekturë shërbeu për të parë në praktikë një varg testimesh të ndryshme që realizohen në këtë laborator.



## DIPLOMATË TË HUAJ VIZITORË TË SHPESHTË NË UBT

## AMBASADORI I NORVEGJISË, JAN BRAATHU MBAJTI LIGJËRATË NË UBT



Ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, z. Jan Braathu, sot ishte mysafiri i radhës në Akademinë verore në UBT. Fillimisht, ai u përshëndet nga Rektori i UBT-së, Prof.Dr. Edmond Hajrizi, stafi akademik dhe studentët e Shkencave Politike dhe të Medias dhe Komunikimit.

Z. Braathu ligjërojë në temën "Raportet midis diplomacisë dhe medias".

Në një ekspozitë shumë të hapur dhe të drejtpërdrejtë, z.Braathu analizoi raportin e mediave në diplomaci dhe raportin e gazetarëve me diplomatët. Në veçanti apostrofoi këtë

raport nga këndi i eksperiencës së tij diplomatike në Kosovë në momentet e vendimmarrjes për çështjet me interes të madh publik, kur roli i mediave ishte me ndikim më të madh.

Ambasadori Braathu theksoi se në karrierën e tij gjithmonë ka qenë në funksion të interesave të shtetit norvegjez, pavarësisht se a i kanë konvencuar këshillat, sugjerimet dhe qëndrimet e ambasadorit zyrtarëve politikë në vendet ku ka ushtruar detyrën e ambasadorit.

Ai në një bisedë të ngrohtë dhe të gjatë iu përgjigj pyetjeve të shumta të studentëve, duke apostrofuuar veçmas sugjerimin e tij për formimin e Gjykatës Speciale, ngase gjykata nuk e dënon Kosovën as UÇK-në, por mosformimi i saj zbeh miqësinë e atyre që kanë kontribuar për çlirimin dhe ndërtimin e saj.

### Ambasadori i Shqipërisë flet para studentëve të UBT-së



### Ambasadori Qemal Minxhozi flet për ndikimin e medias në hapësirën mbarëshqiptare

9 korrik . - Ambasadori i Republikës së Shqipërisë, z.Qemal Minxhozi vizitoi dje UBT-në, ku u prit nga drejtues të këtij institucioni, të cilët e njoftuan me aktivitetet që zhvillohen në UBT.

Pas kësaj, z.Minxhozi mbajti një ligjëratë para studentëve të UBT në temën "Ndikimi i medias në hapësirën mbarëshqiptare", në kuadër të Akademisë Verore të UBT-së.

Pas debatit, ambasadori Minxhozi zhvilloi një debat me studentët.

### U hap ekspozita tradicionale e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT



8 korrik. - Në një ceremoni organizuar në kampusin inovativ të UBT-së, sot është hapur ekspozita tradicionale e organizuar nga Departamenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT.

Ekspozita, e cila tashmë ka një traditë disavjeçare të organizimit, sivjet përfshin në vete mbi 150 punime të ekspozuara të studentëve të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, punime këto nga lëndë të ndryshme të studimeve.

Ekspozita është pjesë edhe e ekspozitës "Prishtina Architecture Eëek" dhe ceremonia hapëse saj u përcoll nga studentë, profesorë, prindër dhe përfaqësues të institucioneve partnere të UBT-së.

Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi, në çelje të ekspozitës, theksoi se ngjarje si kjo ekspozitë e studentëve janë shenjë e rritjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm të institucionit dhe të përparimit të studentëve, punimet e të cilëve nga viti në vit janë më profesionale dhe më domethënëse.

Ai falënderoi profesorët dhe studentët që u angazhuan dhe krijuan punime për një ekspozitë kaq madhështore dhe profesionale.

Për punën rreth përgatitjes së ekspozitës foli dekani, Dr.Lulzim Beqiri.

Ceremoninë e përshëndetën edhe Eljesa Surdulli, kryetar i Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës dhe arkitekti Bekim Ramku.

Në fund të ceremonisë u dhanë edhe shpërblimet tradicionale.

## STUDENTË TË UBT-SË NË PUNËTORINË "CYBER SECURITY EXERCISES" NË PRAGË TË ÇEKISË

Një numër studentësh të UBT-së kanë marrë pjesë në punëtorinë "Cyber Security Exercises", organizuar në Pragë të Çekisë më 29 dhe 30 qershor. Punëtorja është organizuar në kuadër të projektit transregjional të financuar nga Komisioni Evropian "Enhancing Cyber Security", përfitues të të cilit janë Republika e Kosovës, ajo e Maqedonisë dhe ajo e Moldavisë.

Njëri nga studentët e UBT-së, pjesëmarrës në punëtorinë, Atdhe Buja theksoi se punëtorja është shumë e rëndësishme për përballjen e trajtimit më tutje të sulmeve kibernetike si Netëork forensics, Phishing attack dhe Large scale incident handling.



Vlen të theksohet se nga pjesëmarrësit nga Kosova shumica ishin studentë të UBT-së.

Pas punëtorisë, studentët dhe gjithë pjesëmarrësit nga Kosova në këtë punëtorinë vizituan

Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë, ku u pritën nga diplomati Adriatik Kryeziu dhe u njohën më shumë për punën që bën Ambasada e Kosovës në këtë shtet.

## UBT dhe TEB Bank nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi



24 qershor. - UBT ka nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi, në vazhden e zgjerimit të bashkëpunimit me institucione vendore e ndërkombëtare, në të mirë të krijimit të kushteve sa më të mira për studime dhe për hulumtime për studentët, por edhe për stafin e institucioneve partnere.

Marrëveshja e nënshkruar dje me bankën TEB ndërlidhet me shfrytëzimin e inkubatorit të biznesit në UBT nga kjo bankë, me qëllim të avancimit të ndërmarrësisë për studentë dhe entuziastë me ide inovative biznesi.

Marrëveshja u nënshkrua nga rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi dhe zëvendësrejtori menaxhues në TEB, z.Arton Celina.

UBT dhe TEB zhvillojnë bashkëpunim edhe në fusha të tjera dhe janë partnerë në shumë projekte në ndërmarrësi.



QENDRA PËR HULUMTIMIN E OPINIONIT E UBT-SË PREZANTOI HULUMTIMIN “AFTËSITË E KËRKUARA NË FUSHËN E TIK-UT NË KOSOVË”

# ÇKA KËRKOJNË KOMPANITË E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË KOSOVË – PËRVOJË PUNE APO DIPLOMË

Nga anketimi i 60 kompanive të teknologjisë informative në Kosovë del se kompanitë më së shumti çmojnë përvojën e punës në pozita të ngjashme (25 për qind), aftësitë për zgjidhjen e problemeve (14.2 për qind), ndërsa diploma universitare është vetëm në vendin e tretë (11.36 për qind). Por, megjithatë, ato 52.13 për qind e të punësuarve i kanë me nivelin master të edukimit, 36.92 për qind me nivelin baçelor, 6.15 me nivelin e doktoratës dhe vetëm 4.62 për qind janë me shkollë të mesme

24 korrik. – Qendra për Hulumtimin e Opinionit, që vepron në kuadër të UBT-së, ka prezantuar sot rezultatet e hulumtimit “Aftësitë e kërkuara në fushën e TIK-ut në Kosovë”.

Përfaqësues nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, përfaqësues nga institucionet e vendit dhe përfaqësues nga kompani të ndryshme nga fusha e teknologjisë informative dhe mysafirë të tjerë përcollën rezultatet e hulumtimit, qëllimi kryesor i të cilit është hulumtimi i aftësive të kërkuara në fushën e TIK-ut në Kosovë.

Hulumtimi është realizuar në formë të anketimit direkt dhe elektronik. Ai ka përfshirë 60 kompani të ndryshme që merren me teknologji informative në të gjitha rajonet e Kosovës. Qasja përmes anketimit direkt është përzgjedhur si formë e cila do të ofrojë të dhëna direkte nga kompanitë që ofrojnë shërbime në TIK dhe adreson mangësitë e njohurive, të cilat punonjësit e kompanive teknologjike duhet të posedojnë.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, i çmoi rezultatet e anketës si shumë me interes për institucionet shtetërore, ato akademike dhe për kompanitë e teknologjisë informative.

Ai theksoi nevojën që në Kosovë të ketë më shumë bashkëpunim midis institucioneve shtetërore, institucioneve akademike dhe industrisë, me qëllim të zhvillimit sa më të mirë të kësaj fushe, në hap me trendet e zhvillimit ndërkombëtar,



Disa nga treguesit më të rëndësishëm të anketës po i shpalosim në vijim.

Në pyetjen cili është niveli i edukimit të punëtorëve në kompanitë e TIK-ut, anketa ka treguar se 52.13 për qind e të punësuarve janë me nivelin master të edukimit, 36.92 për qind me nivelin baçelor, 6.15 me nivelin e doktoratës dhe vetëm 4.62 për qind janë me shkollë të mesme.

Të pyetur sa i adreson shkathësitë e nevojshme për punë kurrikula mësimore që aplikohet në edukimin e lartë, 64.91 për qind janë shprehur se i adreson mesatarisht, 22.81 për qind aspak dhe 12.28 për qind plotësisht.

Anketa ka përfshirë edhe një pyetje lidhur me trajnimin e punëtorëve në kompanitë e teknologjisë informative. 75.81 për qind kanë theksuar se trajnimi bëhet brenda kompanisë, 14.52 për qind se ky trajnim bëhet jashtë kompanisë dhe 9.68 për qind kanë theksuar se punëtorët nuk trajnohen fare.

Madje 80.33 për qind deklarojnë se kompania fare nuk është konsultuar me institucionet që ofrojnë trajnime, që do të thotë se vetëm 19.67 për qind kanë bërë këtë.

Pyetja tjetër ka të bëjë me mënyrën e përdorur nga ofruesit e arsimit të lartë për të kontaktuar

kompanitë. Del se në 40 për qind të rasteve kjo është bërë përmes anketimit, në 33 për qind të rasteve përmes grupeve punuese dhe në 27 për qind të rasteve përmes debatit publik.

Përgjigje shumë interesante ka nxjerrë pyetja në lidhje me shkathësitë teknike që ju nevojiten kompanive të TIK-ut. Anketa ka nxjerrë se ato çmojnë më së shumti Konfigurimet (16 për qind), vendin e dytë e zë Dizajni (14 për qind) dhe të tretin Certifikimet, si në Cisco, ECDL, Windows (13.33 për qind). Më tutje renditen Web programimi, Administrimi i bazës së të dhënave, Programimi server-klient e të tjera.

Ndërsa, kur janë pyetur për gjuhët programuese që janë më të kërkuarat në treg, të anketuarit kanë bërë këtë renditje: Java (25.25 për qind), C++ (21.21 për qind), PHP (19.19 për qind) C# (13.13 për qind) e të tjera, si ASP, C, Python e Perl.

Përgjigje mjaft interesante janë dhënë në pyetjen cilat aftësi kërkohen më së shumti nga kompanitë e TIK-ut. Del se kompanitë më së shumti çmojnë përvojën e punës në pozita të ngjashme (25 për qind), aftësitë për zgjidhjen e problemeve (14.2 për qind), ndërsa diploma universitare është vetëm në vendin e tretë (11.36 për qind). Kompanitë çmojnë edhe njohjen e gjuhëve (amtare dhe të huaj), trajnimet dhe certifikimet, aftësitë e hulumtimit e të tjera.

Anketa ka përfshirë edhe pyetjen në lidhje me mangësitë e vërejtura te punëtorët e rinj. Në përgjigje dominojnë mangësitë në zgjidhjen e probleme (14.44 për qind), problemet me shkathësitë e komunikimit (12.78 për qind), mangësitë në njohjen e pajisjeve teknologjike (10 për qind) e të tjera.

Pas paraqitjes së rezultateve të anketës, pjesëmarrës nga fusha akademike dhe përfaqësues të kompanive të teknologjisë informative zhvilluan një debat të gjerë lidhur me të gjeturat e anketës dhe gjendjes në të cilën është teknologjia informative sot në Kosovë.

## “HORIZON 2020” – MUNDËSI E MADHE PËR FUSHËN E HULUMTIMIT DHE TË INOVACIONIT

Rektori i UBT-së, prof. Dr. Edmond Hajrizi ka prezantuar sot mundësitë që për kompanitë e teknologjisë informative dhe institucionet e tjera në Kosovë ofron Programi Kornizë i Bashkimit Evropian për Kërkime dhe Inovacion “Horizon 2020”

Ky program përkrah sektorin e teknologjive të reja dhe të së ardhmes dhe Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK).

Me vendim të ministrit të Arsimit të Republikës së Kosovës, rektori Hajrizi është i emëruars i Pikë Kombëtare e Kontaktit (PKK) për Programin “Horizon 2020” në Kosovë.


Rektori Hajrizi theksoi se në fushën e hulumtimit dhe




të inovacionit, Programi “Horizon 2020”, për periudhën 2014-2020 ka vënë në dispozicion 80 miliardë euro.

Ai gjithashtu theksoi se tri prioritetet në këtë fushë janë: Excellentscience, Industrial leadership dhe SocietalChallenger.

### ÇFARË ËSHTË NIVELI I EDUKIMIT TË PUNËTORËVE NË KOMPANITË E TIK-UT?



### SA I ADRESON SHKATHËSITË E NËVOJSHME PËR PUNË KURRIKULA MËSIMORE QË APLIKOHET NË EDUKIMIN E LARTË?







Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

#### Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathtësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

#### Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

#### Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

#### Shkathtësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

#### Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

#### Drejtimi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktëve
- Aqum Comunnitë e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathtësi Diplomatie
- State Protocol

#### Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

#### Teknologji Informative

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

#### Arkitekturë dhe Planifikim

- Hapësiror
- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

**Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.**

## ZGJEROHET BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I UBT-SË

**UBT DHE UNIVERSITETI "CORVINUS" NËNSHKRUAN MEMORANDUM TË MIRËKUPITIMIT**

Ky memorandum bashkëpunimi mes UBT-së dhe Universitetit "Corvinus", që është universiteti më i madh në Hungari, krijon mundësi për shkëmbimin e studentëve dhe të mësimdhënësve, ofrimin e studimeve të doktoratës, bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve e një varg fushash të tjera të bashkëpunimit



4 mars. – Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi dhe prorektori i Universitetit "Corvinus" me seli në Budapest të Hungarisë, dr. László Palkovics, nënshkruan një Memorandum bashkëpunimi mes dy institucioneve.

Ky memorandum bashkëpunimi mes UBT-së dhe Universitetit "Corvinus", që është universiteti më i madh në Hungari, krijon mundësi për shkëmbimin e studentëve dhe të mësimdhënësve, ofrimin e studimeve të doktoratës, bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve e një varg fushash të tjera të bashkëpunimit.

Gjithashtu, z.Hajrizi dhe z. Palkovics u dakorduan për

shtirjen e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus Plus, që përfshin mobilitetin e stafit dhe të studentëve dhe pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta.

Ata gjithashtu theksuan mundësitë e mëdha të bashkëpunimit në kuadër të projektit "Horizon 2020".

Dr. László Palkovics u njoftua nga rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi për funksionimin e UBT-së në sferën e arsimit të lartë, me theks të veçantë me partneritetet ndërkombëtare, ku UBT është institucion që ka marrëveshje bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet më prestigjioze akademike në Evropë e më gjerë.

Prorektori i Universitetit "Corvinus", z. Palkovics u shpreh më fjalë miradije për UBT-në dhe të arriturat e tij, që kanë qenë faktor kryesor që universiteti që ai përfaqëson ta zgjedhë pikërisht UBT-në për vendosjen e bashkëpunimit sa më të afërt.

Ai gjithashtu theksoi se Universiteti "Corvinus" është pjesë e shumë projekteve ndërkombëtare, pjesë e të cilave është UBT, në shumë prej tyre si i vetmi institucion përfaqësues nga rajoni e më gjerë. Në këtë vazhde, bashkëpunimi mes dy institucioneve do të jetë shumë më i lehtë dhe do të hapë perspektivë për stafin dhe studentët e të dy institucioneve akademike.

**UBT realizon vizitë të suksesshme në Corvinus University**

Udhëheqësit e Corvinus University u zotuan që do të përkrahin UBT-në në arritjen e misionit fisnik që konsiston në rritjen e cilësisë së sektorit të edukimit universitar dhe në gjenerimin e projekteve kërkimore-shkencore që do të prodhonin rezultate konkrete për ekonominë kosovare



15 qershor. - Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi dhe Zyra për Marrëdhënie ndërkombëtare e përfaqësuar nga PhD cand. Ermal Lubishtani realizuan një vizitë të suksesshme në njërin nga institucionet universitare më të respektuara në Budapest, Hungari. Në këtë vizitë ata u takuan me udhëheqësit më të lartë të Corvinus University, duke përfshirë rektorin Prof. Zsolt Rostov nyi, prorektorin për Kërkime Shkencore Prof.

Dr. L. szló Palkovics, dekanë dhe udhëheqës të tjerë të lartë të Corvinus University. Qëllimi i vizitës ishte forcimi i bashkëpunimit në mes të dy institucioneve të arsimit të lartë me fokus të veçantë në rritjen e shkëmbimit të stafit akademik, studentëve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta akademike dhe shkencore.

Gjatë kësaj vizite, u prezantuan të arriturat e UBT në sektorin e edukimit universitar në Kosovë

si dhe u debatuan planet për zhvillim të qëndrueshëm të institucionit tonë. Udhëheqësit e Corvinus University u zotuan që do të përkrahin UBT-në në arritjen e misionit fisnik që konsiston në rritjen e cilësisë së sektorit të edukimit universitar dhe në gjenerimin e projekteve kërkimore-shkencore që do të prodhonin rezultate konkrete për ekonominë kosovare.

Në fund të vizitës, Rektori Hajrizi i ftoi udhëheqësit e Corvinus University që të jenë pjesë e konferencës tradicionale të UBT-së që mbahet në nëntor dhe në këtë mënyrë të vazhdohet rritja e këtij bashkëpunimi ndër-institucional.

Rritja kualitative e bashkëpunimit ndërkombëtar vazhdon të jetë nja nga synimet strategjike të UBT-së.

**UBT vazhdon bashkëpunimin me Universitetin e Varshavës**

Bashkëpunimi midis UBT-së dhe Universitetit të Varshavës është zhvilluar fillimisht nëpërmjet projektit "Erasmus Mundus", për shkëmbim të studentëve dhe stafit, si dhe përmes vizitave të dyanshme

16 qershor. - Një delegacion nga Universiteti i Varshavës në Poloni qëndroi më 8 dhe 9 qershor për vizitë në UBT.

Drejtues të UBT-së dhe të Universitetit të Varshavës diskutuan gjatë këtyre dy ditëve për një varg çështjesh me interes për të dy institucionet, të cilat kanë një bashkëpunim në shumë fusha tash disa vite me radhë.

Bashkëpunimi midis UBT-së dhe Universitetit të Varshavës është zhvilluar fillimisht nëpërmjet projektit "Erasmus Mundus", për shkëmbim të studentëve dhe stafit, si dhe përmes vizitave të dyanshme. Dy vite më parë, ndërkaq, të dy institucionet nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, përmes së cilës, për herë të parë në Kosovë, Universiteti i Varshavës ofron programe për studime bachelor dhe master në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Universiteti i Varshavës është themeluar në vitin 1816. Është ndër top universitetet e kategorisë botërore dhe universiteti numër një në Poloni.

UBT dhe Universiteti i Varshavës do të vazhdojnë edhe më tej bashkëpunimin, duke e zgjeruar atë edhe në fusha të tjera.

**UBT nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**

Shkodër, 29 maj, - Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi vizitoi Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Pas pritjes nga drejtues të këtij universiteti, u nënshkrua marrëveshja midis UBT-së dhe Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", e cila përfshin bashkëpunimin në shumë fusha, përfshirë mobilitetin e studentëve dhe të stafit dhe punëtoritë e përbashkëta në fusha të ndryshme të hulumtimit shkencor.

Dr.Hajrizi, i cili është ekspert në fushën e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit të universiteteve, gjatë qëndrimit në Shkodër ka drejtuar punëtorinë "Standardet institucionale dhe raportet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve në dy cikle të studimeve në universitete", në të cilën morën pjesë një numër i madh i stafit menaxhues të Universitetit, dekanë, profesorë dhe studentë të Universitetit të Shkodrës.

Rektori i UBT-së, i licencuar nga institucione ndërkombëtare edhe për një varg fushash të trajnimit, paraqiti në punëtori përvojat e vlerësimit të cilësisë në UBT, përgjithësisht në Republikën e Kosovës, por edhe përvoja nga universitete e institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Pjesëmarrësit e punëtorisë përfituan nga përvoja e rektorit Hajrizi në këtë fushë dhe shtruan për diskutim një varg çështjesh me interes nga fusha e vlerësimit të cilësisë së programeve akademike.

Drejtuesit e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" u shprehën shumë të kënaqur me përvojat e fituara, si dhe e vlerësuan si shumë të rëndësishme marrëveshjen me UBT-në, një institucion prijatar në shumë fusha të arsimit të lartë dhe të hulumtimit shkencor, jo vetëm në Kosovë e në rajon, por edhe më gjerë.

UBT dhe Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" u morën vesh që të organizojnë këtë vit një konferencë të përbashkët në qytetin e Shkodrës.

Gjatë qëndrimit në Shkodër, rektori Hajrizi dha intervista për televizionet "Top Channel" dhe "Star Plus".



NË KOTOR TË MALIT TË ZI

# PROFESORËT E UBT-SË NË TAKIMIN SELEKTUES TË ORGANIZUAR NGA PROJEKTI ERASMUS MUNDUS "SIGMA AGILE"

Profesorët e UBT-së, Lulzim Beqiri dhe Ermal Lubishtani kanë qëndruar për disa ditë në Kotor të Malit të Zi.

Ata kanë marrë pjesë në takim selektues të organizuar nga projekti ERASMUS MUNDUS "Sigma Agile", në të cilin morën pjesë edhe përfaqësues të universiteteve nga Evropa dhe Ballkani Perëndimor.

Takimi ka shërbyer për përzgjedhjen e kandidatëve që kanë aplikuar për mobilitet në 5 nivele: Bachelor, Master, PhD, Post Doc dhe Staff.

Mobilitetet do të fillojnë deri në fund të dhjetorit 2015, ndërsa projekti do të zgjasë deri në vitin 2018.

Universitetet nga Ballkani Perëndimor, që morën pjesë në takim, ishin: UBT e Universiteti i Prishtinës nga Republika e Kosovës; nga Shqipëria ishin Universiteti Evropian i Tiranës, Universiteti i Shkodrës dhe Universiteti i Vlorës; Universiteti i Podgoricës nga Mali i Zi; nga Bosnja dhe Hercegovina ishin Universiteti i Sarajevës, Universiteti i Bihaqit dhe Universiteti i Mostarit; nga Serbia Universiteti i Novi Sadit dhe Universiteti i Nishit.

Ndërsa Universitetet partnere nga BE ishin: University of Warsaw-Poland, City University London-UK, Humboldt Universiteti zu Berlin-Germany, Lappeenranta University of Technology-



Finland, University of Milan-Italy, University of Salzburg-Austria,

University of Twente, ITC Faculty-Netherland, Universitat Pompeu

Fabra - Spain, University Nova de Lisboa-Portugal.

## BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

### STUDENTËT E UBT-SË PJESË E PUNËTORISË SHTATËDITORE "LINKING ALBANIA, KOSOVA AND MACEDONIA"

Studentët e Arkitekturës në UBT morën pjesë edhe në përmblylljen e punëtorisë, që u organizua në Vjenë

Studentët e UBT-së, të programit Master për Arkitekturë, qenë pjesë e punëtorisë shtatëditore "Linking Albania, Kosova and Macedonia" të organizuar mes UBT, Universitetit Publik të Prishtinës, Universitetit të Tetovës, Universitetit Teknik të Vjenës, AAB dhe Universitetit Polis.

Punëtorija pati si qëllim studimin e regjionit ndërkufitar që lidh mes vete Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë, me ç'rast edhe vizituan Prishtinën, Tiranën, Valbonën, Tetovën, Gjakovën, Prizrenin dhe Pejën.

Me ekspertë nga fusha e Planifikimit Hapësinor, grupet e studentëve trajtuan këto regjione për të nxjerrë në pah të përbashkëtat e këtyre vendeve, si dhe analizuan metodat që mund të aplikohen për të sjellë më afër dhe për të nxitur një bashkëpunim të ngushtë ndërregjional të këtyre vendeve.

Turizmi mbetet si përherë pika lidhëse si mjet që do të kishte impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të këtyre qyteteve, përveç që do të krijonte marrëdhënie të

ndërsjella sociale, ekonomike e shoqërore mes qyteteve në anën tjetër të kufirit.

Dita përmblyllëse e punëtorisë mobile "Linking Albania, Kosova and Macedonia" u mbajt në Kolegjin UBT me ç'rast studentët prezantuan strategjinë e tyre për zhvillimin e këtyre vendbanimeve.

Në vijim të punëtorisë, studentët e Fakultetit të Arkitekturës të UBT-së vizituan Fakultetin Teknik të Bratisllavës, Sllovakia, ku u pritën nga profesori Marosh Finka dhe zyrtarë nga Departamenti i Urbanizimit të Bratisllavës. Ata u njoftuan me zhvillimet e fundit të qytetit të Bratisllavës dhe bashkëpunimet e fundit të kryeqytetit sllovak me Vjenën, drejt krijimit të qyteteve "Smart". Ata u njohën gjithashtu me strategjitë e përpiluara nga të dy kryeqytetet dhe përparimet e bëra në drejtim të afrimit të këtyre qyteteve, gjithmonë duke pasur si qëllim ruajtjen e ambientit dhe nxitjen e politikave të ruajtjes së energjisë dhe shfrytëzimit të energjive të rinovueshme. Pas kthimit në Vjenë ata ndoqën prezantimin

mbi historinë e zhvillimit Urban të Vjenës nga Prof. Gerhard Schimack dhe Skender Kosumi.

Të nesërmen ata përmblyllën punëtorinë me prezantimet finale që u mbajtën në ambientet e Universitetit Teknik të Vjenës. Të gjitha punimet pritet së shpejti të jenë pjesë e publikimit të fundit të TU.

Gjithashtu ceremonia përmblyllëse zuri vend në Heuriger Kierlinger, me një nga netët tradicionale vjeneze të shoqëruara me ushqim lokale dhe verë tradicionale të regjionit.

Studentët, po kështu, të udhëhequr nga profesor Skender Kosumi vizituan disa nga objektet më të njohura të Arkitekturës Moderne në Vjenë. Në hapësirat e Kampusit të Fakultetit Ekonomik ata u pritën nga udhëheqësi i Projektit të objektit, arkitektja me famë botërore Zaha Hadid dhe Peter Cook, arkitekt.

Më pas ata vizituan edhe objektin DC Toëer që ofron pamje të gjithë qytetit të Vjenës dhe objekte të tjera të njohura.

## UBT ORGANIZOI PUNËTORI ME EKSPERTË NDËRKOMBËTARË PËR THEMELIMIN E INKUBATORIT TË BIZNESIT

Në kuadër të projektit për Inkubatorin Virtual të Kosovës dhe Qendrën për fillimin e bizneseve të reja, UBT ka organizuar një varg punëtorish me ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë të kësaj fushe. George Lantzas ishte eksperti i radhës i cili mori pjesë në punëtorinë e radhës, ku janë diskutuar një varg temash me interes.

Temë e veçantë e punëtorisë ishte ndërlidhja e modelit të UBT me praktikën e mira ndërkombëtare për funksionimin e inkubatorit brenda UBT-së, jetësimi i tij dhe përshtatja sa më e mirë me rrethanat në Kosovë, duke bërë që ky inkubator të jetë përkrahës i ndërmarrësve dhe ideatorëve të rinj dhe të rezultojë me sukses.

Ky inkubator planifikohet të ketë një hapësirë të veten përbrenda UBT-së me pajisje përcjellëse dhe hapësirë pune. Ai do të jetë i gatshëm brenda 30 ditëve të ardhshme, ku edhe do të hapet konkursi për studentët dhe alumin e UBT-së që të aplikojnë dhe të sjellin idetë e tyre.

Inkubatori i biznesit është projekt i përbashkët i UBT-së dhe Ambasadës së SHBA në Kosovë.

Gjithashtu, në kuadër të inkubatorit të biznesit do të publikohet një magazinë mbi ndërmarrësinë, me disa edicione brenda vitit.

## STUDENTJA BLENDINA LLABJANI ËSHTË PUNËSUAR NË "INTERLEX ASSOCIATES"

Ajo i ka filluar studimet në UBT në vitin 2012, ndërsa tash është punëtore e rregullt e kësaj kompanie

Studentja e vitit të tretë të Fakultetit Juridik në UBT, Blendina Llabjani është punësuar në Zyrën ligjore "Interlex Associates" në Prishtinë, pas një periudhe internshipi prej gjashtë muajsh kryer në këtë zyrë, përmes Qendrës së Karrierës së UBT-së.

Ajo i ka filluar studimet në UBT në vitin 2012, ndërsa në periudhën nga tetori 2014 deri në prill 2015 ka qenë në internship në "Interlex Associates", ku tashmë është punëtore e rregullt e kësaj kompanie.

"Përveç shumë privilegjeve të tjera që më ka mundësuar UBT, falë Qendrës së Karrierës së UBT-së, e cila ka bashkëpunim për ofrimin e mundësive praktike për studentët me Zyrën ligjore "Interlex Associates" kam filluar praktikën në këtë zyrë ligjore. Kjo më mundësoi mua si studente që mësimet e mësuara në teori t'i zbatoj në praktikë, duke marrë pjesë në seanca gjyqësore, duke përpiluar vetë akte juridike të përgjithshme dhe të veçanta dhe punë të tjera administrative", thotë Llabjani, duke shtuar se pas përfundimit të aftësimimit profesional Zyra ligjore "Interlex Associates" i më mundësoi të vazhdojë të jetë pjesë e stafit të kompanisë, tash si punëtore e rregullt.

"Si studente e UBT-së kam një rekomandim për studentët e tjerë, që të mos hezitojnë të aplikojnë për punë praktike, sepse është një mundësi shumë e mirë për ta që në të ardhmen të bëhen pjesë e kuadrove të ndryshme profesionale", thekson Blendina Llabjani.

## SEMRA TYRBEDARI-ÇITAKU MBAJTI NJË LIGJËRATË NË UBT

19 maj. - Semra Tyrbedari-Çitaku, udhëheqëse e Departamentit për Politikë Ekonomike dhe Publike në Ministrinë e Financave e Republikës së Kosovës ka mbajtur një ligjëratë në UBT.

Tema e ligjëratës kishte të bënte me zhvillimet

aktuale në Kosovë në aspektin makroekonomik, me fokus të veçantë në Makroekonominë e Aplikuar dhe në Buxhetim dhe ajo u ndoq me mjaft interesim nga një numër i konsiderueshëm studentësh nga Fakulteti i Menaxhmentit,

Biznesit dhe Ekonomisë, Sistemet e Informacionit, Politikat Publike dhe Menaxhimi dhe studentët të interesuar nga fakultetet tjera.

Ligjëratat zgjoi interesim te studentët gjë që krijoi ambient dhe klimë të mirë diskutimi.

## ZGJEROHET BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I UBT-SË

## UBT TANI PJESË EDHE E CEEEPUS-IT

CEEEPUS përfshin vendet e Evropës Qendrore dhe Evropës Juglindore dhe është një rrjet universitar që ofron programe dhe diploma të përbashkëta për studentët e institucioneve anëtare



UBT vazhdon edhe më tej të jetë prijatë në anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare, që krijojnë mundësi për sigurimin e bursave për studentët dhe shumë mundësi të tjera përparimi në karrierë.

Në këtë vazhdë, UBT është bërë pjesë e projektit CEEEPUS («Central European Exchange Program for University Studies»).

CEEEPUS përfshin vendet e Evropës Qendrore dhe Evropës Juglindore dhe është një rrjet universitar që ofron programe dhe diploma të përbashkëta për studentët e institucioneve anëtare.

UBT është pjesë e këtij rrjeti me tri programe për mobilitet të studentëve, duke u bërë institucioni i parë privat i arsimit të lartë në Kosovë që e ofron këtë mundësi për studentët e tij.

Duke u bërë pjesë e CEEEPUS-it, UBT bëhet institucion që është pjesë e të gjitha rrjeteve universitare dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë që ofrojnë mobilitet për studentët dhe stafin, duke hapur perspektiva të qarta për studentët që të bëhen pjesë e institucioneve ndërkombëtare akademike dhe të përfitojnë nga përvojat akademike në universitetet më të njohura në Evropë e më gjerë.

## DREJTUES TË UBT-SË QËNDRUAN NË DUBROVNIK TË KROACISË

Mbi 20 universiteteve evropiane shprehin interesimin për bashkëpunim me UBT-në

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi dhe drejtori për çështje akademike në UBT, dr.Ardian Emini qëndruan në Dubrovnik të Kroacisë, ku morën pjesë në një takim organizuar nga DAAD, OAED dhe Zyra Kroate e Programit Erasmus.

Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve akademike nga shumë shtete të rajonit dhe më gjerë nga vendet e Evropës.

Rektori Hajrizi dhe drejtori Emini zhvilluan një varg takimesh me përfaqësues të mbi 20 universiteteve nga Gjermania, Austria, Sllovenia, Kroacia e vende të tjera, të cilët kanë shprehur interesimin për bashkëpunim me UBT-në në fushën e mobilitetit, ndërtimit të kapaciteteve dhe në partneritetet strategjike.

“Takimet e shumta me drejtues universitetesh prestigjioze dhe interesimi i tyre për vendosjen e bashkëpunimit me UBT është një lajm shumë i mirë dhe krijon mundësi shumë të mëdha për studentët dhe stafin e UBT-së”, theksoi dr.Hajrizi.

UBT ishte i vetmi institucion nga Kosova, pjesëmarrës në takimin e Dubrovnikut.

## DR.ANITA MIRIJAM DOTTER NGA UNIVERSITETI LINNAEUS LIGJËROI PARA STUDENTËVE TË UBT-SË

Ligjëratën e saj me titull “Analiza, dizajnimi dhe modelimi i sistemeve të informacionit”, e përcollën një numër i madh i studentëve, të cilët u shprehën shumë të kënaqur me materien e shtjelluar nga zonja Mirijamdotter

Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare, në UBT këtë javë ishte për ligjërim Dr.Anita Mirijamdotter nga Universiteti Linnaeus i Suedisë, e cila mbajti një cikël ligjëratash me studentët e nivelit master në drejtimin Sistemet e Informacionit.

Ligjëratën e saj me titull “Analiza, dizajnimi dhe modelimi i sistemeve të informacionit”, e përcollën një numër i madh i studentëve, të cilët u shprehën shumë të kënaqur me materien e shtjelluar nga zonja Mirijamdotter.

Ata gjithashtu theksuan faktin se përmes sjelljes së profesorëve nga universitetet prestigjioze në UBT, u krijohej mundësi të shumta të mësimin të përvojave dhe dijeve të reja.

Gjithashtu, dr.Anita Mirijamdotter u prit në një takim nga rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi. Në takim u diskutua për bashkëpunimin e deritashëm mes UBT-së dhe Universitetit Linnaeus, i cili është i shtrirë në disa fusha.

Po kështu, u diskutua për bashkëpunimin në të ardhmen, në kuadër të projektit Erasmus +, projekte të përbashkëta hulumtuese dhe zhvillime të tjera, sic është shkolla verore e të tjera.

Dr. Anita Mirijamdotter është profesoreshë e Informatikës në Universitetin Linnaeus, Suedi, që nga viti 2008, ku është edhe Shefe e Departamentit të Informatikës. Gjatë periudhës 2010-2012



ajo ishte prodekane e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Inxhinierisë, si dhe kryesoi Komitetin e Fakultetit dhe Bordin për Emërime Akademike. Ajo ka mbikëqyrur një numër të madhe studentësh të doktoratës.

Gjithashtu, dr. Mirijamdotter është paraqitur në një numër të madh konferencash ndërkombëtare, si dhe ka një numër të madh publikimesh në revista shkencore.

## REKTORI HAJRIZI MORI PJESË NË KONFERENCËN RAJONALE PËR ARSIMIN E LARTË DHE HULUMTIMIN SHKENCOR

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi mori pjesë në Konferencën Rajonale për Arsimin e Lartë dhe Hulumtimin Shkencor, organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Konferenca e organizuar në Prishtinë ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet Republikës së Kosovës, rajonit dhe më gjerë në fushën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

Ministrat e Arsimit të Kosovës, dr.Arsim Bajrami, të Shqipërisë, Lindita Nikolla, dhe ai i Maqedonisë, Abdylaqim Ademi, udhëheqës të institucioneve arsimore publike dhe private, si dhe përfaqësues të organizatave që përkrahin arsimin në të tri vendet zhvilluan një debat të gjerë në temën e arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor.

Kosova dhe Shqipëria e kanë hartuar draftin e Ligjit të ri për arsimin e lartë, ndërkohë që Maqedonia gjithashtu ka hapur debatin në këtë temë.

Rektori i UBT-së, dr.Hajrizi dha kontributin e tij në konferencë me paraqitjen e pikëpamjeve të tij rreth temës.

Dr.Hajrizi është pjesë e ekipit të Ekspertëve për Reformën e Arsimit të Lartë në Kosovë (ERAL), i zgjedhur nga Komisioni Evropian.



## REKTORI I UBT-SË NË KONFERENCËN E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT DHE INOVACIONIT NË TEKNOLOGJI NË TIRANË

12 qershor. - Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi mori pjesë në konferencën e Sistemeve të Informacionit dhe Inovacionit në Teknologji, e cila i zhvilloi punimet më 5 dhe 6 qershor në Tiranë.

Konferenca e gjashtë Ndërkombëtare, e titulluar “Information Systems and Technology Innovations: inducing Modern Business Solutions”, u organizua nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (SMIZ) i Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, në bashkëpunim me UBT-në dhe me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Kjo konferencë është një nga më të rëndësishmet që zhvillohet për kërkuesit, akademikët, përfaqësuesit e biznesit dhe studentët e degëve të ndryshme të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

Në konferencë ishin të ftuar personalitete të larta, përfshirë zëvendëskryeministrin e Shqipërisë, z. Niko Peleshi, Ministrin e Inovacionit dhe Administratës Publike, znj. Milena Harito, Nën-kryetarin e Akademisë së Shkencave, z. Gudar Beqiraj, Rektoren e Universitetit të Tiranës, z. Dhori Kule, si dhe personalitete të huaja të shkencës nga universitete të Evropës dhe SHBA.

Konferencën e hapi Prof. Dr. Kozeta Sevrani, drejtoreshë e Departamentit të Statistikave dhe Informatikës së Zbatuar që përhëndeti të gjithë të ftuarit. Më pas fjalën e morën Ministrja e Inovacionit Milena Harito, Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, Drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit Marlinda Karçanaj dhe Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencës, Gudar Beqiraj.

Konferenca i zhvilloi në disa panele: “Siguria e informacionit”, “Inxhinieria dhe rrjetet”, “Informatika Cloud dhe Teknologjitë mobile”, “Ekonomia dixhitale dhe e-shërbimet”, “Modelimi dhe Simulimi”, “Sistemet e informatizuara” e të tjera.

Rektori i UBT-së, Prof.Dr.Edmond Hajrizi, si dhe profesorë dhe ekspertë të tjerë nga UBT-ja, dhanë kontributin e tyre me diskutimet në temat e shtruar në konferencë.



TAKIMIPËRMBYLLËS I PROJEKTIT NË KUADËR TË ACADEMIC EXCHANGE FORPROGRESS

## DREJTUES TË UBT-SË NË TAKIMIN PËRMBYLLËS TË PROJEKTIT NË KUADËR TË AEP-IT



Tetovë, 27 mars. - Drejtues të UBT-së, rektori prof.dr.Edmond Hajrizi dhe dekani i Fakultetit për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, dr.Muzafer Shala morën pjesë në takimin përmbyllës të projektit në kuadër të AEP (Academic Exchange for Progress), që u mbajt në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Ky program ka përfshirë partneritetin mes Universitetit Gjovik në Norvegji, UBT-së, Universitetit të Tiranës, Universitetit të

Prishtinës dhe Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë.

Programi ka përfshirë mobilitetin e profesorëve dhe studentëve, si dhe bashkëpunim në projekte të përbashkëta. Në kuadër të këtij programi, pesë studentë të UBT-së kanë qendruar nga një semestër në Universitetin Gjovik në Norvegji, ndërsa në po këtë universitet po i kryen studimet e doktoratës një student, që ka mbaruar studimet themelore dhe ato master

në UBT, dhe që është staf akademik i tij.

Në takimin e mbajtur në Tetovë u bë një rekapitullim i bashkëpunimit të deritashëm dhe i rezultateve të këtij bashkëpunimi, të cilat janë të shënuara dhe kanë hapur rrugë për bashkëpunim të mëtejshëm edhe në projekte të tjera të përbashkëta.

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi e vlerësoi lart bashkëpunimin në kuadër të këtij programi. Gjatë këtij programi, UBT ka realizuar suksese të shumta, si në fushën e sigurisë së informacionit, konferenca, punësim të studentëve dhe bashkëpunim me të afërt me industrinë, bashkëpunim me universitetet rajonale, posaçërisht me Universitetin e Tiranës dhe Departamentin për Siguri të Informacionit dhe shkencë, ku janë zhvilluar edhe shumë projekte të përbashkëta.

Përfaqësues të universiteteve, pjesëmarrës në takim, shtruan edhe një varg projektesh për bashkëpunimin në të ardhmen, në kuadër të programeve "Erasmus +", "Horizon 2020" e programe të tjera.

## NË UBT U MBAJT SESIONI INFORMATIV PËR BURSAT E FORUMIT EVROPIAN TË ALPBACH DHE IG ALPBACH KOSOVA



Prishtinë, 23 mars. - Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) është mbajtur sesioni informativ për bursat e Forumit Evropian të Alpbach në Austri, organizuar nga UBT në bashkëpunim me IG Alpbach Kosova.

Sesioni informativ për bursa ka zgjuar interesim të madh te studentët e UBT-së, por edhe te studentët e universiteteve të tjera në vend, të cilët në numër të madh e përcollën sesionin.

Shkumbin Asllani nga "Alpbach Kosova", që bëri prezantimin e programeve për bursa, theksoi se organizata që përfaqëson, duke u nisur nga bashkëpunimi shumë i mirë me UBT-në, ka vendosur që të japë dy bursa të plota për dy studentë të këtij institucioni.

Z.Asllani në paraqitjen e tij fillimisht falënderoi UBT-në dhe rektorin Edmond Hajrizi

për bashkëpunimin për vite të tëra.

Ai tha se Forumi Alpbach organizohet në Austri çdo vit, ku shtrohen për diskutim çështje të rëndësishme, ndërsa tema për këtë vit është pabarazia.

Ai në vazhdim tha se Forumi Alpbach pranon rreth 450 studentë dhe gjithsecili student mund të jetë pjesë e këtij forumi, në kuadër të të cilit mund të diskutohen çështje të ndryshme, si shkencat politike, ekonomia, mjekësia, e shumë të tjera.

Për të qenë pjesë e këtij forumi ju duhet një letër motivuese, duke përmbytur idetë dhe mendimin juaj mbi idenë e këtij forumi, një autobiografi, një transkript i notave, si dhe një dëshmi mbi njohjen e gjuhës angleze ose gjermane, shpjegoi z.Asllani.

"Për të gjithë studentet të cilët dëshirojnë të aplikojnë në IG Alpbach Kosova, ne japim 12 bursa, Në bashkëpunim me Rektorin Hajrizi, kemi vendosur të bëjmë një përjashtim - të gjithë studentët kanë të drejtën të aplikojnë në dy vende, edhe në Forum edhe në IG Alpbach Kosova. Kjo rrit shanset e juaja që të fitoni një bursë. Ne si organizatë kemi vendosur që për shkak të bashkëpunimit me UBT-në, t'i japim dy bursa te plota për studentët e UBT-së", tha z.Asllani

Aplikimi duhet të bëhet deri më 31 mars 2015. Adresa për aplikim edhe në Alpbach është [alpbach.kosovo@gmail.com](mailto:alpbach.kosovo@gmail.com). Më shumë informata për Forumin Evropian mund të gjeni në: <http://www.alpbach.org/en/unterveranstaltung/seminar-week/>

Forumit Evropian Alpbach është ngjarja më e madhe që do të organizohet në muajin gusht 2015, me pjesëmarrës të ndryshëm: studentë, shkencëtarë, juristë, ekonomistë, gazetarë si dhe politologë të rinj nga e gjithë Evropa. Forumi Evropian është një mundësi e mirë për studentët dhe të rinjtë të cilët dëshirojnë të krijojnë kontakte ndërkombëtare në fushën e shkencës, dijes dhe karrierës profesionale.

Forumit Evropian (EFA) është një platformë ndërdisciplinore për shkencë, politikë, biznes dhe kulturë, i themeluar në vitin 1945.

SESIONI INFORMATIV PËR PROCESIN DHE BENEFITET E CERTIFIKIMIT

## CERTIFIKIM NDËRKOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E PROJEKTEVE

Prishtinë, 25 mars. - Në kuadër të ligjëratave tematike dhe bashkëbisedimeve me qytetarë, që po mbahen në UBT, të martën u mbajt Sesioni Informativ për procesin dhe benefitet e certifikimit.

Qëllimi i takimit ishte njoftimi për certifikime ndërkombëtare për menaxhimin e projekteve sipas standardeve të organizatës ndërkombëtare me bazë në Zvicër IPMA (International Project Management Association).

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi e hapi këtë takim, duke i falënderuar të pranishmit, të cilët edhe kësaj radhe ishin të shumtë. Ai foli për rëndësinë që Kosova ka në menaxhimin e projektit si dhe mundësitë që të janë ofruar vendit për këtë fushë.

"Kosova ka të drejta të barabarta, njësoj sikur çdo vend tjetër në botë, edhe sikur Gjermania, Amerika, Anglia, Australia, Holanda dhe fati jonë i mirë është që të gjitha kriteret e njëjta, përmbajtje dhe informacione të njëjta janë edhe në gjuhën shqipe, pra nuk ka nevojë në gjuhë të tjera. Është një lehtësim më i madh", tha z. Hajrizi.

Ai shtoi se është i interesuar që bashkarisht shoqërinë ta ngrisin në nivelin më të lartë profesional të menaxhimit të projektit. Sipas tij njerëzit në përgjithësi nuk i njohin projektet, ose njohin disa segmente të projektit por jo edhe tërësinë dhe në këtë mënyrë kanë të bëjnë me sukses, me humbje dhe njëra nga efektet është që ta ngrisin vetëdijen dhe kompetencën në menaxhimin e projekteve. Janë dy fusha në të cilat ky program u ofron studentëve dhe të gjithë të interesuarve: Informimi, trajnimi & ngritja e kapacitetit; Certifikimi.

Rektori i UBT-së u shpreh se objektivi i UBT-së është që certifikimi të mos jetë i shtrenjtë. Kjo do të thotë të kenë mundësi sa më shumë kandidatë të certifikohen dhe që të gjithë të kenë sukses. "Ideja e kësaj është se ne duam që, me një çmim sa më të arsyeshëm, të arrijmë efektin e njëjtë sikur në vendet e tjera dhe e gjithë kjo bëhet për të arritur një vlerësim profesional dhe ju shërben si pjesë të karrierës", theksoi ndër të tjera rektori Hajrizi.

Certifikimet janë të dy niveleve:

Certifikimi në nivelin D – Personat që me sukses menaxhojnë dhe marrin pjesë në projekte. Niveli i parë i kompetencës, kjo bëhet me provim me gojë dhe me shkrim.

Certifikimi në nivelin C – Personat që, përveç provimit me shkrim dhe me gojë, u duhet edhe një prezantim i një dokumentimi të projektit që ai e ka punuar më herët dhe në fund merr një nivel më të lartë.

Ka edhe certifikim për nivelin më të lartë, për ata që punojnë në menaxhimin e projekteve komplekse. Projekt kompleks quhet ai projekt që ka mbi 5 milionë euro buxhet.



## EKSPERTI NGA FRANCA LUC ERARD FOLI PARA STUDENTËVE TË UBT-SË PËR FUSHËN E METROLOGJISË



Prishtinë, 25 mars. - Në kuadër të ligjëratave tematike të organizuara në UBT, para studentëve, mësimdhënësve dhe të interesuarve të tjerë foli eksperti nga Franca z.Luc Erard, nga Organizata Metrologjike dhe Njësia e Sistemit Ndërkombëtar. Në ligjëratë dhe në bashkëbisedim, z.Erard foli për terminologjinë dhe një varg çështjesh me interes rreth fushës së metrologjisë, si sistemi metrologjik, definicionet që shërbejnë si njësi matëse, siç janë temperatura, shkalla elektrike, masa e substancës, matja e njësive metrologjike e të tjera.



## REKTORI I UBT-SË PJESË E EKIPIT TË EKSPERTËVE PËR REFORMËN E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË, I ZGJEDHUR NGA KOMISIONI EVROPIAN

Prishtinë, 9 mars. - Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi është zgjedhur nga Komisioni Evropian të jetë pjesë e ekipit të Ekspertëve për Reformën e Arsimit të Lartë në Kosovë (ERAL). Përveç rektorit Hajrizi, pjesës e këtij ekipi janë edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe atyre të arsimit të lartë, ndërsa rektori Hajrizi është përfaqësuesi i vetëm në këtë ekip nga institucionet private të arsimit të lartë. Rektori Hajrizi në vazhdimësi është pjesë e ekipeve që merren me strategjitë dhe zhvillimin e arsimit të lartë në vend, ku ka dhënë një kontribut të çmueshëm. Përzgjedhja e rektorit të UBT-së në këtë ekip dëshmon edhe një herë se institucionet respektive ndërkombëtare dhe ato vendore çmojnë ekspertizën dhe kualitetin e punës në UBT dhe se puna që bëhet në këtë institucion të arsimit të lartë është konform standardeve ndërkombëtare.



## EDHE NJË PUBLIKIM I RI NË UBT

# U PROMOVUA LIBRI "MARKETINGU", I AUTORIT DR.NEHAT RAMADANI

"Ky libër vjen në vazhdim të botimeve që do t'i ndihmojë studentët për studime akademike. Po ashtu ky libër u përgjigjet sfidave të mungesës së literaturës. Është ndryshe nga gjithë librat e tjerë. Është një përmbajtje e re. Është një qasje e re", tha rektori Hajrizi

Prishtinë, 18 mars. - Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) u promovua sot libri "Marketingu", i autorit Dr.Nehat Ramadani, i cili është profesor në UBT.

Libri, që vjen në vazhdim të librave të profesorëve të botuar nga UBT, është vlerësuar lart nga rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi, i cili tha se ai paraqet një përgjigje sfidave që paraqet mungesa e librave profesionalë në gjuhën shqipe.

"Ky libër vjen në vazhdim të botimeve që do t'i ndihmojë studentët për studime akademike. Po ashtu ky libër u përgjigjet sfidave të mungesës së literaturës. Është ndryshe nga gjithë librat e tjerë. Është një përmbajtje e re. Është një qasje e re", tha rektori Hajrizi.

Rektori Hajrizi theksoi se me botimin e këtij libri dhe librave të tjerë, që janë në plan, po zgjerohet edhe më tej veprimtaria e shtëpisë botuese të UBT-së, në kuadër të së cilës do të publikohen edhe libra të tjerë me rëndësi.

Autori i librit, dr. Nehat Ramadani, fillimisht falënderoi UBT-në për mbështetjen e dhënë. Ai tha



se ky libër i dedikohet kryesisht studentëve të biznesit, ekonomisë, po edhe drejtimve të tjera, sikurse edhe përfaqësuesve të biznesit, të cilët duhet të ndryshojnë qasjen ndaj marketingut.

"Ky libër paraqet përparësi për studentët dhe sigurisht edhe për bizneset, sepse në të përfshihen përvojat e më shumë se 100 kompanive botërore, rajonale e vendore", u shpreh dr.Ramadani.

Duke folur për temën që shtjellon libri, ai theksoi se zhvillimi i teknologjisë e ka ndryshuar në masë të madhe edhe marketingun, një fushë në të cilën kompanitë duhet t'i kuptojnë sfidat globale

Ndërsa dekani i Fakultetit të Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT, Ylber Limani, tha se bashkëpunimi i UBT-së me

profesorët është i nevojshëm, në mënyrë që të kemi libra të cilësisë së lartë. Ai e vlerësoi shumë pozitivisht punën e profesor Ramadani, duke theksuar se libri i tij është një ndihmesë e madhe për studentët dhe një kontribut shumë i madh për literaturën në përgjithësi në fushën e marketingut.

Të pranishëm në promovimin e këtij libri ishin edhe studentët të UBT-së. Në debatin me autorin, ata thanë se një libër i kësaj natyre ka qenë i nevojshëm për faktin se është në gjuhën shqipe dhe ofron shumë të dhëna për studentët, sidomos shembujt e kompanive të mëdha, që janë me shumë interes.

Libri "Marketingu", i autorit Dr.Nehat Ramadani, ka gjithsej 335 faqe dhe është i organizuar në 11 kapituj. Ai është botuar nga UBT.

## STUDENTËT E UBT-SË ME NUMËR REKORD NË DHURIMIN VULLNETAR TË GJAKUT

Studentët dhe stafi i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), janë solidarizuar duke dhuruar gjak, gjatë aksionit që ka zgjatur dy ditë me moton "Dhuro gjak, shpëto jetë", në ambientet e UBT-së në Prishtinë.

Menaxherja e Marketingut dhe Informimit në Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, Albana Gashi falënderoi udhëheqjen, profesorët dhe studentët e UBT-së për gatishmërinë e tyre për t'iu përgjigjur pozitivisht aksionit për dhurimin vullnetar të gjakut.

"Falënderojmë UBT-në që ka bërë këtë aksion për të dhuruar gjak. Si hera e parë, kemi një numër që ka thyer rekordet nga të gjitha universitetet private në vend, po ashtu edhe shtetërore. Është një numër shumë i madh i dhuruesve vullnetar të gjakut. Duke u nisur nga interesimi i studentëve ne kemi vazhduar edhe ditën e dytë të dhurimit të gjakut", tha Gashi.

"Të dhurosh gjak është një gjest më human, ndërsa për një pacient është jetë. Dhurimi i gjakut për dhuruesin është një gjest shumë i thjeshtë, është vetëm një freskim i

rruazave të gjakut, mirëpo për pacientin është jetë. Ky gjak shkon për të gjithë ata pacientë të cilët janë në rrezik për jetë dhe që kanë nevojë për gjak, është një gjest dhe një vepër shumë e madhe për secilin që dhuron gjak. Moshë e cila mund të dhurojë gjak është nga 17-18 vjet deri në moshën 65 vjeç. Ne kemi nevojë për të gjitha grupet e gjakut, sepse pacientët tanë janë me këto gjithë grupet e gjakut, mirëpo për grupin "A Negativ" ka nevojë më shumë", tha Albana Gashi.

Besart Troshupa

## ALBANIAN ICT AWARDS PREZANTOI PARA STUDENTËVE TË UBT-SË

Prishtinë, 17 mars. - Përfaqësues nga Albanian ICT Awards, në UBT mbajtën sesion Informues, me qëllim të identifikimit dhe shpërblimit të profesionistëve të shquar, udhëheqësve të suksesshëm, inovatorëve dhe profesionistëve në ngritje, të cilët me kontributin e tyre kanë lënë gjurmë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Hapjen e bëri Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, dr.Muzafer Shala, i cili i inkurajoi studentët e këtij drejtimi që të aplikojnë dhe premtori mbështetjen e stafit dhe infrastrukturës laboratorike të UBT-së. Më pas u bë demonstrimi i robotëve NAO, si dhe u prezantua puna e studentëve sa i përket programimit të këtyre robotëve humanoidë

## PESË STUDENTË TË UBT-SË FITUAN BURSA NGA IPKO FOUNDATION

17 qershor. - Rinor Maloku, Ylli Salihu, Edison Rama, Era Kuraja dhe Erin Godanci janë pesë studentët e UBT-së që kanë fituar bursa nga IPKO Foundation, në edicionin e shtatë të dhënies së bursave në kuadër të "Next Generation Scholarship Program" për vitin akademik 2015/2016.

Pas një procesi të kujdesshëm dhe dinamik të shqyrtimit të aplikacioneve, janë përzgjedhur studentet kosovarë, më të mirët prej më të mirëve dhe janë bërë pjesë e familjes së 138 bursistëve të Ipko Foundation.

Nga gjithsej 14 bursa të dhëna nga ky fondacion, pesë prej tyre i kanë fituar studentët e UBT-së.

Studentët e UBT-së kanë fituar edhe viteve të tjera bursa nga Ipko Foundation. Sipas viteve, studentët fitues janë: Gjenerata 2010/2011: Anesa Ramxiku e Valbona Fejzullahu; Gjenerata 2011/2012: Besfort Ajeti, Kreshnik Ismaili e Arian Agani; Gjenerata 2012/2013: Fatos Sylaj, Trim Kadriu dhe Besfort Ajeti, Gjenerata 2013/2014: Endrit Kadriu, Afrim Bajraktari, Vesarta Haxhaj dhe Muhamed Retkoceri, Gjenerata 2014/2015: Partin Imeri, Arlind Luma, Atdhe Mahmuti, Blerina Berisha dhe Vlonjat Gashi.

Më shumë informata në: <http://ipkofoundation.org/activities/the-winners-of-the-seventh-round-of-if-next-generation-scholarships-announc>

<http://ipkofoundation.org/programs/next/winners-2015-2016>



TË PRIRË NGA PROFESORSHA DR.CAROLINEJAEGER-KLEIN

një diskutim për planifikimin

## STUDENTËT E UBT-SË DHE TË UNIVERSITETIT PËR TEKNOLOGJI TË VJENËS ZHVILLUAN PUNËTORINË DISA DITORE "TRASHËGIMIA ARKITEKTONIKE E KOSOVËS"

Punëtorja, qëllimi i së cilës ishte studimi i objekteve me rëndësi në trashëgiminë arkitektonike, u organizua në kuadër programit Master Arkitekturë dhe mbledhi 12 studentë nga Vjena dhe 8 nga UBT

19 maj. - Studentë të Universitetit për Biznes dhe Teknologji dhe të Universitetit për Teknologji të Vjenës kanë zhvilluar një punëtorë disaditore të titulluar "Trashëgimia arkitektonike e Kosovës" në rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës, të prirë nga profesoresha Dr Caroline Jaeger-Klein.

Punëtorja, qëllimi i së cilës ishte studimi i objekteve me rëndësi në trashëgiminë arkitektonike, u organizua në kuadër programit Master Arkitekturë dhe mbledhi 12 studentë nga Vjena dhe 8 nga UBT.

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Harjizi, gjatë një takimi me Dr. Caroline Jaeger-Klein dhe me studentët i ka njoftuar për procesin akademik dhe punën hulumtuuese e shkencore që bëhet në UBT. Ai theksoi gjithashtu bashkëpunimin shumë të mirë që ka UBT me Universitetin për Teknologji të Vjenës dhe me shumë universitete të rëndësishme botërore, të cilat u krijojnë mundësi studimi dhe përparimi profesorëve dhe sidomos studentëve të UBT-së.

Studentët kanë vizituar një varg objektiv me interes, duke përfshirë qendrën e qytetit të Prishtinës, zyra të profesionistëve të arkitekturës, si dhe objekte të ndërtuara me material ripërtëritës.

Gjithashtu, studentët dhe profesoresha Dr Caroline Jaeger-Klein, të shoqëruara edhe nga



Arnisa Kryeziu, koordinatore e Programit Master - Departamenti i Arkitekturës në UBT, vizituan disa pjesë të asaj që ka mbetur nga qyteti i vjetër i Prishtinës.

Pastaj, ata vizituan Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, si dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve në Kosovë.

Gjatë qëndrimit në Prizren, studentët vizituan qytetin e vjetër, kështjellën, hamamin, xhamitë dhe monumente të tjera të shumta në këtë qytet, përfshirë edhe disa ura në rrugën për në Gjakovë.

Në Gjakovë ata vizituan Çarshinë e vjetër dhe objekte të tjera me interes.

Kullat ishin në fokusin e vizitave të studentëve gjatë qëndrimit në Dranoc, Junik, Isniq e Deçan, përpara se të shkojnë në Pejë, për të vizituar pjesët e vjetra të qytetit dhe manastirin ortodoks e muzeun etnografik.

Studentët vizituan manastirin e Graçanicës dhe zhvilluan

hapësina në këtë komunë.

Ndërsa tjetër ishte Novobërda, ku ata vizituan kalanë, xhaminë tradicionale, tyrben dhe objekte të tjera.

Ndërsa, në vizitën e fundit të këtij rrugëtimi ata ishin në Vushtrri, ku vizituan urën e kohës a romake, hamanin dhe objekte të tjera me interes.

## UBT ORGANIZOI PUNËTORI ME EKSPERTË NDËRKOMBËTARË ME PJESËMARRËSIT E INKUBATORIT TË BIZNESIT

22 qershor. - Në kuadër të projektit për Inkubatorin Virtual të Kosovës dhe Qendrën për fillimin e bizneseve të reja, UBT ka organizuar një varg punëtorësh me ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë të kësaj fushe. George Lantzas ishte eksperti i radhës i cili mori pjesë në punëtorë, ku shpalosi praktikën dhe metodat më të mira të zhvillimit të inkubatorit.

Pjesë e veçantë e punëtorisë ishte takimi i z. George Lantzas me pjesëmarrësit e inkubatorit, ku u diskutua për fazat e zhvillimit të ideve, barrierat më të cilat janë duke u përballur pjesëmarrësit e inkubatorit, targetimi i klientëve, mënyrat e gjetjes së fondeve, jetësimi i ideve dhe përshtatja sa më e mirë në treg.

Hapja e Inkubatorit Virtual të Kosovës dhe Qendrës për fillimin e bizneseve të reja është bërë më 3 qershor 2015. Pjesëmarrëseve të inkubatorit do t'ju ofrohen shërbime nga fusha të ndryshme në bazë të nevojave të tyre.

Si pjesë e inkubatorit është vendosur këndi i ndërmarrësisë, libreria me titujt më të fundit nga fusha e ndërmarrësisë, publikimi i revistës "EntrepreneurshipJournal", platforma online, etj.



## AKTIVITETE TË SHUMTA TË STUDENTËVE TË SHKENCAVE POLITIKE NË UBT



18 qershor. - Studentët e Departamentit të Shkencave Politike në UBT në UBT kanë zhvilluar një varg aktivitete javëve të fundit.

Fillimisht, studentët e vitit të parë, grupi në Prishtinë dhe grupi në Ferizaj, bënë simulimin e një seance plenare të Kuvendit të Kosovës.

Më pas ata vizituan Kuvendin, ku u takuan edhe me kryetarin Kadri Veseli. Gjithashtu, përgjegjësi për marrëdhëniet me publikun në Kuvend, Musli Krasniqi, i shoqëroi në një vizitë ndërtesës dhe u shpjegoi rreth procedurës legislative dhe punës së administratës së Kuvendit. Më vonë, të dy grupet e studentëve zhvilluan simulimin e seancës plenare. Si fillim studentët krijuan partitë, grupet parlamentare dhe zgjodhën kryetarët e secilit grup dhe Kryetaren e Kuvendit. Kryetaret dhe Kryetarja e Kuvendit krijuan edhe Komisionin Buxhetor. Më pas, secili student, në funksionin e një deputeti, shqyrtoi projektligjin mbi Tatimin mbi të Ardhurat Personale dhe morën pjesë në seancën plenare. Pas debatit, projektligji kaloi me gjashtë amendime shtesë, me shumicë votash.

# UBT KA SIGURUAR ABONIMIN PREMIUM NGA PROGRAMI DREAMSPARK I MICROSOFT-IT PËR STUDENTËT DHE STAFIN AKADEMIK



Ashtu siç ju kemi njoftuar më herët, UBT ka siguruar abonimin Premium që mundësohet për Institucione Akademike nga programi

DreamSpark i Microsoft-it për të gjithë studentët dhe stafin akademik.

DreamSpark është një Program anëtarësimi i

Microsoft-it, që mbështet arsimin teknik, duke siguruar qasje në softuerë që i përkasin kompanisë Microsoft, për mësim, mësimdhënie, zhvillim dhe qëllime kërkimore.

Pas një periudhe teste, ju rikujtojmë se tani të gjithë studentët dhe stafi akademik i institucionit më të madh të arsimit të lartë do të mund t'i shfrytëzojnë licencat e këtij programi pa pagesë, duke

ju mundësuar që të keni qasje në softuerë të të gjitha kategorive, duke përfshirë këtu Sistemet Operative, veglat për zhvillim, serverët dhe programet e ndryshme aplikative, që në tërësi janë mbi 200 licenca në shërbimin tuaj.

Qasja juaj në këtë platformë ju mundësohet përmes SMISI-t, pastaj duke klikuar nëmenunë-DreamSpark, ku, për më shumë, detaje e keni të bashkangjitur manualin për përdorim në këtë e-mail.

UBT tanimë në fushën e Edukimit është sinonim i Cilësisë dhe Inovacionit.

Vërejtje: Të gjitha licencat e ofruara nga DreamSpark janë për përdorim personal më së shumti në 2 pajisje, si

student, mësimdhënës ose institucion edukativ dhe jo për qëllime të tjera të caktuara, si biznes apo diçka tjetër dhe nëse këto rregulla nuk përfillen do të ndalen licencat e juaja dhe shfrytëzimi i tyre dhe i shërbimeve të lartcekura.

Rregullat për përdorim i gjeni edhe në:

<https://www.dreamspark.com/Student/Direct-EULA.aspx>

Për çdo paqartësi ose informatë shtesë, ju lutemi kontaktoni në:

University Education for Business and Technology  
Lagja Kalabria p.n  
+381 38 541 400  
support@ubt-uni.net  
Prishtine, 10000  
Kosovo

## MANUAL PËRDORIMI PËR QASJE NË MICROSOFT DREAMSPARK

Pasi të jeni qasur në SMIS, në anën e majtë të menu klikoni në pjesën DreamSpark

Kur të keni klikuar, do t'ju ridrejtojë tek faqja e UBT-së në



DreamSpark


Në pjesën e majtë të menu mund të zgjedhni kategorinë e softuerëve,



p.sh të serverëve të ndryshëm, sistemeve operative, aplikacioneve etj.

Pasi të keni zgjedhur kategorinë e caktuar, klikoni mbi softuerin që dëshironi ta shkarkoni, p.sh Microsoft Windows 8.1

Kur klikoni softuerin Microsoft Windows 8.1, shfaqen versionet e



ndryshme të atij softueri, që mund të jenë: Professional, Enterprise Edition, si në figurën e mëposhtme etj.

Duke klikuar te Add To Cart,



hapet dritarja tjetër ku shfaqet pjesa për CheckOut.



Kur klikoni CheckOut, lexoni rregullat dhe marrëveshjen midis Microsoft dhe neve si përdorues dhe pajtohuni me kushtet dhe rregullat, duke shtypur në I Accept.




Hapi tjetër pas klikimit në I accept. Duhet të klikojmë në ProceedwithOrder, ku kjo licencë merret me të dhënat tona të studentit, duke përfshirë emrin, mbiemrin dhe email-in.



Kur të bëni Proceedwithorder, do t'ju shfaqet licenca te ProductKey dhe softueri për download te butoni Start Download.

Pasi të keni klikuar në Start Download, hapet tab-i i ri ku në Step 1 duhet të instaloni Secure DownloadManager dhe në Step 2 lëshohet download-imi i softuerit të caktuar, në këtë rast i sistemit operativ Windows 8.1 në format .ISO file



Kur e kaloni hapin 1 dhe klikoni te hapi 2, ju shfaqet dritarja e re si në fotografinë më poshtë, ku zgjedhni në raste të caktuara llojin e arkitekturës së softuerit për 32-bit shkarkim ose 64-bit dhe prisni derisa të shkarkohet 100% në kompjuterin e përdoruesit.



## STUDENTJA E ARKITEKTURËS NË UBT MORI PJESË NË EKSPOZITËN NË TIRANË E NË PRISHTINË

Hatixhe Hoxha, studente në vitin e dytë në Fakultetin e Arkitekturës të UBT-së, dega në Ferizaj, mori pjesë në ekspozitën EkspoStilArkiASA4, e cila u organizua nga Qendra ASA, nga 1 deri më 3 maj 2015 në Tiranë. Ajo gjithashtu ka marrë pjesë edhe në ekspozitën e hapur në Institutin Albanologjik në Prishtinë, më 25 maj 2015.

Në ekspozitën në Tiranë, ku ishte i pranishëm edhe Presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani, ajo u prezantua me projektin Bunkerët, me konceptin Degradimi i natyrës dhe Integrohu me natyrën. Tema e ekspozitës ka të bëjë me lirinë e zgjedhjes së krijimit të veprës mes teknikës, materialeve, formatit, dimensioneve si dhe ngjyrave, që ndikoi që artistët, stilistët dhe arkitektët të jenë më të lirë në krijimtarinë e tyre, si një mundësi e mirë për të promovuar talentet e pjesëmarrësve.

Duke folur për paraqitjen e saj, znj.Hoxha thotë se koncepti i kësaj veprë bazohet në zbutjen e vrazhdësisë së bunkerëve (në Shqipëri numri i tyre është shumë i madh). Ideja është që këta bunkerë, përveç që të shfrytëzohen funksionalisht, gjithashtu të mund të kamuflohen dhe të integrohen në natyrë.





STUDENTËT PËRFITOJNË NGA VIZITAT STUDIMORE JASHTË VENDIT

# STUDENTËT E ARKITEKTURËS DHE TË NDËRTIMTARISË PËRFITUAN PËRVOJA TË REJA NË STAMBOLL

Profesori i UBT-së, Ajhan Bajmak në një intervistë për "UBT News" ka treguar për vizitën e tij me studentët e arkitekturës dhe ndërtimtarisë në Stamboll të Turqisë.



**UBT News:** Profesor Bajmak. Studentët e departamentit të Arkitekturës në UBT kanë realizuar një udhëtim studimor në Stamboll, të shoqëruar edhe ju dhe profesori Muhamet Ahmeti. Cili ishte qëllimi i kësaj vizite?

**Bajmak:** Qëllimi i vizitës së Stambollit është kryesisht Panairi Ndërkombëtar i materialeve ndërtimore që zhvillohet në muajin maj në Stamboll. Ky panair ka një rëndësi të veçantë për studentët e arkitekturës dhe po ashtu atyre të ndërtimtarisë, sepse mundëson që studentët të njohohen me këto materiale, të cilat, pse i mësojnë në lëndën e materialeve në fakultetet, po në këtë rast ata kanë rast që këto materiale për së afërmi t'i prekin, të kenë njohuri për ta, të shohin se si nëpërmjet këtyre materialeve në panair janë ndërtuar edhe shumica e shtandëve. Dhe në këtë rast studentët edhe pasurohen me katalogje, cd dhe mostra nga këto materiale. Sepse, çdo vijë që tërhiqet apo vizatohet në projekte të studentëve është material. Ajo që është edhe më interesant është se studentët këtu njohohen edhe me materiale më inovative që ndoshta në tregje tona ende s'kanë arritur, ndërsa studentët veç i pasurojnë projektet e tyre me informata nga ky panair.

**UBT News:** Sa të shpeshta janë vizitat studimore në fakultetin tuaj dhe ku organizohen ato?

**Bajmak:** Vizitat studentore në UBT organizohen dy herë në vit. Mirëpo, këto vizita tani do të bëhen tre herë në vit, ku do të shtohet edhe një ekstra vizitë për studentët e Masterit. Pra, ne organizojmë një vizitë në fund të muajit dhjetor dhe fillim të muajit nëntor vizitë kjo që përfshin Evropën, ajo e muajit maj për Stamboll dhe tani për Kërshëndella që do të zhvil-

lohet për master ose në plan për master është vizita në Dubai.

Vizita në Evropë zhvillohet kryesisht me studentët e vitit të dytë dhe të tretë. Në Evropë kryesisht bëhet vizita në Itali, ku studentët kanë rastin të njohohen me Bienalen e Arkitekturës, pastaj me qytet e renesancës, vizitohen Firenca, Roma, Venediku, dhe pastaj shkohen në Pragë ose edhe në ndonjërin prej qyteteve sikur sivjet që planifikohet Parisi, Amsterdami dhe Berlini. Pra, çdo vit bëjmë ndërrim të destinacioneve, që të kemi përvoja të ndryshme nga këto qytete. Ajo që është interesant në Evropë studentët përpos qytetit, arkitekturës, hapësirave publike, ata vizitojnë shumë muzeume moderne dhe kontemporane, ku edhe përcjellin artin konceptual se në çfarë përmasash ka arritur.

Ajo që do jetë interesant është vizita e tretë në agjendë që do zhvillohet për master. Kjo vizitë do bëhet për studentët të masterit në Dubai. Nëse kjo vizitë realizohet unë besoj që kjo do jetë një ndihmë e madhe që studentët të njohohen me qendrën e botës në ndërtim inovative. Sepse momentalisht arkitektët më të njohur në botë janë duke krijuar nëpër këto qytete dhe është një ndjenjë e veçantë për arkitektët të përjetojnë hapësirën dhe arkitekturën me të gjitha shqisat e tyre.

**UBT News:** Fillimisht ju vizituat universitetin më prestigjioz të Arkitekturës dhe Dizajnit "Kadir Has Universiteti" në Stamboll. Cilat janë përshtypjet nga kjo vizitë?

**Bajmak:** Kjo është vizita e dytë që ndodh në Kadir Has. Ky universitet është një prej universiteteve më të njohura private në Turqi. Dhe për një kohë të shkurtër ka zënë vend shumë me rëndësi në Azi si për kualitet të ligjëruesve

dhe stafit akademik po ashtu edhe prej studentëve, plan-programeve që posedojnë, universitetit, bibliotekës që posedon. Po ashtu është një prej universiteteve që posedon laboratorë dhe klasa inteligjente që bën edhe më emotive kur vizitohen kësi lloj hapësirash.

Vitin e kaluar kemi pasur edhe një konferencë në këtë shkollë dhe kemi nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërmjet dy universiteteve për shkëmbim të studentëve dhe bashkëpunim në uorkshope.

**UBT News:** Studentët po kështu vizituan galerinë kontemporane Salt-Taksim, dhe muzeun dhe institutin më të njohur për hulumtim në artin kontemporan Galata Salt", që ka bibliotekën më të pasur në Evropë, e udhëhequr Vasif Kortun. Na flisni më shumë rreth vizitës në këto institucione?

**Bajmak:** Sa i përket vizitës së këtyre dy institucioneve Gallata Salt dhe Taksim Salt kjo ishte një vizitë shumë e frytshme, sepse janë dy institucione më të mëdha në Turqi sa i përket artit kontemporan.

E para ky institucion dikur ishte banka qendrore në periudhën otomane dhe tani kjo bankë është transformuar në muze dhe galeri. Ajo që e bën më interesante këtë vizitë për studentët është që studentët këtu mund të shohin intervenimet arkitektonike si bëhen në objekte të vjetra duke ruajtur objektin në tërësi dhe se si shkrihen materialet e reja në këto objekte me intervenime të reja.

Pos asaj në këtë muze ekspozohen ekspozita ndërkombëtare në fotografi, pikturë dhe ky muzeum posedon në bibliotekë shumë të madhe që shfrytëzohet nga studentët e mbarë botës në sferën e arkitekturës dhe artit.

Ndërsa muzeu i dytë, Salt Taksim gjendet në Taksim. Edhe kjo

galeri ka përjetuar një transformim si objekti i vjetër neoklasik nga arkitekti shumë i njohur Han Turmertekin. Ka katër kate dhe në katin më të lartë ka një bibliotekë më të pasur me libra të artit dhe të arkitekturës dhe po ashtu një kinema ku bëhen prezantime të filmave, konferencave etj.

**UBT News:** Ju pastaj vizituat muzeun modern të Stambollit, na tregoni më shumë?

**Bajmak:** Sa i përket muzeumit modern, në çdo vizitë në Stamboll të enjteve muzeumi është falas për studentët dhe ne e shfrytëzojmë këtë ditë të shëtisim komplet të gjitha departamentet e muzeumit.

Muzeumi modern i Stambollit përmban një koleksion shumë të pasur të punimeve në pikturë, skulpturë, grafikë, video instalacione, koleksion ky që i takon muzeumit dhe po ashtu në katin e parë të muzeumit çdo tre muaj organizohet ekspozita të artistëve të rinj kontemporanë. Përpos kësaj, ky muzeum përmban edhe bibliotekën dhe kinotekën për studentët, që mund të shohin filma të ndryshëm në botën e artit.

**UBT News:** Ju takuat edhe kuratorin, kritikun dhe filozofin më të madh të Turqisë, drejtorin e Departamentit të Sociologjisë në Universitetin "Mimar Sinan", prof. dr. Ali Akay. Na jepni përshtypje nga biseda me të?

**Bajmak:** Në këtë vizitë ne takuam edhe filozofin më të njohur të Turqisë, profesor doktor Ali Akay, që është edhe drejtor i Departamentit të Sociologjisë në Universitetin Mimar Sinan. Ali Akay është kritiku më i madh i artit si në Turqi, po ashtu edhe në Francë, sepse karriera e tij filon në Paris ku filloi studimet dhe mbaroi edhe doktoratën e tij.

Profesori po ashtu ka botuar shumë libra në sferën e sociologjisë dhe të artit. Kam pasur fat që edhe unë ta kem profesor Ali Akyin gjatë studimeve në Stamboll. Lënda e tij ka qenë mjaft atraktive, filozofia e artit. Aty jemi njoftuar së bashku dhe tani jam asistenti i tij dhe bashkëpunëtori kryesor në organizimin e ekspozitave ndërkombëtare që zhvillohen në Stamboll dhe në Evropë. Pra, vitin tjetër, së bashku me profesorin Ali organizojmë ekspozitën më të madhe të Ballkanit në Stamboll. Unë jam koordinatori dhe moderatori i kësaj ekspozite. Kjo është një përvojë shumë e madhe për faktin se jam pjesë e një ekspozite të tillë me artistët më të njohur në Ballkan dhe Evropë, si Marina Abramovich, Ulay, Irvin e shumë të tjerë.

**UBT News:** Çfarë biseduat në takim me prorektorin e Universi-

tetit "Mimar Sinan", prof. Dr. Deniz Incedayi?

**Bajmak:** Takimi me prorektorin e universitetit Deniz Incedayi ishte mjaft i frytshëm, sepse profesoresha Deniz Incedayi po ashtu është edhe drejtoreshë e Asociacionit Ndërkombëtar të Arkitektëve Botërorë, që mbledhet një herë në tre vjet. Në këtë kongres marrin pjesë arkitektët më të njohur botërorë. Ajo që është me rëndësi është se profesoresha Deniz Incedayi po ashtu ka pasur ndikim shumë të madh që edhe Kosova të jetë pjesë e këtij asociacioni ndërkombëtar. Ajo që është në të mirën e UBT-së është se Mimar Sinani është i hapur për çdo bashkëpunim me UBT-në, po ashtu edhe vjet kemi pasur një uorkshop me studentët e arkitekturës nga UBT dhe Mimar Sinan dhe kemi të nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi. Ata janë të gatshëm që ne ta vazhdojmë edhe në shkallë më të lartë këtë bashkëpunim.

Universiteti "Mimar Sinan" është një prej universiteteve me prestigjioze në Turqi. Arkitektët më të mëdhenj dhe artistët kanë diplomuar në këtë universitet. Unë kam mbaruar studimet në këtë universitet, po ashtu edhe doktoratën dhe gjithë këtë përvojë që kam marrë këtu sot e ndaj me studentët e mi të dashur.

**UBT News:** Sa përfitojnë studentët nga vizitat studimore?

**Bajmak:** Jam shumë i sigurt që studentët më së shumti përfitojnë nga këto vizita që zhvillohen ose bëhen jashtë vendit. Posaçërisht për një drejtim sikur arkitektura nuk mund të paramendohet që një student të studiojë apo edhe të diplomojë në arkitekturë nëse nuk ka qenë pjesë e hapësirës së ndonjë muzeumi, xhamie, kishe apo ndonjë objekti kulturor punuar nga arkitektët të njohur. Pra, një arkitekt duhet ta përjetojë hapësirën, duhet ta prekë materialin, arkitektura nuk është 2D, ajo duhet të përjetojë me të gjitha shqisat që kemi.

Një student, gjatë vizitës në Evropë apo edhe në vende të tjera e përjeton shpirtin e qytetit, njohet me erën e qytetit, është një emocion që nuk përshkruhet, sheh objekte të reja, muzeume, atë që ka mësuar në teori apo në histori të arkitekturës tani e përjeton së prekuri dhe së shikuarit, tani ka rastin të flasë me objektin, të komunikojë trupi dhe hapësira, dimensionin spiritual i hapësirës... dhe kjo bën që studentët të motivohen edhe më shumë nga përvoja e tyre. Kjo edhe bën që UBT të veçohet nga universitetet e tjera me këto programe që posedon në agjendën e tij si Departament i Arkitekturës.

Sherife Sokoli



ROBOTI NAO, I PROGRAMUAR NGA STUDENTËT E UBT-SË, ATRAKSION I VËRTETË NË PANAIRIN EDUKIMIT

# MINISTRI I ARSIMIT VIZITOI STANDIN E UBT-SË NË PANAIRIN E EDUKIMIT DHE U PËRSHËNDET NGA ROBOTI NAO



Roboti NAO, i programuar nga studentët e UBT-së, ka qenë një atraksion i vërtetë në Panairin Edukimit të organizuar në Tiranë më 4 dhe 5 maj, dhe sidomos në Panairin e Edukimit në Prishtinë, më 6 e 7 maj.

Ky robot e ka përshëndetur ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z.Arsim Bajrami, i cili vizitoi standin e UBT-së në Panairin e Edukimit në Prishtinë.

Gjatë vizitës, ministri Bajrami theksoi se Panairi i edukimit mundësi e mirë për studentët. “Është një mundësi e mirë për të rinjtë tanë që sot të shohin shumë universitete ndërkombëtare, shumë universitete publike vendore dhe shkolla për të gjetur rrugën drejt cilësisë. Ministria e Arsimit është duke zhvilluar projektin e ndërtimit të cilësisë në sferën e arsimit dhe në këtë vit do të japim një numër të konsiderueshëm të bursave për studime jashtë vendit. Dëshirojmë që këto bursa të shkojnë tek talentet e rinj dhe tek universitetet cilësore evropiane”, theksoi ai.

Ndryshe, roboti NAO dhe përgjithësisht oferta e UBT-së kanë zgjuar interesim shumë të madh të të rinjve gjatë Panairit të Edukimit në Tiranë.

Qindra të rinj, gjatë njohjes me ofertat e UBT-së janë shprehur shumë të kënaqur me mundësitë që ofron UBT dhe kanë shprehur interesim që të bëhen pjesë e këtij institucioni.

Roboti NAO, si gjithnjë, ka zgjuar kërkshërinë e tyre të madhe. Të rinjtë janë njoftuar me të, si dhe janë njohur me historinë e zhvillimit të robotëve në UBT, që është qendra më e njohur jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë në fushën e robotikës, duke marrë pjesë për disa vite me radhë në kampionatet ndërkombëtare të garave të futbollit me robotë. Madje, duke e fituar titullin e kampionit evropian në këtë garë në vitin 2011 dhe duke qenë organizator i këtij kampionati dy herë, më 2009 dhe më 2011.

Të rinjtë nga Tirana gjithashtu kanë shprehur interes të madh për ofertën akademike të UBT-së, e cila paraqet in-

teres për programet e veçanta, mësimdhënësit e përzgjedhur dhe mundësitë e mëdha për mobilitet, që krijohen në bazë të marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit që UBT ka me institucione prestigjioze akademike në Evropë dhe më gjerë.

Në Prishtinë, ku tashtë oferta dhe programet e UBT-së janë të njohura, të rinjtë dhe vizitorët e tjerë në standin e UBT-së janë njoftuar me programet e reja e sidomos me mundësitë e shumta që ofron UBT për studime, ngritje në karrierë brenda institucionit dhe vazhdim të studimeve në universitetet prestigjioze me të cilat UBT ka marrëveshje bashkëpunimi.

“UBT në këto panaire ka prezantuar ofertën akademike para një numri të madh të pjesëmarrësve si në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë. UBT ka treguar avantazhin teknologjik duke prezantuar programet, stafin dhe infrastrukturën shkollore, theksoi HalilBashota, udhëheqës i Qendrës së Karrierës në UBT.

## SYRI



**Roboti NAO prezantohet para nxënësve në shkollat anembanë Kosovës**

## INTERESIM I MADH I MATURANTËVE PËR PROGRAMET E STUDIMEVE NË UBT

Qendra e Karrierës në UBT po vazhdon me Programin Përgatitor të Maturantëve në Prishtinë, ku po marrin pjesë rreth 700 maturantë të pothuajse të gjitha shkollave të mesme në kryeqytet, duke filluar nga Gjimnazi “Sami Frashëri”, ai “XhevdetDoda”, SHMT “28 Nëntori”, “Gjin Gazulli”, “Eqrem Çabej”, pothuajse të gjithë maturantët nga “MehmetAkif”, “DonBosko”, si dhe për herë të parë edhe Shkolla e Mjekësisë “Dr. Ali Sokoli”.

Programetëngjashme me maturantëpovazhdojnë-tërealizohenedhenëqendrat e tjera, sinëFerizaj, Gjilan, Prizren...





VITI I TRETË I PROGRAMIT PËRGATITOR TË MATURANTËVE

# MATURANTËT MARRIN DIJE TË REJA DHE NJIHEN ME PROGRAMET E UBT-SË

Edhe sivjet, UBT ka organizuar kurse përgatitore për studentët e ardhshëm. Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Gjuhë Angleze janë disa prej lëndëve që ligjërohen nga mësuesit profesionistë. Halil Bashota, që udhëheq Qendrën e Karrierës në UBT flet për gazetën lidhur me këto ligjërata që janë mirëpritur nga nxënësit që sapo kanë mbaruar shkollën e mesme dhe mësimet e marra u janë të nevojshme për provimin final të maturës, por edhe për të kuptuar mundësitë që përparësitë që ua ofron UBT.

“Programi Përgatitor i Maturantëve ka ardhur si ide nga Qendra e Karrierës në UBT, me qëllim që të përmbushet vet misioni ynë interkomunitar për të qenë sa më afër me shërbimet tona tek të gjithë ata që kanë nevojë, në këtë rast tek maturantët, pasi që aktualisht shkollat nuk kanë mundësi të organizimit të një programi të tillë”, thotë Bashota.

“Orientimi dhe trajnimi profesional mungon në shkollat e mesme në Kosovë, dhe maturantët jo gjithëherë arrijnë të marrin shërbime profesionale mbi orientimin e tyre. Kështuqë, nga përvoja e deritanishme kemi parë të nevojshme që ne si institucion i arsimit të lartë, t’u ndihmojmë këtyre të rinjve në perceptimin e



tyre për karrierën dhe profesionin që do të marrin”, shton Bashota, për të shtuar se, me qëllim që programi përgatitor të jetë sa më i dobishëm, ne kemi përzgjedhur profesorët më të mirë të shkollave të mesme në Kosovë, të cilët punojnë me maturantët për disa ditë deri në testim.

Bashota shton më tej se duke qenë se testi i maturës është i ndarë në dy pjesë, ne gjithashtu e kemi ndarë programin përgatitor në dy pjesë, me qëllim që në pjesën e parë të ofrohen lëndët si: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Gjuhë Angleze, kurse në pjesën e dytë: Fizikë, Kimi, Biologji, etj...

Ai gjithashtu thekson se ka një interesim në rritje në krahasim me vitet e kaluara. “Ky është viti i tretë që ne kemi ofruar shërbime të tilla, të programit përgatitor, dhe bazuar në statistikat që kemi pasur nga vitet e kaluara ka rezultuar të ketë qenë një projekt që ka prodhuar efekte pozitive në dy

relacionet: nxënësit, të cilët kanë ngritur aftësitë dhe shkathhtësitë e tyre, si dhe ne si institucion ku kemi realizuar pjesën e përgjegjësisë sociale për të qenë afër studentëve potencialë. Mendoj që kjo dinamikë duhet të vazhdohet pasi që ofrimi i shërbimeve të tilla pa pagesë, thjeshtë në të mirë të tyre, vetëm se e freskon informacionin dhe sjellë informata të reja për pjesën që nuk kanë qenë shumë aktiv, apo më mirë të themi kanë qenë më pak aktiv, gjatë procesit mësimor”.

“Krahasuar me vitin e kaluar këtë vit janë parë një numër më i madh i maturantëve të cilët po vijnë për t’i ndjekur trajnimet dhe presim që një numër i konsiderueshëm ta shohin me interes ofertën akademike të UBT-së, pasi që atyre ju ofrohen edhe bursa dhe gara të ndryshme, siç është kompeticioni i esesë për të gjithë ata që shkruajnë bukur”, shtoi ai.

Bashota thekson se këto ligjërata kanë ndikuar në rritjen e numrit të studentëve të regjistruar, pasi që për kohën sa ata vijnë trajnimet, arrijnë të ambientohen dhe ta njohin më për më afër UBT-në.

Donjeta Nikçi  
Media dhe Komunikim,  
viti i parë

PRIZRENI VERËS BËHET QENDËR E ARTIT DHE KULTURËS

## DOKUFESTI – FESTIVALI NDËRKOMBËTAR NË QYTETIN E KULTURËS

Ngjarja më e shquar e Kosovës e themeluar në vitin 2002 është festivali i filmit dokumentar i metrazhit të shkurtër i mirënjohur ndërkombëtarisht. Dokufesti është zhvilluar në një model frymëzues për botën e filmave dokumentarë. Ai ofron një shembull mahnitës të asaj se çka dokumentari mund të arrijë duke qenë si një pasqyrë e popullit dhe të vendit të saj në hartë.

Me fillimin e saj nga paslufta, Dokufesti arrin në kohën e shërimit, me një ide shumë të thjeshtë, të ringjallë trashëgiminë e kinemasë së Prizrenit. Pavarësisht se qyteti i dytë më i madh i Kosovës dhe me një pasuri kulturore që kishte mbijetuar relativisht tronditje gjatë shekujve, Prizreni ishte në gjendje të gëzojë një rilindje të kulturës së saj të filmit pas luftës, përkundër mosinteresimit nga ana e autoriteteve qeveritare, të cilët kishin lënë pas dore dhe të varfëruar kinemanë e qytetit.

Dokufesti ka filluar me një përkushtim të disa fotografëve për të nisur një festival filmi. Ideja e vetme ishte të sjellë filma në qytet dhe të ruajë trashëgiminë

kulturore pra kinemanë e vjetër të Prizrenit- KinoLumbardhin.

Është filluar me një numër të vogël të shfaqjes së filmave nga Kosova dhe rajoni.

Por, ajo është rritur nga viti në vit në një ngjarje kulturore që tërheq artistë dhe audiencë rajonale dhe ndërkombëtare.

Dokufesti zakonisht fillon në gusht dhe filmat shfaqen në të gjithë festivalin tetë ditë, duke u shoqëruar nga programet, aktivitetet dhe seminarët, ekspozitat, DokuPhoto, kampet dhe koncertet.

Filmat shfaqen në shtatë kinematë e improvizuara në qytetin e Prizrenit. Vlentë përmendet Kino Kalaja me pamje mahnitëse të qytetit të vjetër dhe Kino Lumi e improvizuar mbi lumin e bukur, që rrjedh nën këmbët e shikueseve gjatë shikimit të filmave.

Netët në Doku (DokuNights) janë bërë ngjarje muzikore kryesore e Kosovës duke shfaqur këngëtarë ndërkombëtarë dhe lokalë, me DJ të njohur botërisht të cilët marrin pjesë në këtë eveniment kulturor.

Në kuadër të Dokufestit gjithashtu është programi Doku për fëmijë (DokuKids) filmave dhe punëto-

rive të dizajnuara veçanërisht për fëmijë.

Dokufesti ka dëshmuar të jetë i njohur edhe jashtë kufijve të Kosovës, në Ballkan në Evropë dhe jashtë saj si Festival i filmit të shkurtër dokumentar me shumë mirënjohje, me artistë të njohur botëror të cilët vijnë për të përcjellë filmat, kritikë të filmave dhe shumë vizitorë që janë adhurues të filmit të shkurtër.

Drejtori artistik i Dokufestit, Veton Nurkollari, për UBT News ka shpalosur historinë e Dokufestit.

**UBT News: Z. Nurkollari, si është marrë vendimi për krijimin e Dokufestit?**

**Nurkollari:** Së pari kemi qenë disa shokë me të cilët kemi vendosur të merremi me një ide për të bërë një festival të vogël. Ideja e parë ka qenë të bëjmë një festival të muzikës, por pastaj e kemi ndryshuar në atë të filmit.

**UBT News: Nga erdhi ideja për krijimin e kinemave të improvizuara?**

**Nurkollari:** Si ide e parë ka qenë të bëhet një kinema e hapur në oborrin e shkollës së mjekësisë së vjetër në Prizren, por pas një



bisede spontane me një shok timin ai dha idenë që kinemaja të ndërtohej mbi lum.

**UBT News: Si ndikon suksesi i Dokufestit në qytetin e Prizrenit?**

**Nurkollari:** Suksesi i Dokufestit ndikon në mënyra të ndryshme. Së pari në aspektin social në përmirësimin e imazhit të qytetit, pastaj në degën e ekonomisë ku gjatë festivalit ndodh një qarkullim i një shume afro 2-3 milionë euro në qytet.

**UBT News: Si drejtor artistik i festivalit, çfarë mund të na thoni për risitë e filmave pjesëmarrës të edicionit të vitit 2015?**

**Nurkollari:** Si karakteristikë e veçantë në krahasim me vitet tjera, këtë vit do të kemi filma

dokumentarë për muzikë, do të kemi regjisorë të famshëm dhe aktorë shumë të njohur.

**UBT News: Si qëndron puna e kinemasë kryesore “KinoLumbardhi” pas vendimit të privatizimit të saj?**

**Nurkollari:** Agjencia Kosovare Privatizimit na ka dhënë leje deri në fund të vitit që kinemaja të përdoret pasi që komuna e ka shpallur si objekt i interesit të veçantë. Ministria e ka futur në listën e përkohshme të trashëgimisë kulturore, dhe tani KinoLumbardhi është hapur si qendër kulturore për filma, koncerte, debate etj.

Vesa Karjagdiu



## LIGJËRATAT TEMATIKE, NDIHMESË E MADHE PËR STUDENTËT

# DEMIRI: LIGJËRATAT TEMATIKE SJELLIN SHUMË PËRFITIME PËR STUDENTËT

31 maj. - Ligjëratat tematike të organizuara në UBT tashmë janë bërë një traditë. Temat e trajtuara nga këto ligjëratat, me mysafirë ekspertë të fushave të ndryshme, po i pasurojnë studentët me informacione nga industritë e ndryshme, po ndihmojnë në përditësimin e njohurive të studentëve lidhur me zhvillimet aktuale në biznes, ekonomi, politikë, teknologji, etj. Këto aktivitetet po zgjojnë gjithnjë e më shumë interesimin e studentëve, të cilët përmes pjesëmarrjes dhe pyetjeve e debatit të zhvilluar, po i bëjnë këto ligjëratat edhe më dinamike dhe më me interes.

Dy ligjëratat e fundit të organizuara nga Fakulteti i Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë, ajo "Politikat makroekonomike dhe buxhetimi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik" me ligjërues Semra Tyrbedari-Çitaku nga Ministria e Financave,

si dhe "Shërbimet e marketingut digjital", nga ligjëruesi Uragan Alia dhe mysafiri Gëzim Begolli, drejtor menaxhues për Httpool Kosovë dhe Shqipëri, u përcollën me mjaft interes nga studentët e MBE-së, por edhe të drejtimit të tjera në UBT.

Dina Demiri është studente e vitit të tretë në MBE në UBT dhe është e rregullt në përcjelljen e ligjëratave tematike.

"Deri sot janë organizuar një numër i madh i ligjëratave tematike në tema të ndryshme, me interes për studentët e MBE-së dhe Sistemeve të Informacionit. Temat që kryesisht trajtohen gjatë këtyre ligjëratave përfshijnë të gjitha fushat e ekonomisë në të cilat besohet se ka nevojë të thellohen njohuritë, si dhe temat më të reja dhe aktuale që janë jo vetëm në Kosovë por edhe në botë sa i përket sferës së ekonomisë, menaxhmentit dhe biznesit", shprehet Demiri,



Dina Demiri

për të shtuar se ligjëruesit kryesisht janë profesionistë me eksperiencë nga institucione dhe kompani të rëndësishme. Edhe pse pjesëmarrja është e kënaqshme, nisur nga

temat shumë të rëndësishme që trajtohen, studentja Demiri thotë se secili student, duke marrë pjesë në këto ligjëratat, informohet nga burime informative të dorës së

parë lidhur me praktikën dhe proceset e bizneseve, të politikës dhe të ekonomisë në vend dhe më gjerë. Kjo padyshim që i ndihmon secilin student të përfitojë njohuri të reja dhe të krijojë shkathtësi për debat dhe komunikim afarist e publik.

Duke numëruar përfitimet nga këto ligjëratat, ajo thekson se përveç njohurive dhe përvojave të reja, është shumë e rëndësishme mundësia që krijohet për kontakte me ligjëruesit dhe kompanitë e tyre për realizimin e praktikave, shkëmbimin e dijes dhe identifikimin e mundësive potenciale të punësimit. Përfundimisht, Demiri mendon se përfitimet e studentit nga ligjëratat tematike janë shumë të mëdha dhe i fton kolegët studentë nga të gjitha fakultetet që ta shfrytëzojnë mundësinë e dhënë nga UBT dhe të jenë pjesë e debateve dhe diskutimeve në ligjëratat tematike.

## ALBINA SHATROLLI: TRANSFORMIMI IM PREJ PASIGURISË NË DIJE DHE NË PERSPEKTIVË



1 korrik. - Përzgjedhja ime që të filloj studimet në UBT ka qenë e gjitha e rastësishme dhe jo shumë e planifikuar. Si gjimnaziste gjithmonë kam qenë e mendimit të studioj Gjuhën Angleze dhe asnjëherë nuk kam menduar për ndonjë opsion tjetër. Mirëpo, në vendin tonë dëshirat dhe synimet tona për të ardhmen realizohen në forma të ndryshme, shpeshherë jo edhe të planifikuara. Shumë herë janë faktorët dhe rrethanat e jashtme ato që përcaktojnë rrugën tonë drejt së ardhmes dhe jo dëshira dhe vullneti jonë.

Duke parë shumë padrejtësi, manipulime të shumta që bëheshin në rezultatet tona në Universitetin e Prishtinës, unë vendosa të heq dorë nga mendimi dhe dëshira që kam pasur më herët. Pas analizimit të ofertave në Kosovë, vendosa të vazhdoj studimet aty ku njohuritë e mia do të kenë vlerë, aty ku fjala ime do të ketë

peshë, aty ku zëri im me të vërtetë dëgjohet dhe aty ku vullneti dhe dëshirat e mia përkthehen në punë dhe sukses! U binda shumë herët se më mirë është të krijosh qëllim dhe objektiva të reja dhe me perspektivë, sesa të jetosh një dëshirë që nuk do të realizohet asnjëherë sipas pritjeve tua.

Kur fillova studimet në UBT, në drejtimin Sistemet e Informacionit (SI), mendimi dhe dëshira ime e vjetër mbeti vetëm një dëshirë dhe asgjë më shumë. Thjesht, në UBT e gjeta veten edhe pse fillova studimet pa ndonjë motiv të lartë apo ndonjë dëshirë të specifikuar.

Mirëpo, afërsia e profesorëve që tregonin me ne që nga fillimi, puna e tyre në UBT që nuk është vetëm ligjërimi dhe ofrimi i njohurive të reja tek ne por edhe interesimi i tyre për qëllimet, ambicet dhe pritshmëritë tona, ngjallën interesim, motivacion dhe dëshirë për të vendosur për të vazhduar studimet në UBT me synime dhe ambicie të reja dhe njëherit edhe më të fuqishme.

Po ashtu edhe pozitiviteti që profesorët reflektonin tek ne, përpjekjet e tyre që t'i bëjnë lëndët sa më atraktive dhe të kuptueshme për ne, duke ofruar materiale të shumta, libra dhe duke u munduar që të na mbajnë të informuar për gjithçka që ndodh në fushën e Teknologjisë Informative, thjesht më ka bërë që të ndihem e privilegjuar që kam pasur fatin të studioj në një institucion prestigjioz dhe të njohur ndërkombëtarisht për cilësinë e studimeve që ofron.

Të gjitha lëndët sa i përket këtyre dy viteve në UBT kanë qenë

atraktive dhe mjaft produktive sa i përket Sistemeve të Informacionit dhe orientimit tonë në këtë drejtim. Nëse do të veçoja disa prej tyre, atëherë do të zgjedhja: Produktivitetin dhe IT, Mikro dhe Makroekonomi, Menaxhment Financiar, Menaxhimi i Operacioneve, Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, Metodën e Hulumtimit, Rrjetet Kompjuterike dhe Sistemet e Distribuimit, etj.

Prej të gjitha përparësive që UBT ofron, ajo që edhe unë vetë e kam parë si të tillë njëherit shumë të rëndësishme për studentët Bachelor është programi i studimeve, i cili pothuajse në të gjitha lëndët përfshin projekte, punime seminarike dhe hulumtuuese. Punimet seminarike janë një ndihmesë tejet e madhe për çdo student, ku për çdo punim seminarik studentit, përveç literaturës, ndeshet edhe me pjesën praktike, me atë se çfarë në realitet ndodh në treg.

Në këtë mënyrë studenti e krijon një figurë apo pasqyrë edhe për tregun, para se të takohet me të. Dhe kjo në një mënyrë ndikon mjaft shumë që studentët të fillojnë të përgatiten profesionalisht qysh në studimet e tyre Bachelor. Përveç kësaj punimet seminarike, iu ndihmojnë shumë studentëve që të jenë më të përgatitur dhe të fitojnë njohuri paraprake më se të nevojshme rreth temës së diplomës, dhe pse jo, të zgjerojnë edhe ndonjë nga punimet seminarike në Bachelor dhe ta bëjnë temë diplome.

Me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë, Sistemet e Informacionit janë bërë më se të nevo-

jshme në vendin tonë. Në kuadër të programit studimor, kemi mjaft lëndë që kanë ofruar punime hulumtuuese dhe raste të studimit. Për shembull, në Metodën e Hulumtimit si temë kërkimore kemi zgjedhur përdorimin e SI në vendin tonë më konkretisht se sa përdoren SI nga bizneset/organizatat tona?

Pas mbledhjes së të dhënave primare dhe atyre sekondare, ne kemi ardhur në përfundim se SI, edhe pse gjejmë përdorim nga një pjesë e bizneseve tona, një pjesë tjetër që përfaqëson shumicën e bizneseve nuk përdorin mjaftueshëm MIS në menaxhimin dhe arritjen e objektivave biznesore.

Rezultatet tregojnë se niveli i shkollimit dhe njohuritë e punëtorëve rreth pajisjeve të reja teknologjike dhe programeve software fatkeqësisht janë të ulëta dhe kjo ndikon negativisht në përdorimin e Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit (MIS).

Kështu kam arritur të kuptoj se SI janë më se të nevojshme për bizneset tona. Gjithashtu kam kuptuar se bizneset tona janë në kërkim të vazhdueshëm për metoda dhe sisteme të avancuara për lehtësimin e punës së tyre, duke u nisur nga makineritë, programet software dhe pajisjet e tjera të nevojshme tekniko-teknologjike. Për gjetjen e këtyre metodave dhe funksionimit të tyre faktor kyç janë burimet njerëzore, pra personat që kanë njohuri adekuate rreth Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit.

Përparësi tjetër e SI është se gjejmë përdorim pothuajse në çdo biznes/organizatë, thënë më

mirë në çdo industri si prodhuese apo shërbuese. Përdorimi efikas dhe efektiv i MIS krijon një avantazh konkurrues për çdo biznes/organizatë, duke e zvogëluar koston e operimit, duke reduktuar stafin, krijon fleksibilitet të organizatës, përgjysmon operacionet e mëparshme në nevojshme në realizimin e objektivave, krijon qasje më të shpejtë në të dhënat e biznesit etj.

Në fund, si porosi për gjithë ata që ende nuk kanë filluar studimet Bachelor, do t'ju propozoj që të orientohen në drejtime dhe fusha në të cilat vendi ynë ka nevojë të zhvillohet, në mënyrë që sukcesi dhe produktiviteti të jetë reciprok. Sepse, pa kontributin tonë shteti asnjëherë nuk do të arrijë të zhvillohet sa duhet, mirëpo edhe pa zhvillimin e shtetit nuk do të ketë arsimim kualitativ për gjeneratat e ardhshme. Për të gjithë ata që mendojnë kështu, UBT ju ofron të gjitha mundësitë e realizimit të synimeve dhe pritshmërive të tyre. Prandaj, e ardhmja juaj është në duart e juaja, ndërtojeni me cilësi dhe qëndrueshmëri, ndërtojeni atë në UBT. Në UBT ofrohen pothuajse të gjitha mundësitë për t'u transformuar nga një maturant entuziast me ambicie të mëdha në një profesionist të shquar dhe në një akademik të mirëfillt dhe bashkëkohor. UBT është e të gjithëve, sepse të gjithë në UBT ndihen si në shtëpinë e tyre.

(Albina Shatrolli është studente e vitit të dytë, Drejtimi Sistemet e Informacionit në UBT)



ME QËLLIM TË PËRFITIMIT TË PËRVOJËS

# STUDENTËT E MEDIAS REALIZOJNË VIZITA TË SHUMTA NË MEDIA DHE INSTITUCIONE

Studentët e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në UBT, së bashku me profesorin Xhevdet Sfarça kanë realizuar vizita në institucione portalin "indeksonline.net", portalin "telegrafi.com", në Zyrën për Informim në Ministrinë e Shëndetësisë, në Komisionin e Pavarur të Medieve e institucione të tjera



Studentët e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në UBT, së bashku me profesorin Xhevdet Sfarça kanë realizuar një varg vizitash në institucione të ndryshme, si dhe në redaksi të mediave të ndryshme.

Kështu, gjatë një vizite në portalin "indeksonline.net", ata panë nga afër punën e kësaj redaksie lajmesh online dhe biseduan për natyrën e punës së një gazetari që punën në një portal, siç është "indeksonline".

Kryeredaktori Besnik Batusha i njoftoi studentët e UBT-së me numrin e punëtorëve që ka ky medium, teknologjinë që ata përdorin dhe angazhimet e gazetarëve nga përgatitja e lajmit deri te postimi i tij në faqen e mediumit.

Batusha tha se "indeksonline.net" brenda 24 orëve klikohet rreth 500 mijë herë, ndërsa karakteristikë e kësaj është se klikimet kryesisht vijnë nga telefonat "e mençur" ose smartphone.

Studentët e fakultetit Media dhe Komunikim të UBT-së bënë pyetje të ndryshme që ndërlidheshin me profesionin e gazetarit dhe funksionimit në përgjithësi të një medie online, siç është eëë. indeksonline.net.

Studentët e Medias dhe Komunikimit të UBT-së vizituan edhe portalin "telegrafi.com", ku panë për së afërmi punën që bëhet në këtë media elektronike.

Lidhur me rrugëtimin "telegrafit" që nga themelimi e deri sot, për formën e financimit dhe përdorimin e teknologjisë më të re informative, studentëve u foli menaxheri për Marketing dhe Zhvillim, Shpend Sadiku.

Sipas tij, "telegrafi.com" brenda 24 orëve klikohet mbi 500 mijë herë dhe karakteristikë e kësaj, siç tha ai, është se shumica e klikimeve tani bëhet përmes telefonave të mençur (smartphone: Android dhe Iphone).

Studentët bënë pyetje lidhur me numrin e punëtorëve, for-

mave të financimit, publikimit të lajmeve si dhe metodat që ky portal përdorë për të numëruar klikimet dhe artikujt më të lexuar.

Gjithashtu, studentët e Medias dhe Komunikimit në UBT vizituan Zyrën për Informim në Ministrinë e Shëndetësisë, ku u njohën për së afërmi me punën e Zyrës për Informim në kuadër të këtij institucioni.

Drejtori i Departamentit për Informim në MSH, Faik Hoti, u shpjegoi studentëve për natyrën e punës në zyrën për informim, misionin dhe sfidat me të cilat ballafaqohet një sektor informim në një institucion qeveritar, siç është Ministria e Shëndetësisë.

Hoti shpjegoi për mënyrën e bashkëpunimit të zyrës që ai drejton me mediat, monitorimin e tyre dhe për çështje të tjera që hyjnë në natyrën e punës së këtij sektori, siç janë fushatat e ndryshme vetëdijesuese, sensibilizimin e opinionit me politika të ministrisë, e të tjera.

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim, bënë pyetje lidhur me punën në sektorin për informim në Ministrinë e Shëndetësisë, bashkërendimin e punëve me departamente tjera në kuadër të këtij institucioni, organizimin e konferencave për media, komunikatave dhe njoftimeve për publikun që përgatiten nga kjo zyrë.

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim të UBT-të vizituan edhe Komisionin e Pavarur të Medieve. Kryeshefja Ekzekutive e KPM-së, Naile Krasniqi, para studentëve e bëri një prezantim të punës dhe përgjegjësisë që ka Komisioni i Medieve.

Ajo foli për kompetencat e këtij institucioni karshi mediave në Kosovë, numrin e mediave të licencuara, si dhe kushtet që një medium duhet t'i plotësoj për të marrë licencë në KPM. Krasniqi me këtë rast njoftoi se KPM tashmë ka marrë vendim për licencimin e Radios në kuadër të UBT-së, që është një arritur tjetër e menaxhmentit

dhe stafit të këtij universiteti, si dhe një mundësi e shkëlqyeshme edukimi të studentëve të Medias dhe Komunikimit në këtë institucion arsimor.

Krasniqi po ashtu foli për procesin e digjitalizimit, ku njoftoi se, KPM tashmë e ka dërguar në qeveri për miratim strategjinë për këtë proces të rëndësishëm në Kosovë. Ajo u shpjegoi studentëve të UBT-së edhe mënyrën e monitorimit të mediave.

Studentët e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në UBT, përmes pyetjeve të tyre u interesuan për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me mediat, rregulloret të cilat janë në fuqi e që ndërlidhen me funksionimin e medias, si dhe për natyrën e shkeljeve të Kodit të Sjelljes nga mediat, rasteve konkrete të shkeljeve dhe dënimeve të shqiptuara nga KPM.

Studentët e vitit të dytë të Fakultetit Media dhe Komunikim të UBT vizituan edhe Doganat e Kosovës. Ata u pritën nga zëdhënësi, Adriatik Stavileci, i cili studentët e UBT-së i njoftoi me punën e zyrës për marrëdhënie me publikun në kuadër të doganave, si dhe aktivitetet e këtij institucioni.

Stavileci tha se Doganat e Kosovës në përgjithësi kanë marrëdhënie të mira me mediat dhe shtoi se informimi i publikut me aktivitetet e Doganave mbetet prioritet i zyrës që ai drejton.

Studentet e Fakultetit Media dhe Komunikim të UBT-së bënë pyetje për natyrën e punës së Doganave të Kosovës, vështirësitë në terren dhe për çështje të tjera që ndërlidhen me formën e mbledhjes së taksave nga mallrat e importuara në Kosovë.





EKSPERTI ISMET HAMITI FLET PARASTUDENTËVE TË UBT-SË

# MUNGESA E KODIT SHTETËROR KA SHKAKTUAR HUMBJE TË MËDHA PËR KOSOVËN

25 qershor. - Ligjërata e radhës tematike është organizuar në UBT, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri. Këtë ligjërata e hapi prodekanja e Shkencave Kompjuterike, kan. PhD Krenare Pireva, duke falënderuar pjesëmarrësit dhe profesorin e nderuar z. Ismet Hamiti.

Prof. Hamiti, me një përkushtim dhe eksperiencë disa dekadash, ka trajtuar temën me titullin "Qeverisja e Sektorit të Telekomit në përgjithësi, rasti i Kosovës në veçanti", duke hapur diskutimin me pjesëmarrës të kësaj ligjërata.

Brenda qeverisjes së sektorit të telekomit, prof. Hamiti shpjegoi rëndësinë e krijimit të kushteve qeverisëse duke filluar nga politikat e sektorit, ligjet, rregullatorët, operatorët e deri te rëndësia e konsumatorëve brenda kësaj

paradigme, ku mospërpilimi i duhur, përkatësisht përpilimi i gabuar i ligjeve trashëgon pasojat te Rregullatori, Operatori e te pjesët e tjera të varura nga ligji.

Diskutimi është realizuar rreth gjendjes aktuale te Sektorit të Telekomit në Kosovë dhe rajon, problematikat që ndërliken nga mungesa e kodit shtetëror dhe tentativa për të privatizuar asetet fitimprurëse të Kosovës, siç është VALA.

Mungesa e kodit ka shkaktuar humbje të mëdha, qoftë për shkak të përfshirjes së operatoreve të jashtëm, qoftë për shkak të pamundësisë së administrimit të trafikut të shtetit tonë. Sipas përlloraritjes së profesorit, duke u bazuar në eksperiencën e tij, mungesa e kodit shtetëror ka qenë aq e lartë, sa mund të jepet një përlloraritje e përafërt, "sa

dyfishi i të gjitha ndërmarrjeve publike të privatizuara deri me tani".

Sipas profesor Hamitit, aplikimi për kode është më i thjeshtë sesa që paraqitet, pasi që anëtarësimi në ITU është shumë më i thjeshtë sesa ai në OKB, sepse kjo çështje trajtohet si çështje ekonomike, e jo politike.

Si pjesë aktive e ITU-së (International Telecommunication Union) për dy dekada të tëra, z. Hamiti shpjegoi alternativat për aplikim për kodin shtetëror direkt në ITU, dhe procedurat e pëlqimit të anëtarësimit brenda kësaj organizate, që këtë vite ka kremtuar 150-vjetorin e ekzistencës. Draftaplikimi është përfunduar nga Profesor Hamitidhe i është dërguar institucioneve tona, mirëpo mungon vullneti dhe vetëvendosja jonë për të dërguar këtë çështje përpara.



Çështja e dytë e diskutuar lidhur me privatizimin e Telekomit të Kosovës, përkatësisht VALA-s, si një aset shumë i rëndësishëm për vendin tonë, ka ngjallur debate lidhur me privatizimin apo mosprivatizimin e saj. Qëndrimet e tij kundër privatizimit të Telekomit të Kosovës janë argumentuar nga ajo se privatizimi i aseteve të tilla nuk mund të jetë fitimprurës për Kosovën dhe qy-

tetarët e saj, në situata kaotike, siç është sektori i Telekomit.

Ligjërata është përmbyllur duke konkluduar se "gjërat e brendshme të Kosovës nuk duhet diskutuar apo negociuar me të tjerët, në kuptimin e qeverisjes sepse negociimi apo diskutimi i çështjeve të brendshme të Kosovës, automatikisht rezulton në humbje për Kosovën.

FATON HASOLLI E MBROJTI TEMËN MASTER NË MBE

16 qershor. - Kandidati Faton Hasolli e ka mbrojtur me sukses temën Master në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT.

Tema e punuar nga ai është "Analiza e Efekteve të Krizës Financiare në Menaxhimin e Riskut: Rasti i Sektorit Bankar të Kosovës" dhe atë e mbrojtë para komisionit të përbërë nga Prof. Ylber Limani, mentor, Prof. Nehat Ramadani, kryetar, dhe Prof. Ardian Emini, anëtar.

Tema e Masterit mbuloi komponente të rëndësishme nga sektori bankar, me fokus të veçantë në aspektin e menaxhimit të riskut në situata të krizave financiare. Hulumtimi dhe rezultatet e dala nga ky hulumtim janë pjesë e strategjisë së hulumtimit dhe zhvillimit të fakultetit MBE dhe e arritur e madhe e kandidatit FatonHasolli, i cili tashmë gëzon titullin Master i Arteve në MBE.



VALËZA GELA E MBROJTI TEMËN MASTER NË MBE

18 qershor. - Kandidatja Valëza Gela e ka mbrojtur me sukses temën Master në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT.

Ajo paraqiti dhe mbrojtë temën "Menaxhimi i politikave publike fiskale dhe buxhetore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit", para komisionit të përbërë nga Prof. Ibrahim Krasniqi, mentor, Prof. Ylber Limani, kryetar, dhe Prof. Nehat Ramadani, anëtar.

Tema e masterit mbuloi disa nga elementet më të rëndësishme të ndërlihdura me menaxhimin e politikave publike fiskale dhe buxhetore në Republikën e Kosovës dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. Fokus i kësaj teze ishte për të studiuar dhe analizuar reformën e sistemit të politikave menaxhuese fiskale dhe buxhetimit në Kosovë.



GYLFIDANE LUSHTA MBROJTI TEMËN E MASTERIT NË UBT

20 maj. - Në Fakultetin e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT, kandidatja Gylfidane Lushta mbrojtë temën e Magjistraturës "Ndikimi i kompetencave dhe shkathtësive menaxheriale në përcaktimin e sjelljes organizative.

Tema, e cila u paraqit para komisionit të përbërë nga Dr. Nehat Ramadani (kryetar), Dr. Ardian Emini (anëtar) dhe Dr. Ylber Limani (mentor i temës), shtjellon aspekte menaxheriale të kohës, e plotëson literaturën aktuale dhe ndihmon në përshpejtimin e dijës në rrafshin akademik dhe atë të bizneseve.

INTERESIM I SHTUAR I UNIVERSITETEVE EVROPIANE PËR BASHKËPUNIM ME UBT-NË

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka zhvilluar një varg takimesh me përfaqësues të universiteteve, gjatë vizitës në Gjermani, në Austri e në Suedi. Drejtues të këtyre universiteteve janë njoftuar me programet e veçanta të studimeve që i ofron UBT, duke qenë prijatë në Kosovë dhe në rajon në shumë fusha, si dhe me numrin e madh të institucioneve partnere kudo në botë.

Ata kanë shprehur interesim për bashkëpunim me UBT-në në shumë fusha të interesit të dyanshëm.

UBT VAZHDON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN LINNAEUS TË SUEDISË



Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe krijimit të mundësive shtesë për stafin dhe studentët, UBT ka konfirmuar vazhdimin e bashkëpunimit me Universitetin Linnaeus të Suedisë.

UBT dhe Universiteti Linnaeus kanë zhvilluar një bashkëpunim shumë të frytshëm deri tash, që ka përfshirë mobilitetin e studentëve dhe të stafit, si dhe vizitat e ligjërata e dyanshme të drejtuesve të këtyre dy institucioneve.

Sipas marrëveshjes së re, stafit të UBT-së i ofrohet mbështetje financiare për të marrë pjesë në ngritjen e kapaciteteve të tyre akademike.

Një nga drejtueset e Universitetit Linnaeus, Dr. Anita Mirijamdotter ka mbajtur disa cikle ligjërata me studentët e nivelit master në drejtimin Sistemet e Informacionit në UBT.

REKTORI HAJRIZI BËRI NJË PREZANTIM NË FUSHËN E MODELIMIT DHE SIMULIMIT NË UNIVERSITETIN E VJENËS PËR TEKNOLOGJI

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi qëndroi për vizitë në Universitetin e Vjenës për Teknologji, një universitet partner i UBT-së.

Me këtë rast, ai bëri një prezantim në fushën e Modelimit dhe Simulimit në një seminar të organizuar në këtë universitet.

Gjithashtu, rektori Hajrizi diskutoi me drejtuesit e Universitetit të Vjenës për Teknologji lidhur me projektet e përbashkëta që këto dy institucione do të zhvillojnë në të ardhmen.



## University of Warsaw




**Bachelor and Master Degree in International Relations**

Apply for Scholarship!

---

**Teaching and Research Areas**

- International Politics
- International Political Economy
- Culture and Multiculturalism
- Diplomacy and Foreign Policy
- International Law and Institutions
- Security and Strategic Studies
- European Integration
- International Relations Theory
- Emerging Markets
- International Business



**University of Warsaw (UW)**  
Is known as one of the leading academic and research center in Poland. The high level of scientific research, its connection with the education of students and the diversity and attractiveness of our teaching determines the position of the University in the country and worldwide.

**UW Highlights:**

- Founded in 1816
- In the top 4% World-Class Universities
- Ranked no.1 in Poland
- Ranked by QS Topuniversities, The times THEWUR,
- Top 500 in Shanghai Group
- One of the most modern library in Central Europe

**Institute of International Relations:**

- Established in 1976
- Worldwide research cooperation
- Visiting Professors from all over the World
- Active in national and international research
- Bachelor, Master level and PhD degrees in English
- Worldwide student exchange programme

**Fees & Financing:**  
Bachelor: 1300 € / Year  
Master: 2000 € / Year  
The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

**Come to UBT and get European degree**

**TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS**



Email: warsaw@ubt-uni.net  
Email: ismn@uw.edu.pl  
Institute of Warsaw  
www.ism.uw.edu.pl

## Danube University Krems



**Master of Business Administration - MBA**

---

**Specializations with MBA Program**

- Aviation
- Business Performance Management
- Corporate Responsibility & Business Ethics
- E-Mobility Management
- Energy & Carbon Management
- Finance
- International Business
- Marketing & Sales
- Strategic Management & Organizational Change
- Enterprise Project Management

Apply for Scholarship!

---

**Fees & Financing**  
Tuition fee: Euro 21,900  
Please note our **Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 10,950  
The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

**Danube University**



Danube University Krems has specialized in postgraduate academic studies and offers exclusive courses in the fields of health and medicine, communication and globalization, business and law, education and media as well as of arts, culture and building. Being a European model project, Danube University Krems combines high quality in education, research and consulting with excellent customer orientation and service. More than 5,000 students from 80 countries are enrolled in over 150 academic courses.

**Department for Management and Business**  
We believe strongly in a long life learning that prepares and enables you to become a responsible business leader in a fast changing world. We place strong emphasis on learning-by-doing approach, and strive for creating an innovative environment that enables you to have a high caliber education and training. As we are well located in Central Europe, you will enjoy a multicultural and international faculty and student body. The Danube Business School provides an environment where East meets West with strong links to the business community and relationships with partners from both Eastern as well as Western European countries.

**Top 10 Reasons to Join a Danube MBA**

- An integrative and applied approach to learning
- Long expertise in postgraduate education
- Customized high standard programs
- High calibre and international faculty
- Flexibility for both full-time and part-time students
- Campus located in the picturesque Wachau region
- International student body
- International study trips
- Individualized quality service
- More than 2000 alumni


**Top University Education for Top Students!**

**TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS**



Email: dukmba@ubt-uni.net  
Email: michaela.moser@donau-uni.ac.at  
Tel: +43 (0)2732 893 2126  
Web: www.donau-uni.ac.at


## Vienna University of Technology



**Msc Engineering Management**

**Your key to the top engineering league**

---




---


**CONTENTS**  
Business • Engineering Informatics • Production • Master's Thesis

**MODALITIES**  
3 semesters, part-time, 14 weekend tracks, in English,

**FEES & FINANCING**  
Tuition fee: Euro 22,000  
Please note our **KAMM Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 13,000  
The KAMM Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

**HIGHLIGHTS**


- 17 years experience
- Master of Science Degree of Vienna University of Technology
- Executive program
- International Faculty - Universities and Industry
- International Participants - Worldwide
- Top international faculty from Europe and USA
- Part time - 14 weekend modules (Thursday to Sunday)
- According to the Bologna Convention
- Contents modernized continuously
- Evening lectures of distinguished guest speakers
- Company visits
- Sustainable Learning Environment – with your tablet at the university (included in the price)
- Alumni Club related to IEEE
- Regularly Club meetings for Networking
- From our graduates approximately 2/3 are in (high) management positions, 1/3 founded a company



**Top University Education for Top Students!**

Our mission is "technology for people". Through our research we "develop scientific excellence", through our teaching we "enhance comprehensive competence".

**Vienna University of Technology**  
Continuing Education Center  
Operngasse 11 • A-1040 Vienna  
T +43(0)1/58801-41701 • engineering@tuwien.ac.at  
Email: engineering@ubt-uni.net  
http://engineering.tuwien.ac.at





SHËNIM

# METADATA DHE PRIVATËSIA: KUFIJTË E LIRISË ONLINE



Atdhe Buja

Kufiri i mbledhjes së të dhënave për të dhënat (IP, Koha, Përdoruesi, pranuesi etj.), ruajtja e privatësisë së qytetarit dhe respektimi i rregulloreve në fuqi janë parime etike të sistemit demokratik që duhet t'i përmbahen të gjithë. Metadata është informacion i krijuar, varësisht si ju e përdorni teknologjinë. Për shembull, përfshijnë datën dhe kohë që ju mund ta quani/cilësoni si dikush ose vendndodhjen nga e cila keni arritur të qaseni në e-mail tuaj.

Një mënyrë e lehtë për të parë disa nga metadata-t tuaja është duke shikuar në historinë e shfletuesit (Browser-it) tuaj, i cili ofron informacion për faqet e internetit (websites) që keni vizituar dhe kur. Më poshtë është paraqitur një model metadata nga agjencia e lajmeve "The Guardian".

```
{
  "created_at": "Mon Jun 10 21:09:19 +0000 2013",
  "id": 344199622916448260,
  "id_str": "344199622916448256",
  "text": "Need to catch up? Our complete #NSAFiles coverage is here: http://t.co/iZPkknopxk",
  "source": "<a href='\"http://www.socialflow.com\"' rel='\"nofollow\"'>SocialFlow</a>",
  "truncated": false,
  "user": {
    "id": 16042794,
    "id_str": "16042794",
    "name": "GuardianUS",
    "screen_name": "GuardianUS",
    "location": "New York",
    "description": "Featuring the Guardian's US coverage, conversations and reporters.",
    "url": "http://t.co/eaPiqNUSme",
    "protected": false,
    "followers_count": 55597,
    "friends_count": 509,
    "listed_count": 2414,
    "created_at": "Fri Aug 29 14:52:08 +0000 2008",
    "favourites_count": 860,
    "utc_offset": -18000,
    "time_zone": "Eastern Time (US & Canada)",
    "geo_enabled": true,
    "verified": true,
    "statuses_count": 41567,
    "lang": "en",
    "contributors_enabled": false,
    "is_translator": false,
    "profile_background_color": "B2AFA9"
  }
}
```

Agjencia Britanike e lajmeve "Guardian" ka paraqitur një shembull të mirë të metadata-ve varësisht nga teknologjia apo shërbimi që përdorni:

<b>email</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>sender's name, email and IP address</li> <li>recipient's name and email address</li> <li>sender's name for identification</li> <li>date, time and timezone</li> <li>unique identifier of email and related emails</li> <li>content type and encoding</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>mail client, login records with IP address</li> <li>mail client header formats</li> <li>priority and categorization</li> <li>subject of email</li> <li>status of the email</li> <li>read receipt request</li> </ul>
<b>phone</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>phone number of every call</li> <li>unique serial number of phones involved</li> <li>time of call</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>duration of call</li> <li>location of each participant</li> <li>telephone calling card numbers</li> </ul>
<b>Camera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>photographic identification</li> <li>creation and modification date and time</li> <li>location where photo was taken</li> <li>details about a photo's contents</li> <li>copyright information</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>camera make and model</li> <li>camera settings: shutter speed, F-stop, focal length and flash type</li> <li>photo dimensions, resolution and orientation</li> </ul>
<b>Facebook</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>your name and profile bio information including birthday, hometown, work history and interests</li> <li>your username and unique identifier</li> <li>your settings/privacy</li> <li>your location</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>your device</li> <li>activity date, time and timezone</li> <li>your activities: likes, shares and events</li> </ul>
<b>Twitter</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>your name, location, language, profile bio information and e-mail</li> <li>when you created your account</li> <li>your username and unique identifier</li> <li>tweets' location, date, time and timezone</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>tweet's unique ID and ID of tweet replied to contributor ID</li> <li>your followers, following and favorite count</li> <li>your verification status</li> <li>notification sending the tweet</li> </ul>
<b>Google search</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>your search queries</li> <li>results that appeared in search</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>IPs you visit from search</li> </ul>
<b>Web browser</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>your activity including pages you visit and when</li> <li>uses data and possibly uses login details with auto-fill features</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>your IP address, internet service provider, device hardware details, operating system and browser version</li> <li>cookies and cached data from websites</li> </ul>

Kombinimi i këtyre metadata-ve nga organet e drejtësisë, policisë dhe të tjera mund të ofrojë rezultate shumë të nevojshme për luftimin e krimit dhe në zgjidhjen e shumë rasteve të drejtësisë por edhe në rritjen e cilësisë së e-shërbimeve për qytetarët.

Kjo na kujton thënien e famshme: "When we act morally, when we act ethically, this is the inspiration that changes the world". (Ku jemi të moralshëm, kur ruajmë etikën, ky është inspirimi që do të ndryshojë botën.)Eduard Snowden

Sipas Snowden, një pasojë e paparë e dhënies së informacioneve është përfshirja e termit "metadata" në përdorim. Ky informacion ka të bëjë në lidhje me kohën dhe vendin e një thirrje telefonike ose email, në krahasim me përmbajtjen e atyre bisedave ose mesazheve. Dallimi formon thelbin e debatit për qëllimin e duhur të mbikëqyrjes ose vëzhgimit nga NSA (Agjencia e Sigurisë Kombëtare). Por, gjithashtu, këto metadata përfshijnë të dhënat personale, të cilat mund të ndërtojnë një profil më të detajuar madje edhe duke lexuar/vëzhguar në përmbajtje. Ky revolucion dixhital që ne sot po e përjetojmë po çon në një shpërthim të përdorimit të madh të celularëve dhe internetit.

Gazetari i njohur GlennGreenwald i agjencisë së lajmeve "The Guardian" në një takim në Universitetin e Utah, ka bërë prezantimin e detajuar të informacioneve klasifikuara në lidhje me programet e mbikëqyrjes globale të bazuar në dokumentet top-sekret të shfaqura nga EdwardSnowden (video e plotë: <https://www.youtube.com/watch?v=-1jAOJHvll0>). Gjatë gjithë këtij prezantimi ai bën një analizë shumë interesante për rëndësinë e Internetit dhe konceptimit të tij në mes moshës së vjetër dhe brezit të ri.Sipasz. Greenwald, atributet më të besueshme demografike për përcaktimin se si njerëzit reagojnë ndaj kësaj pyetjeje është moshë.

Mënyra se si të rinjtë kanë tendencë të mendojnë shumë më ndryshe se të moshuarit për internetin, të cilët nuk janë rritur me Internet, interneti për ta është një lloj instrumenti diskret që përdoret për të arritur funksione të caktuara p.sh. blerja e një libri, rezervimi biletës së avionit etj. Por, për të rinjtë Interneti është shumë më tepër se që është në të vërtetë një pjesë qendrore e botës është vendi ku ju eksploroni botën, bëni miq dhe ruani lidhjet njerëzore, eksperimentoni me identitetin tuaj.

(Autori është student në nivelin Master në Departamentin e Shkencave Kompjuterike në UBT. Artikulli është botuar në: <http://www.pcworld.al>)

## PROFESORINË UBT, VISAR KRELANI DOKTORON NË POLITEKNIKUN E MILANOS

Dr.Visar Krelani, mësimmhënës në UBT, ka mbrojtur temën dhe ka marrë titullin doktor shkence, në Politeknikun e Milanos. Ai ka doktoruar në temën «Aftësia vetëshëruese e kompoziteve të çimentos» («Self-HealingCapacityofCementitiousComposites»), e cila është realizuar falë një bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet Politeknikut të Milanos në Itali dhe Universitetit Federal të Rio de Janeiros në Brazil. Politekniku i Milanos, një institucion me renome të lartë në botë, këtë vit është konfirmuar në vendin e 13-të në botë në drejtimin e Inxhinierisë së Ndërtimit, ku ka doktoruar Dr.Krelani. Kërkimet e realizuara gjatë doktorimit ai i ka paraqitur në disa konferenca, si në SHBA, në Kanada, në Belgjikë, në Brazil, në Itali etj. Gjithashtu, ai do të vazhdojë edhe më tutje kërkimet në këtë fushë. Dr.Visar Krelani është profesor i rregullt në Departamentin e Ndërtimitarisë dhe Infrastrukturës në UBT. Semestrin e kaluar ai ka ligjruar lëndën Materialet në Arkitekturë në Departamentin e Arkitekturës.





# Top Education for Top Students



- 14 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i certifikuar për ekselencë (EFQM)
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfitues për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfitues i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

*Zgjedh më të mirin ...  
... që të bëhesh më i miri!*

**Come to UBT and Go International...**

Kolegji UBT - Bartës privat i Arsimit të Lartë i akredituar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe licencuar nga MASHT.

## PROGRAMET E AKREDITUARA

### - MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Baçelor dhe Master)

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Manaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Marketing dhe Shitje
- Biznes ndërkombëtar
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit

### - SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Baçelor dhe Master)

- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Softuer dhe Sisteme Inxhinierie
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Dizajn dhe Multimedia
- Mekatronikë dhe Robotikë

### - MENAXHMENT I MEKATRONIKËS

#### (Baçelor dhe Master - I vetmi i akredituar në vend)

(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial Ndërmarrësi dhe Menaxhment)

### - SISTEMET E INFORMACIONIT (Baçelor dhe Master)

- Sistemet e Informacionit për Biznes
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Librarive dhe Menaxhimi i Dijes
- Statistika, Përpunimi i të dhënave dhe simulim
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia

### - ARKITEKTURË DHE

#### PLANIFIKIM HAPËSINOR (Baçelor dhe Master)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

### - INXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË (Baçelor)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

## REGJISTRIMI

### Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

**Gjuha e studimeve:** Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

### Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjëratat të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë.

Për të punësuarit ofrohen ligjëratat pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

### Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Liçensa falas për software
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet me prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajnime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.
- Certifikime për kontabilist në bashkëpunim me SCAA

### Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Baçelor është **1200 €**, për nivelin Master është **1500 €** me mundësi pagese deri në **12 kështe**.

Për të gjithë **nxënësit e dalluar** UBT ofron përkrahje financiare

### UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

### - SHKENCA POLITIKE (Baçelor)

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integrimi Evropiane
- Administratë Publike

### - JURIDIK (LLB - Baçelor)

(Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)

### - E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE (LLM - Master)

### - MEDIA DHE KOMUNIKIM (Baçelor)

### - POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM (Master)

### - INXHINIERI E ENERGISË (Baçelor)

### - INXHINIERI E ENERGISË EFIÇIENTE

(Diplomë profesionale - I vetmi i akredituar në vend)

### PËR UBT:

“UBT është krijuar si një universitet ndërkombëtar; një universitet modern që i përbush nevojat e një shoqërie dhe vendi demokratik, që në vazhdimësi është duke zhvilluar kapacitetet ekonomike dhe teknologjike.”

*Edmond Hajrizi, Rektori i UBT-së*

“Edukimi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve, që sot veprojnë ndërkombëtarisht, jo vetëm në hapësirën e Europës, por globalisht. UBT ju ofron mundësinë për të arritur qëllimet-objektivat ndërkombëtare”

“Profesorët e këtij universiteti janë më të mirët, dhe mund të shtojë që studimet tuaja në UBT janë më të mirat për të ardhmen tuaj si dhe të vendit tuaj, por edhe për një të ardhme më të mirë të Europës.”

*Dr.Erhard Busek Special Coordinator for the Stability Pact for SEE*

Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400, Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: [www.ubt-uni.net/apliko](http://www.ubt-uni.net/apliko) ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjilan